



***STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E
DREJTËSISË 2024-2030
DRAFT RAPORTI I MONITORIMIT
JANAR - DHJETOR 2024***

Tiranë, Mars 2025

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
I. INFORMACION PËRMBLEDHËS	18
1.1. Hyrje	18
1.2. Përmbledhje e arritjeve dhe sfidave kryesore	19
1.3. Metodologjia	24
II. PROGRESI I STRATEGJISË	29
2.1 Reforma të zbatuara me sukses në 2024	29
2.2 Impakti i zbatimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritit evropian	29
2.3 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit	31
III. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE TREGUESVE	33
3.1 Përmbledhje e arritjeve në lidhje me Qëllimet e Politikave dhe Objektivat Specifikë sipas masave	33
3.2 Vlerësimi i arritjes së Qëllimeve të Politikës kundrejt masave dhe treguesve	34
3.2.1 Qëllimi i Parë i Politikës	34
Objektivi Specifik 1.1.	34
Objektivi Specifik 1.2.	41
Objektivi Specifik 1.3.	44
Objektivi Specifik 1.4.	49
3.2.2. Qëllimi i Dytë i Politikës	53
Objektivi Specifik 2.1.	53
Objektivi Specifik 2.2.	56
Objektivi Specifik 2.3.	59
Objektivi Specifik 2.4.	62
Objektivi Specifik 2.5.	65
3.2.3. Qëllimi i Tretë i Politikës	70
Objektivi Specifik 3.1.	70
Objektivi Specifik 3.2.	77
Objektivi Specifik 3.3.	81
Objektivi Specifik 3.4.	85

<i>Objektivi Specifik 3.5</i>	89
<i>Objektivi Specifik 3.6</i>	94
3.2.4. Qëllimi i Katërt i Politikës	105
<i>Objektivi Specifik 4.1.</i>	105
<i>Objektivi Specifik 4.2.</i>	109
<i>Objektivi Specifik 4.3.</i>	110
<i>Objektivi Specifik 4.4.</i>	117
3.2.5. Qëllimi i Pestë i Politikës	120
<i>Objektivi Specifik 5.1.</i>	120
<i>Objektivi Specifik 5.2.</i>	127
<i>Objektivi Specifik 5.3.</i>	131
IV. RISQET HAPAT NË VIJIM	134
4.1 Pasqyrë e Përgjithshme	134
4.2 Vlerësimi i riskut	134
4.3 Hapat vijues	143

LISTA E AKRONIMEVE

AT	<i>Asistencë Teknike</i>
BE	<i>Bashkimi Evropian</i>
BKH	<i>Byroja Kombëtare e Hetimit</i>
CAMS	<i>Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Shërbimit të Prokurorisë Shqiptare</i>
CCTP	<i>Profesionist i Çertifikuar për Traumat Klinike</i>
DNJF	<i>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas</i>
DPB	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</i>
DPKHL	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit</i>
DPSHP	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës</i>
DHASH	<i>Dhoma Kombëtare e Avokatisë e Shqipërisë</i>
DHKN	<i>Dhoma Kombëtare e Noterëve</i>
DHKND	<i>Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësuesve</i>
DHKPGJP	<i>Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë</i>
GP	<i>Grup Pune</i>
GJEDNJ	<i>Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut</i>
GJK	<i>Gjykata Kushtetuese</i>
GJL	<i>Gjykata e Lartë</i>
IEVP	<i>Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale</i>
ILD	<i>Inspektori i Lartë i Drejtësisë</i>
IPA	<i>Instrumenti i Asistencës Para-Anëtarësimit</i>
IPSIS	<i>Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar</i>
IT	<i>Teknologjia e Informacionit</i>
JFA	<i>Projekti "Justice for All"</i>
KE	<i>Këshilli i Evropës</i>
KEDNJ	<i>Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut</i>
KLGI	<i>Këshilli i Lartë Gjyqësor</i>
KLP	<i>Këshilli i Lartë i Prokurorisë</i>

KM	<i>Këshilli i Ministriave</i>
KPA	<i>Kolegji i Posaçëm i Apelimit</i>
KPK	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit</i>
MD	<i>Ministria e Drejtësisë</i>
MFE	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>
MShMS	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>
OJF	<i>Organizata Joqeveritare</i>
OS	<i>Objektiv Specifik</i>
OSFA	<i>Fondacioni “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”</i>
OZHQ	<i>Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm</i>
PKIE	<i>Plani Kombëtar për Integrimin Evropian</i>
PP	<i>Prokuroria e Përgjithshme</i>
PZ	<i>Periudha e Zbatimit</i>
PSDHS	<i>Plani Strategjik i të Dhënave Sistemike</i>
QP	<i>Qëllim Politik</i>
QTI	<i>Qendra e Teknologjisë dhe Informacionit</i>
SASPAC	<i>Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës</i>
SKZHI	<i>Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim</i>
SND	<i>Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë</i>
SPAK	<i>Struktura e Posaçme Antikorrupsion</i>
SHM	<i>Shkolla e Magjistraturës</i>
TF	<i>Task Forca</i>
TP	<i>Tabela e përputhshmërisë</i>
DPPP	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave</i>

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Reforma në drejtësi, e nisur në vitin 2016, ka për qëllim adresimin e problematikave të rëndësishme të sistemit të drejtësisë dhe përafrimin e tij me standardet evropiane. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve organike të miratuara në këtë kuadër kanë përcaktuar qartë garancitë për pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin dhe integritetin e sistemit gjyqësor, si dhe mekanizmat për rritjen e llogaridhënies dhe monitorimit të funksionimit të tij.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka qenë dhe është një instrument kyç në drejtimin e reformave në këtë sektor, duke synuar përmirësimin e aksesit në drejtësi, rritjen e besimit të publikut dhe nxitjen e integritetit evropian. Për këtë arsye, hartimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 është bazuar në një analizë të plotë të reformave të mëparshme dhe ka për qëllim të konsolidojë arritjet e SND 2021-2025, duke adresuar sfidat e reja të sektorit.

Vlen të theksohet se, sistemi i drejtësisë ka kaluar nëpër disa faza kyçe për të siguruar harmonizimin me praktikrat dhe standardet më të mira ndërkombëtare:

Faza I (2016-2020): Krijimi i bazës ligjore dhe institucionale të reformës, përfshirë ndryshimet kushtetuese dhe ristrukturimin e sistemit gjyqësor në përputhje me standardet evropiane. Gjatë kësaj periudhe, u krijuan institucionet e reja dhe nisi procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Faza II (2021-2025): Konsolidimi i kuadrit institucional, zbatimi i praktikave moderne në drejtësinë penale, përmirësimi i infrastrukturës dhe zhvillimi i teknologjive inovative për të rritur efikasitetin dhe transparencën në sistemin e drejtësisë.

Faza III (2024-2030): Synohet forcimi i kuadrit ligjor në përputhje me *acquis* të BE-së, eliminimi i backlog-ut, rritja e cilësisë së shërbimeve dhe sigurimi i një drejtësie të standardeve evropiane. Po ashtu, do të fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës dhe forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës.

Duke qenë se reforma në drejtësi ka kaluar tashmë dy faza dhe po hyn në fazën e saj të tretë, u vlerësua e nevojshme hartimi i një strategjie të re për vitet 2024-2030.

Në këtë drejtim, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030 dhe dokumentet e saj strategjike – Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve – të hartuar nga Ministria e Drejtësisë si një dokument politik kyç i Qeverisë Shqiptare, janë në përputhje të plotë me të gjitha dokumentat e tjera strategjik adresuar rekomandimet e raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare në përputhje me masat strategjike të përcaktuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës – Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.

Strategjia e re identifikon prioritetet kyçe për sistemin e drejtësisë në kuadër të reformës, duke përfshirë zbatimin e hartës gjyqësore, forcimin e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë, reduktimin e backlog-ut në gjykata dhe plotësimin e vakancave të krijuara nga procesi i vetting-ut.

E konceptuar si një strategji gjithëpërfshirëse, SND 2024-2030 përmban objektiva të qarta dhe rezultate të pritshme për shtatë vitet e ardhshme, në përputhje me angazhimet që rrjedhin nga procesi i integritetit të Shqipërisë në BE. Ndryshe nga strategjia e mëparshme, SND 2024-2030 përfshin edhe elementë të rinj, si informimi dhe edukimi ligjor i publikut për ligjin dhe sistemin e drejtësisë, si një prioritet i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit qytetar dhe forcimin e sundimit të ligjit.


Gjatë shtatë viteve të zbatimit të saj, SND 2024-2030 parashikon në total realizimin e 22 *Objektivave Specifike* dhe 139 *masave* dhe 511 *aktiviteteve*, të ndara në pesë objektiva politikë. Arritjet dhe sfidat kryesore në sektorin e drejtësisë maten përmes 35 treguesve, të përfshirë në Pasaportën e Treguesve.

Ky dokument që paraqesim është raporti i pari i monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, dhe ka si qëllim vlerësimin e ecurisë së implementimit të objektivave dhe masave të parashikuara për vitin 2024.


Në këtë raport janë marë në analizë:

- 22 Objektiva Specifik
- 99 Masa të përcaktuara për tu zbatuar gjatë janar-dhjetor 2024
- 240 Aktivitete të të përcaktuara për tu zbatueshme zbatuar përgjatë janar-dhjetor 2024


NIVELI I REALIZIMIT TË QËLLIMEVE POLITIKE PË
PERIUDHËN E RAPORTIMIT



Realizimi i SND 2024-2030 për vitin 2024




Masa të realizuara plotësisht për vitin 2024




Aktivitete të realizuara plotësisht për vitin 2024


REALIZIMI I QËLLIMEVE TË POLITIKËS NË VITIN 2024¹




QËLLIMI POLITIK 1
Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standartet Evropiane



QËLLIMI POLITIK 2
Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë



QËLLIMI POLITIK 3
Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë




QËLLIMI POLITIK 4
Forcimi i cilësisë së drejtësisë



QËLLIMI POLITIK 5
Drejtësi më e afërt me qytetarët

Niveli i masave të zbatuara për vitin 2024
për 5 Qëllimet Politike




¹ Realizimi në këtë grafik paraqet mesataren e realizimit të të gjithë masave që përmban secili Qëllim Politik

Paraqitja grafike për zbatimin e masave të secilit Qëllim Politik për vitin 2024


QËLLIMI I I POLITIKËS

Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standartet Evropiane




QËLLIMI II I POLITIKËS

Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë




QËLLIMI III I POLITIKËS

Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë




QËLLIMI IV I POLITIKËS

Forcimi i cilësisë së drejtësisë



QËLLIMI V I POLITIKËS


Drejtësi më e afërt me qytetarët



Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të këtij Raporti, paraqiten si më poshtë:

Lidhur me përmbushjen e objektivave specifik të Qëllimit të Parë Politik - “Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standartet Evropiane.”, konstatohet se:

Më 15 tetor 2024 u zhvillua Konferenca e Dytë Ndërqeveritare ku u hap grupkapitulli i parë i negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, i cili përfshin reformat në drejtësi, funksionimin e institucioneve demokratike dhe administratën publike. Ky grupkapitull është kyç për procesin e anëtarësimit, pasi progresi në këto fusha ndikon drejtpërdrejt në ritmin e negociatave për kapitujt e tjerë. Hapja e tij konfirmon angazhimin e Shqipërisë për forcimin e shtetit të së drejtës dhe përmirësimin e qeverisjes.



Ndërkohë më 17 dhjetor 2024 u zhvillua Konferenca e Tretë Ndërqeveritare ku u hap grupkapitulli i gjashtë, i cili trajton politikën e jashtme, sigurinë dhe mbrojtjen. Ky kapitull synon përafrimin e politikës së jashtme të Shqipërisë me atë të BE-së, pjesëmarrjen në misione ndërkombëtare dhe forcimin e bashkëpunimit në mbrojtje.

Në vijimësi me Vendimin Nr. 787, datë 18.12.2024 u miratua “Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030, dhe plani i saj i veprimit dhe pasaportës së treguesve”. Hartimi i Strategjisë së Re të Drejtësisë, u mbështetet në një analizë të plotë të historikut të reformave të sistemit të drejtësisë. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka luajtur një rol kyç në drejtimin e reformave në këtë sektor, duke synuar përmirësimin e qasjes në drejtësi, rritjen e besimit të publikut në sistemin shqiptar të drejtësisë dhe nxitjen e integritetit evropian. Këto objektivat janë reflektuar në dokumentet e reja për periudhën 2024-2030, të cilat synojnë të vazhdojnë dhe të thellojnë reformat e filluara, duke u mbështetur në arritjet e mëparshme dhe duke adresuar sfidat e reja në fushën e drejtësisë.

Procesi i hartimit dhe miratimit të ndryshimeve të reja të Kodit Penal, në përputhje me acquis dhe rekomandimet e screening report në fushën penale dhe kriminalitetit, ende mbetet i pafinalizuar. Duhet theksuar se hartimi i Kodit të ri Penal në përputhje me acquis e BE-së është sfidues dhe kërkon kohë, burime dhe profesionalizëm të duhur. Për këtë arsye, cilësia e Kodit të ri Penal duhet të konsiderohet si prioritet.

Një arritje e rëndësishme e reformës në drejtësi për vitin 2024 është përfundimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Gjatë periudhës 8 shkurt 2018 – 27 nëntor 2024, KPK ka dhënë gjithsej

805 vendime, duke përfshirë:

- 373 vendime për konfirmim në detyrë;
- 268 vendime për shkarkim nga detyra;
- 105 vendime për ndërprerje të procesit;
- 49 vendime për përfundim të procesit pa vendim përfundimtar;
- 8 vendime për ndërprerje të procesit;
- 2 vendime për pezullim nga detyra.

Gjatë veprimtarisë së tij, KPK ka referuar 53 subjekte pranë SPAK për dyshime mbi elementë penalë, nga të cilat 19 i përkasin vitit 2024, shifër e reflektuar edhe në Progres-Raportin e vitit 2024. Nga këto raste, 12 janë kaluar për hetim pranë Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm, 5 vijojnë fazën hetimore me dokumentacion të përcjellë, ndërsa për 2 subjekte është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Këto referime përforcojnë përpjekjet për integritetin dhe llogaridhënien në sistemin e drejtësisë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka miratuar aktet nënligjore, të cilat janë thelbësore për finalizimin dhe për garantimin e një procesi tërësisht të rregullt, transparent dhe objektiv të vlerësimit të prokurorëve gjatë periudhës 2024-2025.

Më 10 maj 2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) zhvilluan mbledhjen e përbashkët vjetore, në përputhje me nenin 170 të Ligjit Nr. 115/2016, për të forcuar mekanizmat disiplinorë në sistemin e drejtësisë. Pas kësaj, dy institucionet organizuan një tryezë të rrumbullakët për hartimin e një draft-rregulloreje mbi bashkimin e procedimeve disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët e përfshirë në të njëjtën shkellje. Ky proces u përmbyll me miratimin e Rregullores nga KLP me vendimin Nr. 112, datë 9 korrik 2024, duke krijuar një mekanizëm të ri disiplinor për raste të ndërlydhura. Ndërkohë kjo praktikë e krijuar sugjerohet të vazhdojë edhe në vijim duke pasur të paktën dy mbledhje të përbashkëta në vit nga ana e Këshillave.


Ndërkohë Prokuroria e Posaçme përballet me mungesë të këshilltarëve ligjorë, një problematikë e evidentuar në raportin vjetor 2023, e cila ndikon në ndjekjen efektive të çështjeve në të gjitha shkallët e gjyqimit. Kjo mungesë bëhet më e evidente edhe në këtë periudhë me kalimin e kompetencave të Komisionerit Publik në janar 2025 te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke rritur ngarkesën e punës për përfaqësimin në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Edhe pse në buxhetin e vitit 2025 është miratuar shtimi i 10 këshilltarëve (ligjorë dhe ekonomikë), deri më tani janë marrë vetëm katër nga stafi i ish-komisionerëve publikë, ndërsa hapja e vakancave për pjesën tjetër është vonuar për shkak të pritjes së ndryshimeve ligjore nga Kuvendi.

E njëjta situatë vihet re tek Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku mungesa e kryetarit të Gjykatës krijon një boshllëk në drejtimin dhe koordinimin e punës, duke ndikuar në menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe efikasitetin administrativ. Sipas ligjit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kompetencën për të emëruar kryetarin, por deri më tani kjo nuk është realizuar, çka mund të pengojë vendimmarrjen strategjike,

shpërndarjen e ngarkesës së punës dhe mbikëqyrjen e proceseve gjyqësore. Kjo situatë përkeqësohet edhe nga mungesa e ndihmësve ligjorë, duke krijuar nevojën për një riorganizim të menjëhershëm të strukturës, për të garantuar funksionimin optimal të gjykatës.

II. Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Dytë Politik “Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë”, konstatohet se:

KLJGJ dhe KLP kanë vijuar me verifikimin e pasurisë dhe figurës për gjyqtarët dhe prokurorët para ngritjes në detyrë, duke siguruar përputhjen me standardet e rivlerësimit dhe vendimet e vettingut. Në këtë kuadër, KLJGJ ka miratuar programet vjetore për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, ndërsa KLP ka ndjekur një proces të ngjashëm për prokurorët, përfshirë



procedurat e përzgjedhjes. Gjithashtu, KLP ka mundur vlerësime të përshpejtuara për magistratët sipas kërkesës, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Institucionet përkatëse po shqyrtojnë ngritjen e mekanizmeve shpesh për përmirësimin e procesit të vlerësimit dhe kanë bashkëpunuar me partnerë ndërkombëtarë për të reduktuar numrin e dosjeve të mbetura. Megjithatë mbetet një numër i lartë i magistratëve të cilët akoma nuk kanë të paktën një vlerësim etik dhe profesional dhe nevojitet një plan efikas për realizimin e këtij procesi duke ruajtur dhe standartet më të larta.

Gjithashtu zbatimi dhe ndjekja e mëtejshme e dokumenteve strategjike të KLJGJ-së për hetimin administrativ të sinjalizuesve dhe shqyrtimin e rasteve të korrupsionit brenda institucionit mbetet një sfidë kyçe për forcimin e integritetit dhe llogaridhënies. Aktualisht, mungesa e zhvillimeve në këtë drejtim tregon nevojën për një qasje më aktive në monitorimin dhe zbatimin e masave të parashikuara. Një nga problemet kryesore është niveli i ulët i sinjalizimeve, i cili vjen si pasojë e mungesës së besimit tek mekanizmat e mbrojtjes së sinjalizuesve dhe frikës nga pasojat e mundshme. Për të përmirësuar këtë situatë, është e rëndësishme të rritet transparenca e procedurave hetimore, të forcohet rregullorja për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe të sigurohet një proces efektiv dhe i besueshëm për trajtimin e rasteve të korrupsionit. Gjithashtu, përfshirja e trajnimeve të detyrueshme mbi etikën dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve të padrejta, si dhe ngritja e pikave të dedikuara për raportim, mund të ndihmojnë në rritjen e numrit të sinjalizimeve dhe ndjekjen e vazhdueshme të tyre. Vetëm përmes një zbatimi të plotë dhe të vazhdueshëm të dokumenteve strategjike, KLJGJ mund të forcojë integritetin dhe besueshmërinë e sistemit të drejtësisë.

Ndërkohë për shkak të rasteve në rritje të presionit publik dhe përpjekjeve për të ndikuar në pavarësinë e magjistratëve, KLGJ dhe KLP kanë ndërmarrë masa për të mbrojtur integritetin e sistemit të drejtësisë. KLGJ ka reaguar me deklarata publike dhe ka trajtuar kërkesa të gjyqtarëve për mbrojtje nga ndikimi i padrejtë, duke vepruar mbi raste të identifikuar ose raportuara në media. Ndërkohë, KLP ka mbrojtur publikisht SPAK-un nga sulmet dhe përpjekjet për intimidim, duke theksuar rëndësinë e respektimit të procedurave ligjore për çdo kundërshtim ndaj veprimtarisë së prokurorëve. Të dy institucionet duhet të vijojnë të forcojnë mekanizmat mbrojtës dhe të garantojnë një sistem drejtësie të paanshëm dhe të mbrojtur nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme.

Gjithashtu një proces i rëndësishëm është edhe shorti për ndarjen e rastësishme të çështjeve. Një nga problemet kryesore me përdorimin e shortit për ndarjen e rastësishme të çështjeve është mundësia e manipulimit ose përjashtimit të qëllimshëm të gjyqtarëve nga procesi i shortimit, duke ndikuar kështu në paanshmërinë dhe transparencën e gjykimit. Ndërhyrjet e mundshme përfshijnë shmangien e gjyqtarëve të caktuar për çështje specifike, keqpërdorimin e çelësave të sigurisë, mospërfshirjen e të gjithë kandidatëve të mundshëm në short, apo edhe dobësi në auditimin dhe monitorimin e sistemit. Këto problematika rrezikojnë të minojnë besimin në sistemin gjyqësor dhe të krijojnë hapësira për ndikime të jashtme mbi procesin e drejtësisë. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokuroria e Përgjithshme duhet të marrin masa të forta për të garantuar një mekanizëm të besueshëm dhe të pandryshueshëm të shortimit, duke përmirësuar auditimin automatik, transparencën e sistemit dhe rritjen e kontrollit mbi procesin për të shmangur çdo devijim apo abuzim të mundshëm.

ILDKPKI ka vijuar administrimin e deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë të magjistratëve nëpërmjet sistemit elektronik EACIDS dhe në format shkresor, në përputhje me ligjin. Gjatë vitit 2024, janë kryer kontrole të plota për 53 subjekte dhe janë referuar 5 raste pranë organeve ligjzbatuese për dyshime mbi elementë penalë. Për shkak të kompleksitetit të çështjeve dhe afatit të shkurtër nga momenti i referimit, proceset hetimore mund të mos jenë përmbyllur ende. Prandaj, është thelbësore që këto referime të ndiqen me rigorozitet, për të siguruar transparencë dhe efektivitet në zbatimin e ligjit.

Nga ana tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka vijuar përpjekjet për fuqizimin e kapaciteteve të tij përmes trajnimeve dhe rekrutimeve të reja, duke synuar përmirësimin e efikasitetit dhe profesionalizmit në procesin e inspektimit. Në lidhje me rekrutimin e inspektorëve jomagjistratë, është vënë re një interes i lartë, me 19 kandidatë që kanë aplikuar për 4 pozicionet e shpallura, ndërkohë që procesi i verifikimit të kriterëve dhe përzgjedhjes është ende në vijim. Ky interes tregon dukshëm se pozicioni i inspektorit në ILD tashmë është bërë më tërheqës, megjithatë sfidat mbeten në lidhje me plotësimin e vakancave të inspektorëve magjistratë. Aktualisht, 6 pozicione të inspektorëve magjistratë mbeten të paplotësuar, duke ndikuar në numrin e inspektimeve të planifikuara dhe efektivitetin e institucionit. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokuroria e Përgjithshme duhet të marrin masa për të lehtësuar procesin e komandimit dhe rekrutimit të magjistratëve në ILD, duke siguruar jo vetëm përmbushjen e kriterëve ligjore, por edhe angazhimin e magjistratëve me përvojë dhe integritet të lartë. Për më tepër, nevojiten ndryshime ligjore që do të mundësonin një proces më efikas dhe tërheqës për magjistratët, si dhe masa shtesë për forcimin e kapaciteteve të inspektimit,

promovimin e imazhit publik të inspektorëve dhe sigurimin e një procesi të qëndrueshëm rekrutimi.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Tretë Politik “Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë”, konstatohet se:


Sistemi gjyqësor po përballë me një mungesë të konsiderueshme të gjyqtarëve dhe stafit administrativ, duke ndikuar në efikasitetin dhe cilësinë e drejtësisë. Të dhënat tregojnë se vetëm 73.6% e pozicioneve në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm janë të mbuluara, ndërsa për Gjykatat e Apelit kjo

shifër bie ndjeshëm në 35.8%, duke krijuar një mungesë kritike të gjyqtarëve në nivelin e dytë të gjykimit. Situata është edhe më alarmante për stafin administrativ, ku vetëm 28.9% e vendeve të planifikuara janë të plotësuara. KLGJ ka ndërmarrë hapa për të adresuar këtë problem përmes rekrutimeve dhe propozimeve për rritjen e numrit të gjyqtarëve, megjithatë, mungesa e miratimit të pozicioneve shtesë në buxhetin e vitit 2024 pengon një zgjidhje efektive. Ndikimi i kësaj problematike reflektohet në ngarkesën e lartë të çështjeve të prapambetura dhe në zgjatjen e proceseve gjyqësore, duke vënë në rrezik aksesin në drejtësi dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Rritja e burimeve njerëzore dhe financiare mbetet një domosdoshmëri për të siguruar një funksionim efikas dhe të drejtë të gjykatave.

Në KLGJ, me vendimin nr. 251, datë 09.05.2024, ka miratuar Strategjinë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (2024-2027). Strategjia përmban masa konkrete ligjore dhe administrative, me synimin e adresimit të faktorëve që shkaktojnë akumulimin e çështjeve dhe reduktimin gradual të tyre brenda tre viteve të ardhshme.

Ndërkohë me vendimet nr. 184 dhe nr. 186, datë 31.07.2024, Këshilli i Lartë i Prokurorisë finalizoi procesin e plotësimit të dy vakancave për prokurorë në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Me emërimin e tyre, kjo strukturë arriti kapacitetin e saj të plotë funksional, në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 6/2021, sipas të cilit numri i përgjithshëm i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme është 20. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve institucionale të SPAK, duke garantuar një funksionim më efikas dhe të konsoliduar të mekanizmave të drejtësisë penale në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Bashkëpunimi ndërinstitutional në drejtësinë penale mbetet një sfidë që ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe në besimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë. Vonesat e shkaktuara nga mungesa e koordinimit midis institucioneve përgjegjëse rrezikojnë



efektivitetin e dënimeve dhe masave alternative, duke cënuar si parandalimin ashtu edhe rehabilitimin. Për të siguruar një sistem më efikas dhe të besueshëm, është thelbësore forcimi i procedurave, rritja e mbikëqyrjes dhe respektimi i afateve ligjore nga të gjitha palët e përfshira.

Dizenjimi dhe implementimi i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS) është një hap i rëndësishëm në dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë, me synimin për të rritur transparencën, efikasitetin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Gjatë periudhës raportuese, Grupi Ndërinstitucional i Punës ka përfunduar draft-Udhërrëfyesin për dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë, duke përfshirë konsultime të gjera me institucionet përkatëse dhe ekspertë ndërkombëtarë. Dokumenti aktualisht është në pritje të komenteve mbi buxhetin e parashikuar, i cili pritet të financohet nga fondet IPA III të BE-së.

Megjithëse është bërë përparim i rëndësishëm, sfidat mbeten të ndjeshme, duke përfshirë sigurimin e fondeve të nevojshme, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe sigurimin e një bashkëpunimi efektiv midis aktorëve të drejtësisë. Vonesat në zbatimin e projektit mund të ndikojnë në funksionalitetin e tij dhe të shtyjnë përfitimet që sjell për qytetarët dhe administratën gjyqësore. Për të garantuar një implementim të suksesshëm, kërkohet një angazhim i vazhdueshëm institucional, një koordinim i mirëfilltë dhe adresimi i pengesave teknike dhe ligjore që mund të shfaqen gjatë procesit të zbatimit.


Në drejtim të zbatimit të sistemeve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, mbetet sfida rritja e kapaciteteve të DHKN-së, rritja e numrit të rasteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë alternative, dhe gjetja e mekanizmave për ta bërë ndërmjetësimin më të aksesueshëm, përveç kerkimit dhe aplikimit të praktikave më të mira evropiane.

Ndërkohë Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për periudhën 2024-2030. Në bashkëpunim me ASPA dhe organizata ndërkombëtare si OSBE dhe Expertise France, janë zhvilluar trajnime për përmirësimin e shërbimeve, duke përfshirë tematika si të drejtat pronësore të grave dhe komunikimi me qytetarët. Po ashtu, DNJF ka propozuar ndryshime në aktet nënligjore për të përmirësuar cilësinë e ndihmës juridike falas dhe ka zhvilluar aktivitete për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre ligjore. Këto iniciativa synojnë garantimin e aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët si një ndër synimet kryesore të sistemit të drejtësisë.

Për sa i përket Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, ai përballet me mbingarkesë të lartë të dosjeve, ku një përmbarues mund të ketë mesatarisht 1,500 çështje për ekzekutim, duke shkaktuar vonesa të mëdha dhe mosrespektim të afateve procedurale. Kjo rëndesë operationale pengon efektivitetin dhe rrit rrezikun e moszbatimit të vendimeve gjyqësore. Një tjetër problem thelbësor janë boshllëqet ligjore dhe mungesa e praktikave të unifikuara, të cilat krijojnë paqartësi në ekzekutimin e vendimeve dhe trajtime të ndryshme të rasteve. Mungesa e rregulloreve të qarta dhe interpretimet e ndryshme ligjore e bëjnë procesin e përmbarimit joefikas dhe të pasigurt për palët e përfshira.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Katërt Politik “Forcimi i cilësisë së drejtësisë”, konstatohet se:

Po vijon implementimi me sukses i hartës së re gjyqësore, me ngritjen e 13 Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Megjithatë, infrastruktura në zbatim të hartës së re gjyqësore nuk është e siguruar, pasi ka probleme me miratimin e shesheve të ndërtimit nga ana e bashkive për godinat e reja të gjykatave dhe ky problem vazhdon që nga periudhat e mëparshme raportuese.



Gjykata Kushtetuese po përballlet me mungesë të theksuar të këshilltarëve

ligjorë magjistratë, duke ndikuar në efikasitetin e saj. Sipas organikës, duhet të ketë 24 këshilltarë, nga të cilët 12 duhet të jenë magjistratë, por aktualisht ka vetëm 12 jo-magjistratë. Përpjekjet për të komanduar magjistratë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë dështuar për shkak të mungesës së interesit nga gjyqtarët. Si zgjidhje, synohet ndryshimi i ligjit për të ulur pragun e magjistratëve të kërkuar nga 50% në 20%, duke mundësuar punësimin e më shumë këshilltarëve jo-magjistratë për të përballuar ngarkesën e lartë të çështjeve.

Ndërkohë Shkolla e Magjistraturës ka realizuar një rishikim të plotë të rregullores dhe strukturës së provimit, duke synuar përmirësimin e vlerësimit dhe procesit të testimit. Ky rishikim përfshin risitë në mënyrën e testimit të aftësive të kandidatëve, si dhe organizimin e aktiviteteve trajnimi për t’i përgatitur ata më mirë për provimet. Pjesë e këtij përmirësimi është dhe projekti i Binjakëzimit, i cili kontribuon në zhvillimin e provimit hyrës dhe fazës së dytë të provimit.


Në vitin 2024, Shkolla e Magjistraturës nisi procesin e analizës së nevojave për trajnimin e magjistratëve, duke bashkëpunuar me institucione të ndryshme të drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë për të identifikuar temat dhe kërkesat e specializimit. Programi i Formimit Vazhdues u zhvillua duke marrë parasysh nevojat e sistemit dhe legjislacionin e ri, duke përfshirë aktivitete trajnuese për tema të ndryshme si korrupsioni, hetimi financiar, dhe të drejtat themelore. Shkolla ka përmirësuar gjithashtu metodat e vlerësimit dhe trajnimin e trajnuesve, duke u fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve të magjistratëve dhe përgatitjen e tyre për sfidat e reja ligjore. Ky proces është i orientuar për të siguruar një formim të qëndrueshëm dhe të përshtatur me kërkesat e integritetit evropian dhe standardet ndërkombëtare.

Ndërkohë, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Gjykata e Lartë (GJL) kanë përmirësuar bashkërisht sistemet e tyre online. KLGJ ka modernizuar portalin e saj për të siguruar publikimin dhe aksesin në informacionin gjyqësor, duke përfshirë të dhëna për kalendarin e seancave, shortin dhe vendimet gjyqësore. Ky portal është përditësuar me mbështetje të legjislacionit të ri dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian. KLGJ gjithashtu siguron

publikimin e vendimeve anonimizuara, duke siguruar transparencë dhe mbrojtje të privatësisë. Gjykata Kushtetuese (GjK) ka përfunduar procesin e ri-dizenjimit të faqes së saj zyrtare, duke ofruar një databazë të avancuar për kërkimin e vendimeve me fjalë kyçe. Kjo faqe e re ka për qëllim përmirësimin e aksesit të përdoruesve në informacion mbi çështjet, seancat dhe veprimtarinë e Gjykatës, dhe do të jetë funksionale nga janari 2025. Për një periudhë tranzitore prej 6 muajsh, faqja e vjetër do të qëndrojë gjithashtu aktive.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Pestë Politik “Drejtësi më e afërt me qytetarët”, konstatohet se:

Gjatë vitit 2024, DNJF ka përmbushur një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimin e publikut për sistemin e ndihmës juridike. Për këtë qëllim, janë realizuar aktivitete informuese dhe janë mundësuar materiale të rëndësishme si manuale udhëzuese, përfshirë manualin në gjuhën Braille. Kjo ka përfshirë mbi 640 aktivitete, me një fokus të veçantë te kategoritë vulnerabël, në 51 bashki të vogla, dhe përbashkimin e përpjekjeve për të arritur në më shumë qytetarë për vitin 2025.



Përveç aktiviteteve informuese, një arritje e rëndësishme e DNJF ka qenë zhvillimi i një analize për përmirësimin e ndërgjegjësimit mbi sistemin e ndihmës juridike. Kjo analizë ka ofruar një udhëzues për konceptimin e aktiviteteve të ardhshme dhe ka theksuar rëndësinë e shtrirjes së aktiviteteve në të gjitha bashkitë, duke siguruar mbështetje për ata që kanë më shumë nevojë. Këto përpjekje janë realizuar përmes bashkëpunimit me media dhe një sërë aktiviteteve të ndërgjegjësimit që synojnë të arrijnë një audiencë më të gjerë dhe t'i japin mundësi çdo qytetari të përfitojë nga shërbimet e ndihmës juridike.

Në vitin 2024, Ministria e Drejtësisë (MD) zhvilloi aktivitete të rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve mbi procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të drejtat themelore dhe aksesin në drejtësi. Panairët informuese, si ai në Sheshin Skënderbej për Ditën e Rinisë, dhe aktivitetet e tjera edukative si stenda në Ministrinë e Drejtësisë, ofruan mundësi për qytetarët, veçanërisht të rinjtë, për të marrë informacion të vlefshëm mbi Bashkimin Evropian dhe të drejtat e tyre. Aktivitetet përfshijnë shpërndarjen e librave, broshurave dhe QR kodeve, duke nxitur përfshirjen aktive të rinisë në proceset

integruese dhe duke theksuar rëndësinë e njohjes së të drejtave të njeriut dhe angazhimeve të Shqipërisë për forcimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave procedurale.

Zyra e Komisionerit ka realizuar aktivitete ndërgjegjëse dhe edukuese për publikun mbi legjislacionin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Këto përfshijnë trajnime për zyrtarët dhe aktivitete informuese me nxënës dhe mësues. Zyra ka realizuar raportet monitoruese për zbatimin e legjislacionit në institucione të ndryshme dhe ka promovuar njohuritë mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Aktivitetet synojnë balancimin e sigurisë dhe privatësisë në përputhje me ligjet dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Në kuadër të forcimit të komunikimit dhe transparencës për të rritur mirëkuptimin dhe besimin e publikut në Reformën në Drejtësi dhe sistemin e drejtësisë, institucionet e sistemit të drejtësisë kanë ndërmarrë hapa konkretë për të siguruar një pasqyrë të qartë dhe transparente mbi aktivitetet dhe vendimet e tyre. Këto përpjekje synojnë përmirësimin e marrëdhënieve me qytetarët dhe median, duke u fokusuar në ofrimin e informacionit të përditësuar dhe të kuptueshëm, për të rritur besimin dhe transparencën. Ky proces kontribuon në forcimin e sistemit të drejtësisë dhe krijimin e një lidhjeje më të ngushtë mes institucioneve dhe shoqërisë civile, duke e bërë këtë sistem më të besueshëm dhe të aksesueshëm për qytetarët.

Në vijim, SND dhe dokumentet e saj strategjike do të monitorohen me bazë 6-mujore për të mundësuar përmirësimin e performancës nga institucionet dhe një raport të orientuar drejt rezultateve. Raportet do të pasqyrojnë situatën aktuale të sistemit dhe institucioneve të drejtësisë, si dhe nevojat dhe prioritetet e institucioneve në kuadër të integritetit në BE.

I. INFORMACION PËRMBLEDHËS

1.1. Hyrje

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030 (SND 2024-2030) dhe dokumentet e saj strategjike si Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve u miratuan në vitin 2024, me VKM nr. 787, datë 18.12.2024 dhe zbatimi i saj nisi menjëherë, si një përgjigje e ushtrimit të përgjegjësiwe institucionale për jetësimin e Reformës në Drejtësi.

Raporti Vjetor i Monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2024, mbi zbatimin e SND 2024-2030, është raporti i parë i monitorimit të zbatimit të SND 2024-2030.

. Raporti përmbledh të dhëna dhe analiza nga institucione në sektorin e drejtësisë. Të gjitha institucionet e pavarura të drejtësisë dhe disa 25 institucione nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë kanë kontribuar në zbatimin e SND.

Tashmë, zbatimi i strategjisë së tretë ndërsektoriale të drejtësisë, ka shënuar arritje të rëndësishme dhe inkurajuese në drejtim të konsolidimit të pavarësisë së institucioneve të drejtësisë, efikasitetit, rritjes së transparencës, forcimit të besimit të publikut, si dhe përmirësimit të mëtejshëm të infrastrukturës të gjithë hallkave të sistemit të drejtësisë nëpërmjet zbatimit të masave konkrete. Strategjia do të synojë vazhdojë konsolidimin e këtyre arritjeve edhe për periudhën 2024-2030 në kuadër të Integritetit Europian, ku Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” pjesë e Grupkapitullit 1 “Themeloret” luan një rol kyç. Sukseset e fushës së drejtësisë konfirmohen gjithashtu, edhe nga gjetjet e Progres Raportit të Komisionit Evropian, korrik 2024, ku theksohet se Shqipëria ka bërë një progres të mirë me zbatimin e Reformës në Drejtësi si dhe me hapjen e Grupkapitullit 1 “Themeloret” në Konferencën e Dytë Ndërqeveritare me 15 Tetor 2024.

Nën dritën e rekomandimeve, në kuadër të procesit të negociatave të anëtarësimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, ky raport ka një rëndësi të vecantë për të reflektuar sfidat e Agjendës 2030 dhe për të vendosur piketat e procesit të zbatimit të Strategjisë së re Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030.

Gjatë shtatë viteve të zbatimit të saj, SND 2024-2030 parashikon realizimin e 22 Objektivave Specifike, 139 masave dhe 511 aktiviteteve, të ndara në pesë qëllime politike. Arritjet dhe sfidat kryesore në sektorin e drejtësisë maten përmes 35 treguesve, të përfshirë në Pasaportën e Treguesve. Në këtë raport janë marë në analizë:

■ 22 Ojektiva Specifikë

■ 99 masa dhe 240 aktivitete për tu zbatuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2024

Raporti paraqet gjithashtu një analizë të detajuar mbi zbatimin e 35 indikatorëve të parashikuar në Pasaportën e Treguesve, lidhur me secilin Qëllim Politik dhe Objektiv Specifik. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të këtij Raporti, paraqiten si më poshtë.

1.2. Përmbledhje e arritjeve dhe sfidave kryesore

Në tabelën më poshtë listohen disa konkluzione të përgjithshme lidhur me arritjet dhe sfidat në sektorin e drejtësisë bazuar në gjetjet dhe analizat për periudhën raportuese janar-dhjetor 2024. Tabela e konkluzioneve është ndarë sipas Qëllimeve të Politikës.

Qëllimi Politik I	
Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standartet Evropiane.	
Arritjet	Sfidat
- Hapja e grupkapitujve të parë dhe të gjashtë në negociatat për anëtarësim në BE pasqyron progresin e Shqipërisë në reformat kyçe dhe përafrimin me politikën e jashtme të BE-së. (shih objektivin 1.1) - Si pjesë e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, është miratuar Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030, e cila vazhdon përparimin e strategjisë së mëpaarshme duke adresuar problemet ekzistuese dhe duke integruar zhvillimet e nevojshme në sistemin e drejtësisë, në përputhje me "Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës". (Shih objektivin specifik 1.1) - Përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar nga KPK me 805 vendime tregon një arritje të madhe për procesin e vettingut sepse përforcon integritetin dhe transparencën në sistemin e drejtësisë. (shih objektivat 1.1 & 1.2) - Plotësimi i numrit të prokurorëve në SPAK me dy emërime të reja garanton funksionimin e plotë të strukturës dhe fuqizon luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. (shih objektivat 1.1 & 3.3) - Numri i referimeve nga KPK pranë SPAK për hetim tregon angazhimin për forcimin e llogaridhënies dhe integritetit në drejtësi. (shih objektivin 1.2) - Miratimi i akteve nënligjore nga KLP synon sigurimin e një procesi tërësisht të rregullt dhe transparent për vlerësimin e prokurorëve gjatë periudhës 2024-2025. (shih objektivin 1.3) - Mbledhja e përbashkët mes KLGJ dhe KLP synon rritjen e bashkëpunimit ndërmjet këshillave i cili solli miratimin e një rregulloreje të re për bashkimin e procedimeve disiplinore për	- Miratimi i Kodit Penal në përputhje me <i>acquis</i> dhe rekomandimet e Screening Report lidhur me fushën penale dhe kriminalitetin. (Shih objektivin masën 1.1.2) - Prokuroria e Posaçme përballat me mungesë të këshilltarëve ligjorë, duke ndikuar në efektivitetin e ndjekjes së çështjeve dhe rekrutimi mbetet i vonuar për shkak të nevojës për ndryshime ligjore. Kalimi i kompetencave të Komisionerit Publik të Drejtësisë i SPAK në janar 2025 e ka rënduar këtë situatë me ngarkesën e shtuar. (shih masën 1.1.10). - Mungesa e kryetarit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar ka krijuar një vakum në drejtësi, duke ndikuar në efikasitetin administrativ dhe shpërndarjen e ngarkesës së punës. KLGJ duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të adresuar këtë boshllëk (shih masën 1.1.13). - Ndryshimet ligjore të ligjeve të reformës në përputhje me analizat dhe propozimet e institucioneve të pavarura të drejtësisë dhe aktorëve të tjerë përkatës për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me zbatimin e disa ligjeve (dispozitave apo plotësimit të boshllëqeve të krijuara për shkak të sfidave të reja në zbatimin e ligjeve të reformës). (shih objektivin 1.1) - Në përputhje dhe me rekomandimet e Screening Report, emërimi i profesorëve të shkollës së magistraturës duhet të marrë parasysh plotësimin e kriterëve profesionalë dhe etikë në mënyrë që të shmanget emërimi i magistratëve të shkarkuar nga vetting-u. Krijimi i modeleve pozitivë në përgatitjen e magistratëve të rinj. (Shih masën 1.1.11)

gjyqtarët dhe prokurorët e përfshirë në të njëjtën shkellje. (shih objektivin 1.4)	
--	--

Qëllimi Politik II Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë	
Arritjet • KLGJ dhe KLP kanë vijuar me vlerësimin e magjistratëve për pasurinë dhe figurën, duke siguruar që gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar apo të promovuar të jenë në përputhje me standardet e rivlerësimit dhe vendimet e vetëgjyqësorisë, çka përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e integritetit në sistemin e drejtësisë. (shih masën 2.1.1) • Në përgjigje të tentativave për të ndikuar magjistratët, KLGJ dhe KLP kanë marrë masa konkrete për mbrojtjen e tyre, përfshirë reagime publike dhe mbështetje institucionale për SPAK, duke kontribuar në mbrojtjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe forcimin e besimit publik. (shih masën 2.2.2) • ILDKPKI ka referuar raste të dyshuara për elementë penalë pranë organeve ligjzbatuese, duke forcuar mekanizmat e kontrollit mbi deklarinë e pasurisë dhe interesave privatë të magjistratëve, megjithatë mbetet e nevojshme ndjekja rigoroze e këtyre rasteve për të garantuar transparencë dhe efektivitet në luftën kundër korrupsionit. (shih masën 2.4.1)	Sfidat • Mungesa e gjyqtarëve dhe stafit administrativ ka ulur ndjeshëm efikasitetin e gjykatave. KLGJ duhet të intensifikojë përpjekjet për të adresuar këtë problem, duke përsheptuar rekrutimet (shih masat 2.1.2 & 3.1.3). • Ndërmarrja nga ana e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP) e masave të cilat sigurojnë vijueshmërinë e standarteve të procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve, edhe pas përfundimit të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbetet një sfidë e cila duhet adresuar në të ardhmen. (shih objektivin 2.1) • KLGJ dhe Prokuroria e Përgjithshme duhet të garantojnë integritetin e mekanizmit të shortimit përmes përmirësimeve teknologjike dhe rritjes së kontrollit mbi procesin me një theks të shtuar tek eliminimi i rasteve të shortimit manual (shih masën 2.3.2). • Plotësimi i vakancave të inspektorëve magjistratë dhe jo-magjistratë, por vecanërisht plotësimi i pozicioneve të inspektorëve magjistratë në ILD. (shih masën 2.5.2). • Ndërmarrja nga ana e ILD-së, brenda vitit 2024 dhe 2025 në bashkëpunim me partnerët dhe me institucionet e tjera masa lidhur me forcimin e kapaciteteve të inspektimit: ▪ promovimin e imazhit publik të inspektorëve; ▪ hapja e thirrjeve me qëllim tërheqjen e inspektorëve të profilin të lartë; ▪ Rekrutimin e inspektorëve me inspektorë të profilin të lartë. (shih objektivin 2.5) • Niveli i ulët i sinjalizimeve për korrupsion tregon mungesën e besimit në mekanizmat mbrojtës. Është thelbësore të forcohet transparenca e procedurave hetimore, të rritet mbrojtja e sinjalizuesve dhe të implementohen masa për rritjen e raportimeve (shih masën 2.5.5).

--	--

Qëllimi Politik III Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë	
Arritjet - Hartimi i një strategjie të mirëfilltë dhe një plan veprimi me masa konkrete, për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura mund të konsiderohet si një hap pozitiv për krijimin e hapësirave për uljen e backlogut dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjeve gjyqësore. (shih masën 3.1.2) - Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka vijuar me forcimin e kapaciteteve të saj duke investuar në burime njerëzore dhe infrastrukturë, si dhe ka zhvilluar trajnime në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, duke përmirësuar cilësinë dhe aksesin në shërbimet juridike për grupet në nevojë. (shih objektivin 3.6)	Sfidat - Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (shmangja e backlog-ut) nëpërmjet zbatimit të “Strategjisë Kombëtare të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata 2024-2027”. (shih masën 3.1.2) - Bashkëpunimi ndërinstitucional për të respektuar afatet ligjore për ekzekutimin e vendimeve mbetet sfida. (shih masat 3.1.6 & 3.2.6). - Në drejtim të zbatimit të sistemeve alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbetet sfida puna në disa drejtime: a) rritja e kapaciteteve të DHKN; b) rritja e numrit të rasteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë alternative; c) gjetja e mekanizmave për ta bërë ndërmjetësimin më të aksesueshëm; d) kërkim dhe aplikim i praktikave më të mira europiane. (shih objektivin 3.4) - Dixhitalizimi i sistemit të drejtësisë dhe vënia në funksion e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve, nëpërmjet: - plotësimit të vakancave, rritjes së kapaciteteve, amendamenteve ligjore etj. - bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve. - sigurimit të buxheteve të nevojshme për vënien në funksion të Sistemit. (shih masën 3.5.2). - Ndërtimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve dhe dixhitalizimi i vendimarrjes së Gjykatës Kushtetuese. (Shih masën 3.5.11) - Mbingarkesa e dosjeve për përmbaruesit gjyqësorë dhe boshllëqet ligjore kanë krijuar vonesa serioze në ekzekutimin e vendimeve. Përmirësimi i procedurave dhe unifikimi i praktikave do të ndihmonte në rritjen e efikasitetit të sistemit të përmbarimit (shih masën 3.6.14).

--	--

Qëllimi Politik IV Forcimi i cilësisë së drejtësisë	
Arritjet - Shkolla e Magjistraturës ka rishikuar rregulloren dhe strukturën e provimit të pranimit, duke e bërë procesin më rigoroz dhe të bazuar në aftësitë reale të kandidatëve, një hap kyç për garantimin e profesionalizmit të brezave të rinj të magjistratëve. (shih masën 4.3.1) - Në kuadër të përmirësimit të formimit të vazhduar, Shkolla e Magjistraturës ka analizuar nevojat për specializim, ka përditësuar programet trajnuese sipas legjislacionit të ri dhe ka rritur kapacitetet e magjistratëve për t'u përballur me sfida të reja ligjore, duke siguruar një sistem drejtësie më të përgatitur dhe të pavarur. (shih masën 4.3.5) - Gjykata Kushtetuese, KLGJ dhe Gjykata e Lartë kanë modernizuar platformat e tyre online, duke përmirësuar ndjeshëm aksesin e publikut në praktikat gjyqësore dhe duke siguruar transparencë më të madhe në vendimmarrje, një hap i rëndësishëm drejt forcimit të besimit të drejtësisë. (shih objektivin 4.4)	Sfidat - Pavarësisht përparimit në implementimin e hartës së re gjyqësore, infrastruktura e nevojshme për zbatimin e saj mbetet e pamjaftueshme. Problemet me miratimin e shesheve të ndërtimit nga bashkitë po krijojnë vonesa të konsiderueshme (shih masën 4.1.2). - Gjykata Kushtetuese ka një mungesë të theksuar të këshilltarëve ligjorë magjistratë. Përpjekjet për komandimin e tyre kanë dështuar për shkak të mungesës së interesit, duke e bërë të nevojshme ndryshimin e ligjit për të ofruar stimuj më tërheqës për magjistratët (shih masën 4.1.3).

Qëllimi Politik V Drejtësi më e afërt me qytetarët.	
Arritjet Sa i takon arritjes së objektivit “Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e drejtësisë përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave inovative të komunikimit” konstatohet progres i dukshëm nëpërmjet organizimit të fushatave ndërgjegjëse, materialeve promovuese, ndërtimit dhe përmirësimit të ëëbsite informativ dhe i aksueshëm	Sfidat Institucionet e drejtësisë duhet të rrisin më tepër transparencën dhe përmirësojnë mënyrat e qasjes së publikut në informacion, përmes digjitalizimit, publikimeve të rregullta dhe strategjive efektive të komunikimit, me qëllim forcimin e besimit të sistemi gjyqësor dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi reformat dhe vendimmarrjet në drejtësi. (shih objektivin 5.2)

për të gjitha grupet vulnerabël nga DNJF. (shih masën 5.1.11) - Ministria e Drejtësisë ka organizuar aktivitete ndërgjegjëse mbi integrimin evropian, të drejtat e njeriut dhe aksesin në drejtësi, duke përfshirë panairë dhe fushata informuese që synojnë informimin e qytetarëve, veçanërisht të rinisë, mbi rëndësinë e sundimit të ligjit. (shih masat 5.1.12 & 5.3.1) - Zyra e Komisionerit ka zhvilluar aktivitete edukuese për rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke trajnuar zyrtarë dhe grupe të ndryshme shoqërore për të forcuar zbatimin e ligjit dhe respektimin e privatësisë në përputhje me standardet evropiane. (shih masën 5.2.2) - Institucionet e drejtësisë kanë intensifikuar përpjekjet për rritjen e transparencës dhe komunikimin me publikun, duke forcuar besimin në Reformën në Drejtësi dhe duke krijuar një lidhje më të fortë midis sistemit gjyqësor dhe qytetarëve, në përputhje me standardet demokratike dhe të integritetit evropian. (shih masën 5.2.7)	
---	--

1.3. Metodologjia

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor të mundësojë udhëzimet e nevojshme për lehtësimin në kuptueshmërinë e tij, si dhe të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore për të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim.

Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritje konkrete, Ministria e Drejtësisë realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në Planin e Veprimit, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të rezultateve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit.

Kështu, gjatë periudhës hartuese, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm (verbal dhe zyrtar) në varësi të specifikave për plotësimin e dokumentave raportues me disa prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit, të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në veprimtarinë e tyre, gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilët kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Ky sektor kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SND 2024-2030) për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2024, është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe bashkëpërgjegjëse të planit të veprimit.

Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët sigurojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SND-së për 7 vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në linkun: <https://drejtesia.gov.al/plani-i-veprimit-te-strategjise-ndersektorale-te-drejtesise/>

Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS miratuar me vendimin nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS).

Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me Parimet e Mirëqeverisjes

Ky raport është hartuar përputhje me Parimet e Mirëqeverisjes të cilët përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi. Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA).

- **Efikasiteti:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i monitorim/vlerësimit duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit.
- **Llogaridhënia:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit/vlerësimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **Rëndësia:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e monitorimit/vlerësimit duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, periudhës dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin informacion për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme.

Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- kërkesa për kontribut u dërgua në datë 06.01.2025 tek të gjitha institucionet raportuese në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;
- publikimi në faqen zyrtare të internetin të Ministrisë së Drejtësisë dhe dërgimi tek të gjitha institucionet e përfshira në strategji me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve më datë 01.04.2025;
- konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella;
- organizimi i mbledhjes së Ekipit Tematik për Reformën në Drejtësi me qëllim miratimi i raportit të monitorimit më datë xxxxx 2025;
- publikimi i Raportit Vjetor të Monitorimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;
- dërgimi i procedurave të mbledhjes të Ekipit Tematik (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) dhe paketa finale, së bashku me linkun e publikimit për njohje SASPAC.

Metodologjia e analizimit të të dhënave për Raportin e Monitorimit dhe Performancës

Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur grafikë, dashboards, analiza të thelluara, edhe vizualisht përmes tabelave. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Qëllimet e Politikave dhe Objektivet Specifikë.

Analiza mbi progresin e realizimit të Qëllimeve Politike ndjek një qasje të strukturuar. Progresi lidhur me secilin Qëllim Politik është analizuar në përgjithësi sipas Objektiveve Specifikë (OS) përkatës. Në vijim, për secilin OS është paraqitur një përmbledhje e rezultateve sasiore dhe cilësore të zbatimit të masave përkundrejt kryerjes së veprimeve për realizimin e tyre nga institucionet përgjegjëse, analiza e risqeve dhe veprimeve për adresimin e tyre (sipas rastit) dhe analiza e treguesve të performancës, nëse kjo ka qënë e mundur mbi bazën e të dhënave të paraqitura nga institucionet përgjegjëse.

Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin a masave ndjek numërimin e Planit të Veprimit dhe është paraqitur me sfond me ngjyrë sipas nivelit të zbatimit (*të zbatuara plotësisht/ të zbatuara pjesërisht/ të pazbatuara/ të pazbatueshme*). Disa masa rezultojnë të pazbatueshme dhe janë paraqitur me sfond të bardhë. Ato përfshijnë: (i) masat afati i zbatimit i të cilave fillon pas periudhës aktuale të raportimit; (ii) masa të cilat nuk mund të zbatohen nga institucioni raportues për arsye të cilat nuk varen nga institucioni (p.sh. mungesë e kompetencave).

Përcaktimi i nivelit të zbatimit të masave (në përqindje) është ai i raportuar nga secili institucion përgjegjës, dhe është evidentuar në kontributet e përcjella prej tyre mbi çdo masë të përcaktuar. Shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar si më poshtë:

- **E zbatuar:** masa e cila është përmbushur plotësisht;
- **Pjesërisht e zbatuar/Në proces:** masa e cila në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijon të jetë në zbatueshmëri.
- **E pazbatuar:** masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese.

➤ **Përcaktimi i nivelit të realizimit të treguesve të performancës** është përllogaritur përkundrejt targetit të vendosur për vitin 2024 në Pasaportën e Treguesve.

Në rastin e *treguesve me trend në rritje* (si p.sh. numri i masave administrative ndaj subjekteve të organeve gjyqësore, si rezultat i kontrolleve te plota të kryera ndaj tyre) ku synohet që vlera e raportuar të jetë e barabartë ose më e lartë se targeti, niveli i realizimit të targetit është përllogaritur si raporti midis vlerës së raportuar (R) dhe targetit (T), e shprehur në përqindje ($R/T \cdot 100\%$).

Në rastin e *treguesve me trend në zbritje* (si p.sh. numri mesatar i çështjeve për prokuror.) ku vlera më të ulëta se targeti konsiderohen arritje pozitive, niveli i realizimit të targetit është përllogaritur si raporti midis targetit (T) dhe vlerës së raportuar (R), e shprehur në përqindje ($T/R \cdot 100\%$).

Kur vlera e raportuar është zero (0), edhe përqindja e realizimit të targetit është konsideruar zero (0).

▪ **Përcaktimi i nivelit të realizimit të OS** është përllogaritur në dy mënyra.

Së pari, është analizuar realizimi i Objektivit Specifik si mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave përkatëse. Analiza në nivelin e mesatares së përqindjes së zbatimit të masave pasqyron në mënyrë më të drejtpërdrejtë arritjet lidhur me Objektivat Specifikë në vitin 2024, në krahasim me analizën mbi treguesit. Të dhënat e disponueshme mbi treguesit e performancës – mungesa e tyre në disa raste – nuk mundësojnë një analizë të përgjithshme të harmonizuar për të gjithë OS. Shkalla e realizimit të OS është përcaktuar në bazë të intervalit:

- **I zbatuar:** mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave në vlerën 100%;
- **Pjesërisht i zbatuar:** mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave në vlerën 50%-99%.
- **I pazbatuar:** mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave në vlerën 0%-49%.

Së dyti, është analizuar realizimi i Objektivit Specifik përkundrejt numrit të masave të zbatuara (e shprehur në %). Përlogaritja është kryer në bazë të intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën më poshtë:²

Kategoria	Niveli i Tolerancës
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara
Tejkaluar	111 dhe më lart

- **Përcaktimi i nivelit të realizimit të Qëllimeve të Politikave** është përlogaritur si mesatarja e përqindjes së realizimit të Objektivave Specifikë përkatës.
- Në raportin e monitorimit vlerësohet **identifikimi i risqeve** me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për tu adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Risqet janë identifikuar në nivel QP dhe OS në zbatim të Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.³ Janë marrë në konsideratë dy aspekte: mundësia e verifikimit të risqeve dhe ndikimi i tyre, sipas vlerësimit të kryer nga secili institucion përgjegjës për zbatim. Secili nga këto dy aspekte vlerësohet në bazë të tre kategorizimeve: *i. ulët; ii. mesëm dhe iii. lartë.*
- Konkluzionet dhe rekomandimet janë në përputhje me evidencat e raportit dhe përfshijnë masa konkrete për përmirësim për tu adresuar në vendimmarrje.

Analizat financiare

² Vlerësim është realizuar në përputhje me Guidën Metodologjike “Struktura e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes”.

³ Analiza dhe vlerësimi i riskut është kryer referuar Guidës Metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes.

- Analiza e buxhetit të përdorur është analizuar e lidhur me programet buxhetore (identifikohet saktë numri total i programeve buxhetore) në tre (4) nivele: (i) qëllimi i politikave (ii) objektivi specifik, (iii) masa, aktivitete.
- Shkalla e analizës financiare është kryer ku janë identifikuar dhe shkaqet e mungesës së fondeve dhe se si ky hendek do të trajtohet në të ardhmen.

Konsultimi publik i Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që ndërlidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është procesi i konsultimit publik. Tashmë korniza rregullatore për konsultimin publik është unifikuar dhe ka ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së politikave. Prioritare mbetet përfshirja aktive e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes.

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 01.04.2025 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktoi dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtesia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryeu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Pas miratimit të raportit në Ekipin Tematik, Ministria e Drejtësisë publikon në faqen e saj zyrtare raportin e monitorimit.

II. PROGRESI I STRATEGJISË

2.1 Reforma të zbatuara me sukses në 2024

Reforma në Drejtësi, e konsideruar si një proces prioritar për shtetin shqiptar, u iniciua me synimin që sistemi i drejtësisë të ndryshonte thelbësisht për të garantuar dhe konsoliduar pavarësinë, efikasitetin, rritjen e transparencës, forcimin e besimit të publikut si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës së sistemit penitenciar. Jetësimi me sukses i Reformës në Drejtësi kërkon vëmendje të shtuar gjithashtu edhe mbi përgjegjësitë që burojnë për institucionet e përfshira.

Në mënyrë të përmbledhur, viti 2024 ka shënuar disa arritje të rëndësishme, pozitive dhe inkurajuese në fushat kryesore të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë të cilat janë përkthyer në rezultate konkrete dhe kanë pasur impakt në disa drejtime kryesore në lidhje me 5 (pesë) Qëllimet e Politikës së Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

2.2 Impakti i zbatimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritit evropian

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030 është një dokument kyç për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe ka një rëndësi të veçantë në kuadër të procesit të integritit evropian të vendit. Ky proces është përshkruar si një prioritet strategjik kombëtar, i cili është thelbësor për demokratizimin dhe transformimin e shoqërisë shqiptare, duke i përshtatur vlerave dhe parimeve të Bashkimit Evropian.

Përmes kësaj strategjie, Shqipëria synon të forcojë sundimin e ligjit dhe të përmirësojë efikasitetin e institucioneve të drejtësisë, duke përmbushur standardet e BE-së që janë të parashikuara në Kapitullin 23 të negociatave për anëtarësim, i cili trajton reformat në gjyqësor dhe të drejtat themelore. Kjo strategji është pasardhëse e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, e cila kishte për qëllim implementimin e reformave që synonin përmbushjen e kushteve për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Në kuadër të procesit të integritit, Shqipëria ka marrë disa hapa konkretë për të avancuar reformat në drejtësi. Miratimi i ligjeve të reja, implementimi i procesit të vettingut për gjyqtarët dhe prokurorët, modernizimi i administratës gjyqësore dhe forcimi i mekanizmave kundër korrupsionit janë disa nga masat që janë ndërmarrë për të përmbushur standardet e BE-së. Kjo ka çuar në përmirësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë, rritjen e pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit dhe forcimin e shtetit të së drejtës, një aspekt kyç i integritit në BE.

Progresi i Shqipërisë në këtë fushë është vlerësuar në mënyrë pozitive nga Komisioni Evropian në raportin e tij për Shqipërinë, i cili u publikua më 12 tetor 2022. Raporti theksoi përparimin e bërë në zbatimin dhe konsolidimin e reformës në drejtësi, veçanërisht në lidhje me procesin e vettingut dhe në rritjen e pavarësisë dhe profesionalizmit të gjyqësorit. Ky progres është i rëndësishëm për vazhdimin e procesit të negociatave dhe është një faktor kyç në përshpejtimin e avancimit të Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE.

Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë 2024-2030 është një element kyç i procesit të integrimit evropian të Shqipërisë, pasi ajo nuk synon vetëm përmirësimin e sistemit të drejtësisë, por gjithashtu mbështet realizimin e kërkesave të BE-së për anëtarësim. Objektivat kryesore të strategjisë, si përmirësimi i qasjes në drejtësi, rritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe forcon pavarësinë dhe efektivitetin e gjyqësorit, janë të drejtpërdrejta në përputhje me kërkesat e BE-së për të siguruar një sistem të drejtësisë të fortë dhe të pavarur.

Reforma e administratës gjyqësore dhe implementimi i mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies janë gjithashtu thelbësore për përmbushjen e standardeve të BE-së. Kjo strategji synon të rrisë efikasitetin e sistemit gjyqësor, duke siguruar një sistem të drejtësisë të drejtë dhe të shpejtë, që është një kërkesë e rëndësishme për përputhshmërinë me acquis communautaire të BE-së.

Për më tepër, lidhja e strategjisë me procesin e integrimit evropian theksohet nga angazhimi për të forcuar qeverisjen e mirë dhe shtetin e së drejtës. Kjo është e rëndësishme për të garantuar që Shqipëria të jetë e gatshme për të zbatuar politikat e BE-së dhe për të kontribuar në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, një aspekt kyç i procesit të integrimit.

Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë 2024-2030 është një dokument kyç që lidh përpjekjet e Shqipërisë për të avancuar në drejtësi dhe përmbushjen e kushteve për anëtarësimin në BE. Ajo është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të sundimit të ligjit, përmirësimit të administratës gjyqësore dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke kontribuar kështu në transformimin e shoqërisë shqiptare në përputhje me vlerat dhe parimet evropiane. Kjo strategji është gjithashtu një garanci për rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe për avancimin e Shqipërisë në rrugën e saj të integrimit evropian.

2.3 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë është një element i rëndësishëm që mundëson analizimin e efektivitetit të progresit të strategjisë. Ky raport monitorimi synon të sigurojë transparencë për cdo palë të interesuar duke prezantuar shpenzimeve të kryera me qëllim marrjen e masave për të adresuar nevojat sa i përket burimeve financiare.⁴ Plani i detajuar i veprimit, bashkangjitur si aneks këtij dokumenti strategjik, është hartuar në përputhje me metodologjinë e sistemit IPSIS. Ai është kostuar dhe buxhetet e detajuara parashikohen në të njëjtën mënyrë në sistemin IPSIS, duke ofruar edhe ndarjen e duhur për programet buxhetore sipas institucioneve. Financat do të mbulohen nga buxheti i shtetit, kontrata sektorale “BE-ja për reformën në drejtësi”, nga donatorët në formën e granteve, kredive ose çdo fondi tjetër kapital apo asistencë teknike të parashikuar. Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë 2024-2030 është rreth **5.93 miliardë Lekë**, ose rreth **56.4 milionë Euro**. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 105 lekë për 1 euro. Masat e kostuara në planin e veprimit 2024-2030, **të cilat janë planifikuara të mbulohen nga fondet e buxhetit të shtetit**, janë brenda fondeve të caktuara për institucionet përgjegjëse.

Totali i buxhetit të shtetit i përdorur për periudhën janar-dhjetor 2024 është në shumën 507,187,914 lekë.

Buxheti i përdorur sipas Qëllimeve të Politikës

Gjatë analizës të kryer konstatohet se informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse i cili lidhet me ekzekutimin e buxhetit rezulton i pjesshëm, si dhe mungon plotësisht informacioni mbi financimin nga donatorët⁵.


Gjatë procesit të dërgimit të kontributit nga institucionet haset si problematikë raportimi i masave ku rezultojnë institucion përgjegjës në “kosto administrative” ndërkohë që është parashikuar buxhet për realizueshmërinë e tyre. Gjithashtu, mosraportimi i buxhetit mbi masat përkatëse sjell si pasojë mungesën e një vlere të saktë.

⁴ Vlen për tu theksuar se përgjatë dërgimit të kontributit është hasur mungesa e informacionit që lidhet me ekzekutimin e buxhetit.


⁵ Kjo problematikë është trajtuar në kapitullin “Hapat në vijim”.

Sipas raportimeve nga institucionet rezulton se buxheti i parashikuar për tu shpenzuar në kuadër të Qëllimeve për masat të cilat rezultojnë të perealizuara apo në proces zbatimi do të shpenzohet në periudhën në vijim.


Buxheti i shpenzuar: Qëllimi Politik I




Buxheti i shpenzuar: Qëllimi Politik II




Buxheti i shpenzuar: Qëllimi Politik III



Buxheti i shpenzuar: Qëllimi Politik IV



Buxheti i shpenzuar: Qëllimi Politik V



III. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE TREGUESVE


3.1 Përmbledhje e arritjeve në lidhje me Qëllimet e Politikave dhe Objektivat Specifikë sipas masave

SND 2024-2030 parashikon për zbatim gjatë 7 viteve të implementimit të saj 22 Objektiva Specifike, 139 masa dhe 511 aktivitete. Në analizë për periudhën raportuese janë marrë në konsideratë:

- 22 Objektiva Specifikë , të ndarë në 5 Qëllime Politike;
- 139 masa të ndara në 511 aktivitete të cilat janë përcaktuar për tu zbatuar nga institucionet gjatë viteve 2024-2030.

Nga 40 masat që rezultojnë jashtë periudhës së raportimit (të cilat janë paraqitur me ngjyrë të bardhë në tabelat shpjeguese të masave për secilin OS), nga disa prej institucioneve zbatuese rezulton se ka filluar një implementim i lehtë i disa prej tyre, dhe kryesisht i masave që prekin fushën e ngritjes së kapacitetit të stafit.

Niveli i realizimit në total: Masat dhe objektivat



Në vitin 2024, nga 22 Objektivat Specifike **21 janë zbatuar pjesërisht** dhe **1 objektiv nuk është zbatuar**. Objektivi specifik 2.3 Sigurimi i zbatimit të njëtrajtshëm të standardeve të ndarjes së rastësishme të çështjeve nuk është zbatuar gjatë vitit 2024 pasi ka munguar një analizë e mirëfilltë nga institucionet për rastet e hedhjes së shortit manualisht dhe rishikimin e rregullave përkatës. Për rrjedhojë, nuk është siguruar një vlerësim i plotë mbi efektivitetin dhe transparencën e procesit.



Nga 99 masa gjithsej që kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën janar-dhjetor 2024, **36 masa ose 36% janë zbatuar plotësisht**, 53 masa ose 54% janë zbatuar pjesërisht, dhe **10 masa ose 10% janë të pazbatuara**. Masat e parealizuar për vitin 2024 kanë të bëjnë me forcimin e integritetit dhe transparencës në sistemin e drejtësisë, garantimin e ndarjes së rastësishme të çështjeve, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore. Mungesa e progresit në këto masa reflekton sfida në monitorimin efektiv të institucioneve, analizimin e rreziqeve të korrupsionit dhe zbatimin e rregullave të përcaktuara për funksionimin e drejtësisë. Për më tepër, vonesat në miratimin e planeve të integritetit dhe zhvillimin e kapaciteteve teknologjike ndikojnë drejtpërdrejt në eficiencën dhe besueshmërinë e sistemit gjyqësor ndonëse disa prej këtyre vonesave vijnë si shkak i vonesave në marrjen e fondeve.

3.2 Vlerësimi i arritjes së Qëllimeve të Politikës kundrejt masave dhe treguesve

3.2.1 Qëllimi i Parë i Politikës

Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standartet Evropiane.

Qëllimi i Parë i Politikës: 27 masa



Obiektivi Specifik 1.1.

Plani i Veprimt për Objektivin 1.1 parashikon parashikon 13 masa por vetëm 7 masa janë të zbatueshme për vitin 2024, prej të cilave **6 masa janë zbatuar plotësisht** dhe **1 masë është zbatuar pjesërisht**. 86% e masave janë zbatuar plotësisht.

OS.1.1 - Përditësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi në përputhje me parimet e pavarësisë, llogaridhënies, efikasitetit, cilësisë dhe sigurimi i harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së.

	<i>Koordinimi i zhvillimit dhe zbatimit të politikave shtetërore në lidhje me rritjen e pavarësisë, përgjegjëshmërisë, cilësisë dhe efikasitetin e drejtësisë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> <i>MD, Institucionet zbatuese të SND 2024-2030 dhe Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës, KLGJ, KLP</i> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Zbatimi i masës për koordinimin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave shtetërore në drejtësi për periudhën 2024-2030 ka vijuar në disa drejtime kyçe. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka përmbushur detyrimet e tij për raportimin mbi zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND) 2024-2030 dhe në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës. Deri më tani, janë hartuar dhe dorëzuar dy raporte që ofrojnë një pasqyrë të ecurisë së reformave dhe masave të zbatuara. Ky proces monitorimi tregon një qasje të rregullt dhe të strukturuar për të vlerësuar progresin e institucioneve të përfshira. Një tjetër aspekt i rëndësishëm ka qenë roli i Shkollës së Magjistraturës, e cila ka vijuar aktivitetin e saj në trajnimin dhe vlerësimin e kandidatëve për magjistratë, ndihmësve ligjorë dhe magjistratëve në detyrë. Në këtë drejtim, Shkolla ka bashkëpunuar me të gjithë aktorët e përfshirë, duke organizuar takime dhe duke marrë pjesë në diskutime të zhvilluara nga Kuvendi për çështje të reformës në drejtësi. Për më tepër, ajo ka siguruar raportime të rregullta mbi aktivitetet e saj, duke reflektuar një përpjekje për të siguruar zbatimin e plotë të detyrimeve që burojnë nga Udhërrëfyesi i Shtetit të së Drejtës dhe aktet nënligjore përkatëse. Në drejtim të planifikimit strategjik për sistemin gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka nisur hartimin e Planit Strategjik për periudhën 2025-2027, një dokument kyç për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në vitet e ardhshme. Në shtator 2024, KLGJ organizoi një takim dy-ditor me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë për të diskutuar mbi këtë plan, duke reflektuar përpjekjet për një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar në zhvillimin e reformave në drejtësi. Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka vijuar të monitorojë dhe zbatojë angazhimet e SND-së dhe të Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës, duke përgatitur raportime të rregullta për Ministrinë e Drejtësisë. KLP ka vijuar të zbatojë Planin Strategjik 2021-2024, duke kryer monitorime periodike mbi zbatimin e tij dhe duke analizuar arsyet e mosrealizimit të disa masave. Aktualisht, në bashkëpunim me projektin EU4Justice, KLP ka nisur procesin e hartimit të Planit Strategjik 2025-2030, duke ftuar përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë në fazën fillestare të diskutimeve për të garantuar një qasje të koordinuar dhe efektive. Drafti përfundimtar i këtij plani pritet të miratohet pas konsultimeve të mëtejshme me aktorët institucionale. Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2024 ka hartuar Raportin e fundi të Monitorimit të SND 2021-2025 për periudhën janar-qershor 2024 dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse ka hartuar Strategjinë e re Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030. Strategjia e re e cila synon të konsolidojë arritjet e strategjisë së mëparshme, vendos theksin në sfidat e hasura gjatë implementimit të saj, si dhe adreson sfidat e reja dhe kërkesat lidhur me Integrimin European u miratua me VKM nr. 787, datë 18.12.2024. Megjithatë miratimi u bë në fund të vitit, masat e dakorduara nisën të zbatohen që në fazën fillestare të hartimit të strategjisë, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.
1.1.2	<i>Përditësimi i Kodit Penal në përputhje me acquis të BE. (pz. 2024-2026)</i> <u>Institucioni raportues:</u> <i>MD, Kuvendi</i> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Procesi i identifikimit të acquis të BE-së për ndryshimet në Kodin Penal është përmbyllur me sukses, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin evropian, praktikat më të mira dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara. Drejtoria e Kodifikimit ka analizuar aktet ligjore të BE-së që lidhen me veprat penale dhe ka kryer një studim krahasues me vendet anëtare të BE-së për të vlerësuar praktikat

	më të mira. Gjithashtu, janë hartuar dhe përfunduar tabelat e përputhshmërisë për direktivat që kërkojnë transpozim në Kodin Penal, duke realizuar kështu plotësisht këtë masë.
1.1.3	<i>Përditësimi i Kodit të Procedurës Penale në përputhje me acquis të BE . (pz. 2024-2027)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, Kuvendi <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Procesi i përafrimit të Kodit të Procedurës Penale me acquis të BE-së është përmyllur plotësisht, duke siguruar përputhshmërinë me legjislacionin evropian, praktikat më të mira dhe konventat ndërkombëtare. Janë identifikuar të gjitha aktet e BE-së që lidhen me procedurat penale dhe që duhet të transpozohen në këtë kod. Analiza përkatëse është realizuar dhe tabelat e përputhshmërisë për direktivat mbi të drejtat procedurale janë hartuar me sukses. Gjithashtu, është kryer identifikimi i boshlleqeve ligjore, me një analizë të detajuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit, ndërsa pritet kontributi i institucioneve të tjera për ndërhyrjet e nevojshme në këtë kod.
1.1.4	<i>Përditësimi i Kodit Civil në përputhje me acquis të BE (pz. 2026-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, Kuvendi <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
1.1.5	<i>Përditësimi i Kodit të Procedurës Civile në përputhje me acquis të BE (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, Kuvendi <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
1.1.6	<i>Përditësimi i Kodit Familjar në përputhje me acquis të BE për sistemin e drejtësisë (pz. 2024-2027)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, Kuvendi <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Procesi i identifikimit të acquis të BE-së për ndryshimet në Kodin e Familjes është realizuar plotësisht, duke siguruar përputhshmërinë me legjislacionin evropian, praktikat më të mira dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara. Është identifikuar acquis përkatës i BE-së, ndërsa pritet kontributi i institucioneve të tjera për të vlerësuar nevojat për ndërhyrje të mundshme në këtë kod.
1.1.7	<i>Përditësimi i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, në përputhje me acquis të BE për sistemin e drejtësisë. (pz. 2025-2026)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, Kuvendi <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u>

	Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
1.1.8	<i>Kontrollet e rregullta të përshatshmërisë ligjore dhe miratimi i ndryshimeve ligjore të nevojshme për konsolidimin, pavarësinë, integritetin, efikasitetin dhe rritjen e besimit të publikut, ndërmerren në përputhje me acquis të BE-së dhe standardet evropiane dhe forcojnë më tej parimet e reformës në drejtësi të vitit 2016 (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> <i>Institucionet e sistemit të drejtësisë MD, Kuvendi</i> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
1.1.9	<i>Avancimi i reformës nëpërmjet ndryshimeve ligjore duke përfshirë vijueshmërinë e rezultateve pozitive të procesit të verifikimit dhe forcimin e rregullave për kontrollin e pasurive dhe të figurës për aktorët e sistemit të drejtësisë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> <i>MD, Kuvendi, KPK, KLGJ, ILD, KLP, ILDKPKI, SPAK</i> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Avancimi i reformës në drejtësi përmes ndryshimeve ligjore ka vijuar me një fokus të veçantë në forcimin e verifikimit dhe kontrollit të pasurive dhe figurës së aktorëve të sistemit. Një arritje kryesore ka qenë përfundimi i procesit të vettingut nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), i cili në shtatë vite ka rivlerësuar 805 subjekte, duke përmbyllur mandatin e tij kushtetues me rezultate konkrete në pastrimin e sistemit. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ka përfunduar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjatë periudhës 8 shkurt 2018 – 27 nëntor 2024, KPK ka dhënë gjithsej 805 vendime, duke përfshirë: • 373 vendime për konfirmim në detyrë për: - o 165 gjyqtarë, - o 167 prokurorë, - o 2 ish-inspektorë të KLD-së, - o 2 inspektorë të KLGJ-së, - o 37 ndihmës ligjorë/këshilltarë. • 268 vendime për shkarkim nga detyra për: - o 146 gjyqtarë, - o 1 ish-gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, - o 116 prokurorë, - o 1 inspektor të KLGJ-së, - o 4 ndihmës ligjorë. • 105 vendime për ndërprerje të procesit për: - o 61 gjyqtarë, - o 27 prokurorë, - o 1 ish-prokuror, - o 1 ish-gjyqtar, - o 1 ish-inspektor të KLD-së, - o 14 ndihmës ligjorë (sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës). • 49 vendime për përfundim të procesit pa vendim përfundimtar për: - o 26 gjyqtarë, - o 17 prokurorë, - o 1 ish-kryeinspektor të KLD-së,

	- o 2 ish-inspektorë të KLD-së, - o 3 ndihmës ligjorë (sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 64 të ligjit nr. 96/2016). • 8 vendime për ndërprerje të procesit për: - o 3 gjyqtarë, - o 1 prokuror, - o 4 ndihmës ligjorë (sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016). • 2 vendime për pezullim nga detyra për: - o 2 prokurorë.
1.1.10	<i>Kryerja e ndryshimeve ligjore për masat që sigurojnë efikasitetin lidhur me burimet njerëzore në gjykata dhe zyrat e prokurorisë. (pz. 2024-2027)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, PP, Gjykatat e Posaçme, SPAK</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> KLJG ka propozuar ndryshime ligjore në Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Sa i përket burimeve njerëzore, këto propozime kanë konsistuar në ndryshime ligjore për lehtësimin e procedurave të rekrutimit të ndihmësve ligjorë dhe bërjen më atraktive të këtij pozicioni. Është bërë inventarizimi i çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe atij Administrativ Tiranë si dhe në Gjykatat e Apelit, Juridiksioni i Përgjithshëm dhe Administrativ. Gjithashtu, është propozuar rritja e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve. Grupi i Punës i ngritur për hartimin e një strategjie për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata e ka përmbyllur veprimtarinë e tij në 2024 e cila ka konkluduar në propozimin e masave konkrete ligjore dhe administrative me qëllim rritjen e efikasitetit në drejtësi. Në vijimësi të këtij GP, është ngritur një tjetër GP me objekt përcaktimin e rregullave për afatet standarde minimale kohore dhe standardet minimale sasore të gjykimit të çështjeve, si dhe modelet standarde të vendimeve. Prokuroria e Përgjithshme raporton se propozimet lidhur me ndryshimet ligjore në kuader të efikasitetit janë paraqitur që në vitin 2022 pranë Kuvendit të Shqipërisë. Për vitin 2024 nuk ka zhvillime të reja në këtë aspekt. Në kuadër të kryerjes së analizave dhe adresimit të gjetjeve të tyre për rritjen e efikasitetit të institucionit, PP raporton se analizat vjetore të vitit 2024 për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kryhen brenda 3 muajve të parë të vitit 2025. Në rast se do të ketë gjetje do të adresohen në raportimet në vijim. Prokuroria e Posaçme që në Raportin vjetor 2023, ka evidentuar si problematikë mungesën e keshilltarëve ligjorë, si domosdoshmëri në analizat ligjore të çështjeve, që sipas ligjit duhet të ndiqen nga Prokuroria e Posaçme në të gjitha shkallët e gjykimit. Gjithashtu, bazuar në pikën 8, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është parashikuar kalimi i kompetencave të Komisionerit Publik në janar 2025, për Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, e cila adreson një ngarkesë të shtuar lidhur me çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të magjistratëve, që lidhen me përfaqësimin në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, gjatë gjykimit të çështjeve të ankmuara prej tyre. Për këtë arsye, gjatë vitit 2024 është kërkuar në projekt buxhet shtimi i strukturës së Prokurorisë së Posaçme me 1 punonjës Drejtor Kabineti dhe 10 punonjës Këshilltarë (ligjor/ekonomik). Kjo kërkesë është miratuar me ligjin nr. 115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025". Prokuroria e Posaçme në kuader të procesit të rivlerësimit kalimtar, si pjesë e stafit të Kabinetit të Drejtuesit ka marrë nga stafi i ish-komisionereve publike 4 keshilltarë ligjorë, (dy keshilltarë ekonomikë dhe dy keshilltarë juridikë), nga 10 keshilltarë të miratuar për kabinetin e Drejtuesit. Në lidhje me keshilltarët ligjorë të Prokurorisë së Posaçme nuk janë hapur vakancat pasi pritet të miratohet një ndryshim ligjor nga Kuvendi për këtë qëllim.
1.1.11	<i>Marrja e masave për mospërfshirjen e ish-magjistratëve të shkarkuar/dorëhequr gjatë vetting-ut në veprimtaritë e institucioneve të sistemit të drejtësisë (pz. 2025-2026)</i>

	<u>Institucioni raportues:</u> MD, SHM, KLGJ, KLP, ILD, Kuvendi <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
1.1.12	<i>Forcimi i kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës (pz. 2025-2026)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, SHM, Kuvendi <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
1.1.13	<i>Rritja e mëtejshme e kapaciteteve të organeve të specializuara për korrupsionin dhe krimin e organizuar në mënyrë që ato të mund të kryejnë në mënyrë efikase hetimin dhe gjykimin. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> SPAK, KLGJ, KLP <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Në vitin 2024, KLGJ ka vendosur caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme të 2 gjyqtarëve pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Këto pozicione janë plotësuar si pasojë e vendimmarrjeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit që kanë vendosur ndryshimin e vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke konfirmuar në detyrë të 2 subjekteve të rivlerësimit. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka në strukturën organizative të saj 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë, por aktualisht, kjo gjykatë ka në organikën e saj faktike 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë dhe është në pritje të plotësimit të trupës gjyqësore me 5 (pesë) gjyqtarë, pas përfundimit të procedurave përkatëse për përzgjedhjen e gjyqtarëve, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka një strukturë organike të përbërë nga 42 njësi, nga të cilat një kryetar gjykate, 1 zëvendëskryetar, 9 gjyqtarë dhe 31 të caktuar në zonën e administrimit të brendshëm gjyqësor. Evidentohe se sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk ka caktuar kryetarin e gjykatës. Gjithashtu, Njësia e Ndihmësave Ligjorë në këtë gjykatë sipas strukturës përbëhet nga 6 ndihmësa, por aktualisht ushtrojnë funksionin vetëm 3 ndihmësa ligjorë të emëruar nga ana e KLGJ. Zëvendëskryetari i Gjykatës tashmë ka vënë në dijeni KLGJ-në për nevojat e riorganizimit të strukturës dhe plotësimin e vendeve vakante. Nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është paraqitur një kërkesë për krijimin e Sektorit të Informacionit të Klasifikuar me 3 nëpunës civilë gjyqësorë, e cila ende nuk është miratuar. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, gjatë vitit 2024, me shkresën nr. 40485 prot., datë 08.07.2024 i ka kërkuar dhe argumentuar Minsitrisë së Financave shtimin e organikës me 40 Hetues për Byronë Kombëtare të Hetimit dhe me shkresën nr. 15874 dt. 02.09.2024 i ka kërkuar dhe argumentuar Ministrisë së Financave shtimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme me 1 punonjës Drejtor Kabineti dhe 10 punonjës Këshilltarë (ligjor/ekonomik). Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me Aktin Normativ nr. 3, datë 28.08.2024 “Për disa ndryshime dhe shtese në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, si dhe me ligjin nr. 115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”, janë shtuar në strukturë 40 funksione hetues në organikën e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët do të ndikojnë në rritjen e përgjegjësi dhe efikasitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, për të cilët akoma nuk ka filluar procedura e rekrutimit.

Me vendimet Nr.184 dhe Nr.186, datë 31.07.2024, KLP plotësoi 2 vakancat për prokuror në SPAK. Me emërimin e tyre u plotësua struktura e plotë e kësaj prokurorie sipas Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 6/2021, në të cilën është parashikuar se, numri i përgjithshëm i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme është 20 prokurorë. Prokuroria e Posaçme me Vendimin e Drejtuesit të Prokurorisë nr. 214, datë 29.02.2024 “Për miratimin e planit të pranimit/rekrutimit në shërbimin civil, për vitin 2024 për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, ka miratuar planin për plotësimin e vakancave për vitin 2024. Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka zhvilluar procedurat e rekrutimit/punësimit që kanë qenë të domosdoshme, si rezultat i mungesës së infrastrukturës (ambjenteve të punës zyrtare). Prokuroria e Posaçme, ka plotësuar vakancat si më poshtë: 1 pozicion Ekspert Financiar, 1 pozicion Koordinator për Marrëdhënie me Mediat, 4 pozicione specialist, kategori ekzekutive, 1 pozicion drejtor, kategoria e mesme drejtuese, 1 pozicion përgjegjës sektori, kategoria e ulët drejtuese, 1 pozicion në administratë, punonjës me kontratë, 2 pozicione në administratë punonjës me kontratë të përkohshme.

Për OS 1.1 janë përcaktuar dy tregues performance:

- ***Norma (%) e zbatimit të rekomandimeve të raporteve analitike të institucioneve mbi problematikat e zbatimit të ligjeve të reformës në drejtësi***

Treguesi synon të masë koordinimin e institucioneve të pavarura të drejtësisë dhe MD-së (Drejtorisë së Kodifikimit)/Komisioni i posaçëm parlamentar dhe rezultatet e këtij koordinimi me qëllim rishikimin cilësor të ligjeve të reformës për të garantuar eliminimin e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të ligjeve.

Nuk ka patur propozime për vitin 2024.

- ***Numri i akteve ligjore të BE-së me të cilat ligji vendas është përafruar të paktën 'pjesërisht'***

Treguesi synon të masë numrin e akteve ligjore të BE-së, përkatësisht direktivat, vendimet kuadër, vendimet dhe rregulloret me të cilat ligji vendas është përafruar të paktën 'pjesërisht'. Përafrimi konsiderohet 'i pjesshëm' kur është vlerësuar se niveli i përputhshmërisë është të paktën "i mirë" dhe propozimet për ndryshime ligjore, bashkë me tabelën përkatëse të përputhshmërisë janë përcjellë pranë Këshillit të Ministrave.

Niveli i përafrimit me qëllim të matjes së këtij treguesi vlerësohet në kuadrin e tabelave të përputhshmërisë të plotësuar nga MD, ku vlerësimi i përgjithshëm i përafrimit së ligjit vendas me aktet ligjore të BE-së është i nivelit: “i mirë”, "i lartë" ose "i plotë".

Aktualisht kërkohet që nismat që ndërmerr Ministria e Drejtësisë të jenë të transpozuar plotësisht. Për këtë qëllim, transpozimi i pjesshëm nuk është pjesë e nismave të Ministrisë së Drejtësisë. Të gjitha aktet, të cilat janë të parashikuara për t'u iniciuar nga MD, do të jenë të transpozuar plotësisht dhe janë të parashikuara sipas planit të shtrira në kohë. Vetëm me miratimin e aktit mund të themi se transpozimi është bërë i plotë.

Obiektivi Specifik 1.2.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.2 parashikon 4 masa dhe 3 masa janë të zbatueshme për vitin 2024, prej të cilave **1 masë është zbatuar plotësisht** dhe 2 masa janë zbatuar pjesërisht 33.3 % e masave janë zbatuar plotësisht.

OS. 1.2 - Përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar (vetting-ut) brenda afateve kushtetuese dhe vendosja e mekanizmave për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij procesi

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisioneri Publik sigurojnë finalizimin e të gjitha çështjeve pezull të verifikimit (pz. 2024-2025)

Institucioni raportues: KPK, IKP

Informacion mbi zbatimin e masës:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Komisioneri Publik (IKP) po vijojnë përmbushjen e detyrimeve të tyre për finalizimin e procesit të verifikimit për vitet 2024-2025. Në këtë kuadër, IKP ka shqyrtuar vendimet e njoftuara nga KPK brenda një afati 15-ditor nga momenti i marrjes së tyre. Vendimi i fundit i njoftuar në IKP nga KPK daton më 6 dhjetor 2024 dhe është ankimuar brenda afatit ligjor më 20 dhjetor 2024, duke siguruar një përmbyllje të rregullt brenda kufizimeve kushtetuese deri më 31 dhjetor 2024.

1.2.1

Përtej këtij procesi, IKP po vijon me hartimin e bilancit të veprimtarisë së tij, i cili pritet të finalizohet brenda 31 marsit 2025. Paralelisht, po zhvillohet puna për përpunimin dhe arkivimin e dokumentacionit të viteve 2018-2024, një proces që përfshin përgatitjen dhe nënshkrimin e inventarëve, si dhe dorëzimin përfundimtar të tyre brenda 30 qershorit 2025. Aktualisht, ka nisur përpunimi i fashikujve të vitit 2018, dorëzimi i të cilave dhe i fashikujve të viteve në vijim do të bëhet sipas udhëzimeve të Arkivit Qendror Shtetëror të Drejtësisë (ish ASHSGJ)".

Nga ana tjetër, KPK ka miratuar vendimin nr. 110/2024 të Kuvendit të Shqipërisë më 12 dhjetor 2024, i cili përcakton strukturën dhe organikën për mbylljen e institucionit. Prosesi i dorëzimit të dosjeve përfundimtare në Arkivin Qendror Shtetëror të Drejtësisë do të zhvillohet nga 1 janari deri më 30 qershor 2025, duke ndjekur udhëzimet e vendimit të Kuvendit. Për të mundur një administrim të rregullt të kompetencave gjatë fazës përfundimtare, më 30 dhjetor 2024 kryetari i KPK ka deleguar kompetencat te Sekretari i Përgjithshëm përmes urdhrit nr. 96, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare më 30 dhjetor 2024.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit përshpejton ritmin në gjykimin e ankimeve dhe ndërmerr të gjithë hapat përkatës për të siguruar finalizimin e çështjeve dhe përmbush parashikimet ligjore brenda afatit kushtetues (pz. 2025-2026)

1.2.2

Institucioni raportues: KPA

Informacion mbi zbatimin e masës:

	Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
1.2.3	<i>Institucionet e vetting-ut sigurojnë referimin sistematik të çështjeve në prokurori, ku ka dyshime për elementë penalë (pz. 2024-2024)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KPK <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Në total, gjatë gjithë veprimtarisë së tij, KPK ka referuar 53 subjekte pranë SPAK për çështje ku janë evidentuar dyshime mbi elementë penalë, nga të cilat 19 i përkasin vitit 2024. Kjo shifër është reflektuar edhe në kontributet e progres-raportit për vitin 2024. Lidhur me ecurinë e këtyre referimeve, është raportuar se për 12 subjekte çështjet janë dërguar për kompetencë hetimi pranë Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm në Shqipëri. Për 5 subjekte të tjera është përcjellë dokumentacioni i kërkuar, duke vijuar fazën e hetimit, ndërsa për 2 subjekte Prokuroria pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.
1.2.4	<i>Shërbimet e prokurorisë në mënyrë proaktive nisin procedimin penal ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, procesi i vetting-ut të të cilëve ka zbuluar elementë penalë.</i> <u>Institucioni raportues:</u> PP/KPK, KPA, SPAK, Gjykatat e Posaqme <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Nenkomitetit Drejtësi, Liri dhe Siguri për vitet 2023 dhe 2024, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm vijnë raportimet e tyre çdo tre muaj mbi ecurinë e procedimeve penale të lidhura me ish-magjistratët e hetuar për sjellje kriminale gjatë procesit të vettingut. Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2024, 21 kallëzime penale janë regjistruar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Pas verifikimeve paraprake, 14 prej tyre kanë kaluar në fazën e hetimit, ndërsa për 3 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Katër kallëzime të tjera mbeten ende në proces verifikimi. Në vijim të analizës së kallëzimeve të periudhës së mëparshme (korrik-shtator 2024), për një prej tyre, që ishte në proces verifikimi, prokurori vendosi mosfillimin e çështjes, ndërsa për një tjetër është regjistruar procedimi penal dhe hetimi vijon. Sa i përket gjashtë procedimeve penale të raportuara më herët, zhvillimet kanë qenë të ndryshme: • Dy procedime janë bashkuar në një, pasi lidhen me të njëjtin person dhe akuzat janë bashkuar në një dosje të vetme. Hetimi për këtë rast është ende në vijim. • Dy procedime të tjera po ashtu vijnë në një në hetim. • Një procedim penal është pushuar me kërkesë të prokurorit, duke sjellë përfundimin e çështjes. • Një procedim penal ka kaluar në fazën e gjyqimit në Gjykatën e Shkallës së Parë. Në përfundim të vitit 2024, situata në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm paraqitet si vijon: • 18 procedime penale janë ende në hetim, • Një procedim penal është në pritje të vendimit për pushimin e hetimeve, • Një tjetër procedim penal ndodhet në fazën gjyqësore në shkallën e parë. Shumica e këtyre kallëzimeve kanë ardhur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe janë përcjellë për kompetencë nga SPAK. Konkretisht, 19 kallëzime kanë ardhur nga KPK përmes SPAK, një kallëzim është referuar drejtpërdrejt nga KPK, ndërsa një tjetër është kryer nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI).

Në vazhdim, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm mbeten të angazhuara për të vlerësuar dhe trajtuar çdo referim të ri nga KPK, institucionet e tjera shtetërore apo individë, në lidhje me ish-prokurorët dhe gjyqtarët e shkarkuar nga procesi i rivlerësimit.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, SPAK ka regjistruar 19 kallëzime penale të referuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), të cilat lidhen me 19 ish-subjekte të rivlerësimit të dorëhequr.

Pas shqyrtimit të këtyre kallëzimeve, u konstatua se:

- Nuk përmbajnë elementë të veprave penale që hyjnë në kompetencën e Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 75/a, gërma “a” dhe “b” të Kodit të Procedurës Penale.
- Nuk përfshijnë subjekte që, sipas nenit 75/a, gërma “c” të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3, pika 2 të ligjit Nr.95/2016 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", duhet të hetohen nga SPAK.

Për këtë arsye, u vendos shpallja e moskompetencës dhe kalimi i akteve në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore. Më 27 shtator 2024, të gjitha 19 kallëzimet u transferuan për hetim në prokuroritë përkatëse të rretheve:

- Prokuroria e Tiranës – 7 kallëzime
- Prokuroria e Durrësit – 5 kallëzime
- Prokuroria e Elbasanit – 3 kallëzime
- Prokuroria e Fierit – 1 kallëzim
- Prokuroria e Gjirokastrës – 1 kallëzim
- Prokuroria e Kukësit – 1 kallëzim
- Prokuroria e Vlorës – 1 kallëzim

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar publikon në faqen zyrtare të gjykatës në www.gjykata.gov.al të gjitha njoftimet për dosjet penale, kërkesat për dërgimin e çështjeve në gjyq, kërkesat penale (përveç atyre që shqyrtohen në dhomë këshillimi), që janë shpallur pranë kësaj gjykate.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar raporton se Poli i Shërbimit për marrëdhëniet me publikun dhe median siguron periodikisht dhe në kohë reale informacion faktik për çështjet me interes publik, përfshirë ndjekjen penale të ish-magjistratëve të larguar nga vettingu. Ky informacion komunikohet sipas rregullave ligjore dhe strategjisë së KLGJ.

Për vitin 2024, janë regjistruar dhe gjykuar dy çështje:

- Çështje themeli (vendimi nr. 06, datë 13.02.2024) – personi është dënuar sipas nenit 275/a, paragrafi 2 të Kodit Penal.
- Çështje konfiskimi pasurie (vendimi nr. 142, datë 15.07.2024) – bazuar në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009.

Informacioni mbi këto çështje dërgohet rregullisht tek Ministria e Drejtësisë dhe KLGJ. Gjithashtu, ai është i aksesueshëm në kohë reale në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për OS 1.2 janë përcaktuar dy tregues performance:

➤ ***Përqindja e ankimeve nga SPAK për çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të magjistratëve pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit***

Në zbatim të nenit 179/b, pika 8 të Kushtetutës pas shpërbërjes së Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pas shpërbërjes së tyre

me përfundimin e mandatit të tyre kushtetues, datë 31.12.2024. Treguesi synon të masë numrin e ankimeve të paraqitura nga SPAK në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA) lidhur me çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të magjistratëve.

Kjo matje ndihmon në vlerësimin e ngarkesës së punës së KPA-së dhe vazhdimësinë e efektivitetit të procesit të rivlerësimit, duke identifikuar numrin e çështjeve që janë subjekt ankimi pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë.

Prokuroria e Posaçme raporton se në datë 31.12.2024 kanë mbetur për tu gjykuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, në total 41 ankime, nga ato të ushtruara nga ish-Institucioni i Komisionerëve Publike përgjatë viteve 2022-2024, të cilat do të ndiqen në vijim nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Gjatë vitit 2024 nga ish-Institucioni i Komisionerëve Publikë janë ushtruar gjithsej 25 ankime nga 96 vendime të zbardhura gjatë vitit 2024 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ne raport 26.04%. Nga 25 ankimet e ushtruara nga ish-Institucioni i Komisionerëve Publikë në vitin 2024, janë gjykuar brenda te njëjtë vit (2024) në Kolegjin e Posaçëm të Apelit vetëm 3 prej tyre. Krahës ankimeve si më sipër, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit shqyrtohen edhe ankimet e depozituara nga vetë subjektet e rivlerësimit.

➤ ***Përqindja e çështjeve ku të pandehurit subjekte të vetingut të akuzuar për korrupsion janë dënuar me vendim të formës së prerë***

Treguesi i dënueshmërisë së subjekteve të vetingut mat shkallën e ndëshkimit penal në rastet kur janë konstatuar elemente të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ai përfshin identifikimin e rasteve me shkelje, referimin e tyre në organet e drejtësisë, ndjekjen e procedimeve penale dhe përfundimisht vendimet e gjykatave. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të procesit të vetingut dhe në forcimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë, duke treguar sa efikas ka qenë sistemi në largimin dhe ndëshkimin e individëve të përfshirë në veprimtari të paligjshme.

Për vitin 2024 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar raportohet se nuk ka patur raste ku të pandehurit subjekte të vetingut të akuzuar për korrupsion janë dënuar me vendim të formës së prerë.

Objektivi Specifik 1.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.3 parashikon parashikon 7 masa për vitin 2024 vetëm 6 masa janë të zbatueshme, prej të cilave **2 masa janë zbatuar plotësisht**, **3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë është e pazbatuar**. 33.3% e masave janë zbatuar plotësisht.

OS. 1.3. - Ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapacitetit profesional, pavarësisë dhe efikasitetit të organeve të qeverisjes së drejtësisë

KLP-ja miraton aktet nënligjore të nevojshme për të përfunduar procedurën e vlerësimit për prokurorët, duke përfshirë miratimin e rregullave mbi procedurat e vlerësimit për PP dhe rregullat për drejtuesit e prokurorive (pz. 2024-2025)

Institucioni raportues: KLP

Informacion mbi zbatimin e masës:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të përfunduar procedurën e vlerësimit për prokurorët gjatë periudhës 2024-2025. Këto përfshijnë:

- Vendimi Nr.100, datë 18.06.2024 – Ndryshime në Rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”;
- Vendimi Nr.111, datë 27.06.2024 – Ndryshime në ankesat Nr.2, 5, 6 dhe tabelat përkatëse, pjesë e Rregullores së sipërpërmendur;
- Vendimi Nr.380, datë 30.11.2023 – Rregullorja për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm;
- Vendimi i datës 26.11.2024 – Miratimi i “Metodologjisë së Pikëzimit për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme”, e cila integrohet në Rregulloren për Vlerësimin Etik dhe Profesional.

Grupet e punës të ngritura për këtë proces kanë përfunduar misionin e tyre, dhe analiza e legjislacionit dytësor është pasqyruar në vendimmarrjet përkatëse të KLP-së. Kuadri rregullator i plotësuar ka lejuar vijimin e procesit të vlerësimit, i cili për vitin 2024 ka rezultuar në:

- 5 vlerësime periodike etike dhe profesionale;
- 3 vlerësime të përshpejtuara etike dhe profesionale;
- 1 vlerësim drejtuesi etiko-profesional.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të përafrtojë plotësisht procedurat e tij me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe të rrisë transparencën (pz. 2024-2030)

Institucioni raportues: KED

Informacion mbi zbatimin e masës:

KED 2024 filloi përpjekjet për të rishikuar kuadrin ligjor të funksionimit dhe organizimit të KED, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së vet. Fillimisht veprimtaria e KED 2024 konsistoi në rishikimin e kuadrit ligjor të funksionimit dhe organizimit të KED nëpërmjet analizës së të gjithë procesit të veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ndër vite, me fokus vlerësimin e bazës ligjore që rregullon çështje që lidhen me funksionalitetin, përbërjen, mbështetjen infrastrukturore e financiare për veprimtarinë e tij, me qëllim për të adresuar problematikat e konstatuara në veprimtarinë e viteve të kaluara.

Për këtë qëllim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2024 zhvilloi disa mbledhje në të cilat u diskutua mbi një draft-ligj fillestar të hartuar nga stafi administrativ i Këshillit, ku parashtroheshin problematikat e

	konstatuara në ligjin nr. 115/2016, dhe propozimet përkatëse për dispozita të caktuara, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së tij. Në këtë aspekt, disa çështjet që synonte të rregullonte draft-ligji paraprak, lidheshin me: a) përcaktimin e buxhetit të KED, në funksion të garantimit të të fondeve të nevojshme dhe përdorimin e tyre sipas nevojave nëpërmjet parashikimit të fondi të destinuar në mënyrë të veçantë për KED; b) përbërjen e KED, në funksionin të sigurimit të vazhdimësisë së funksionimit të Këshillit në rast të mobilitetit vertikal apo largimit të anëtarëve të tij c) krijimin e faqes zyrtare ëeb të KED, në funksionin të rritjes së transparencës dhe lehtësisë së aksesit në informacion. d) përfaqshjen e ligjit me legjislacionin për deklarimin e pasurisë, me qëllim reflektimin e kuadrit ligjor të deklarimit të pasurisë edhe në ligjin nr. 115/2016. Në përfundim të diskutimeve të zhvilluara nga të gjithë anëtarët e KED, përfshirjes në diskutim edhe të anëtarëve zëvendësues si dhe të ftuarve, u konkludua në hartimin e një drafti me propozime për ndryshimet në ligjin nr. 115/2016, mbi problematikat e mësipërme, i cili iu përçoll Kuvendit të Shqipërisë.
1.3.3	<i>Organet e qeverisjes së drejtësisë të përfshira në vettingun e anëtarëve të Këshillave ose të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, veçanërisht anëtarëve jo magjistratë duhet të marrin masa të rregullta për rritjen e kapaciteteve për kontrollin e figurës dhe të pasurisë/integritetit. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> <i>Kuvendi, Avokati Popullit</i> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Komisioni i Pavarur Ad-Hoc miratoi paraprakisht Metodologjinë për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale si dhe caktimin e peshës specifike të tyre (pikëzimin) për renditjen e kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve. Kjo Metodologji u hartua mbi bazën e Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, miratuar me Vendimin nr.51, datë 21.06.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Në datat 13 dhe 16 dhjetor u zhvilluan seancat dëgjimore dhe pas përfundimit të seancave dëgjimore, Komisioni i Pavarur Ad-Hoc nisi procesin e vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale si dhe caktimin e peshës specifike të tyre (pikëzimin) për renditjen e kandidatëve. Masa konsiderohet e përcaktuar pasi nuk është ndërmarrë ndonjë analizë nga institucionet përgjegjëse lidhur me përmirësimin e procesit të kontrollit të figurës.
1.3.4	<i>Organet e qeverisjes së drejtësisë dhe të tjerët të përfshirë në vettingun e anëtarëve të Këshillave ose Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, veçanërisht të anëtarëve jo magjistratë kryejnë kontrolle të figurës dhe të pasurisë/integritetit në përputhje me standardet e larta të vetting-ut</i> <u>Institucioni raportues:</u> <i>Kuvendi, Avokati Popullit</i> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Avokati i Popullit, në përputhje me ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", ndoqi procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) nga radhët e avokatëve dhe shoqërisë civile. Pas publikimit nga Kuvendi të vendeve vakante dhe thirrjes për aplikime më 20 korrik 2023, Avokati i Popullit nisi menjëherë procedurat administrative për zhvillimin e procesit, duke siguruar që të gjitha fazat të përmblidheshin në përputhje me afatet dhe kompetencat ligjore. Për të mbështetur këtë proces, më 24 korrik 2023, me urdhër të Avokatit të Popullit u krijua grupi ad-hoc i punës, i cili kishte për detyrë të ndihmonte në verifikimin e kriterëve të kandidatëve dhe të siguronte një proces transparent dhe profesional. Nga faza e parë e shqyrtimit të aplikimeve, rezultoi se kishin shprehur interes gjithsej 29 kandidatë. Nga këta, 6 kishin aplikuar vetëm për KLGJ, 22 për të dyja pozicionet, ndërsa një kandidat kishte dorëzuar aplikimin jashtë afatit.

	Më 24 gusht 2023, Komisioni Ad-Hoc nisi zyrtarisht punën, duke miratuar rregullat dhe procedurat e funksionimit të tij. Procesi u zhvillua nën mbikëqyrjen dhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, të cilët morën pjesë si vëzhgues në çdo fazë. Për të garantuar transparencën, në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit u krijuan dy rubrika të posaçme, ku publiku informohej rregullisht mbi ecurinë e procesit. Gjatë verifikimit të kushteve ligjore dhe integritetit të kandidatëve, Komisioni Ad-Hoc hasi vështirësi për shkak të refuzimit të Prokurorisë së Përgjithshme për të kryer kontrollin e formularëve të deklarimit të integritetit, ndonëse ligji e përcaktonte qartë si kompetencë të saj. Për këtë arsye, Komisioni Ad-Hoc ndërmori një hetim administrativ të thelluar, duke shqyrtuar dokumentacionin e kandidatëve, duke kërkuar informacion shtesë nga institucionet publike dhe duke analizuar të dhënat mbi integritetin dhe përmbushjen e detyrimeve tatimore e ligjore të tyre. Më 7 dhjetor 2023, Komisioni publikoi listën e kandidatëve që plotësonin kriteret ligjore dhe atyre që nuk i përmbushnin ato. Kandidatët e kualifikuar vijuan në fazën e vlerësimit profesional dhe moral, e cila përfshiu zhvillimin e seancave dëgjimore për të vlerësuar më tej përgatitjen dhe përshtatshmërinë e tyre për këto pozicione. Në përfundim të procesit, më 23 janar 2024, Avokati i Popullit i përcolli Kuvendit raportin përfundimtar të vlerësimit, së bashku me gjithë dokumentacionin e plotë të kandidatëve. Nisur nga sfidat e hasura gjatë këtij procesi, Avokati i Popullit vlerëson të domosdoshme ndërmarrjen e ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 115/2016 për të qartësuar përgjegjësitë institucionale, për të përmirësuar afatet kohore të përzgjedhjes, për të siguruar një përzgjedhje më cilësore të kandidatëve dhe për të garantuar mbështetje financiare për institucionin në realizimin e këtij procesi të rëndësishëm.
1.3.5	<i>Cilësia e vendimeve të KLGJ-së dhe KLP-së, duke përfshirë pajtueshmërinë me legjislacionin e brendshëm, acquis të BE-së dhe standardet evropiane, sigurohet nëpërmjet trajnimeve të organizuara. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, KLP</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
1.3.6	<i>KLJG-ja zbaton më tej një program transparence dhe komunikimi për të gjithë elementët e vendimmarrjes së tyre, duke përfshirë vendimet për karrierën, menaxhimin, rekrutimin e stafit, funksionimin e gjykatave dhe monitoron dhe raporton në mënyrë të vazhdueshme publikisht për zbatimin e tij. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLJG) ka vijuar me zbatimin e programit të transparencës dhe komunikimit për të siguruar një proces vendimmarrjeje më të hapur dhe të aksesueshëm për publikun. Në këtë kuadër, janë miratuar dhe zbatuar një sërë dokumentesh dhe masash që synojnë të forcojnë besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor dhe të rrisin nivelin e informimit publik. Një nga zhvillimet kryesore ka qenë miratimi i “Strategjisë së Komunikimit për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, e cila shërben si një udhërrëfyes për mënyrën se si kjo gjykatë duhet të komunikojë me publikun dhe median. Po ashtu, KLJG ka miratuar dhe vënë në zbatim “Planin e Komunikimit për Gjykatat”, një dokument i cili siguron një strukturë të qartë për mënyrën se si do të transmetohen informacionet mbi funksionimin e sistemit gjyqësor. Në këtë drejtim, faja zyrtare e gjykatave në internet është bërë një burim i rëndësishëm për publikun, duke ofruar akses të lehtë në të dhënat zyrtare, përfshirë rubrikën “Programi i Transparencës”, e cila përditësohet rregullisht për të reflektuar vendimet dhe masat e ndërmarra. Në kuadër të transparencës në vendimmarrje, KLJG ka ndërmarrë hapa konkretë për të garantuar informimin e qytetarëve mbi proceset e brendshme të sistemit gjyqësor. Lista e gjyqtarëve që kandidojnë

	në procedurat e lëvizjeve paralele dhe ngritjeve në detyrë publikohet rregullisht në mënyrë që të rritet llogaridhënia dhe besimi në procesin e përzgjedhjes. Po ashtu, emrat e gjyqtarëve të sapoemëruar bëhen publikë, duke mundësuar një nivel të lartë transparence dhe akses të gjerë në këtë kategori informacioni. Vendimmarrjet e KLGJ-së publikohen në mënyrë anonimizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe bëhen të disponueshme përmes njoftimeve për shtyp, duke siguruar një komunikim të vazhdueshëm dhe të strukturuar me median dhe publikun. Në vijim të përpjekjeve për të përmirësuar komunikimin institucional, KLGJ është duke finalizuar Planin e Ri të Komunikimit për periudhën 2025-2027. Ky plan bazohet në një analizë të thelluar të nivelit të zbatimit të Planit të mëparshëm 2022-2024, me synimin për të reflektuar përvojat dhe sfidat e kaluara në mënyrë që të sigurohet një qasje më efektive për të ardhmen. Paralelisht, KLGJ ka vijuar me monitorimin e rregullt të zbatimit të “Planit të Komunikimit për Gjykatat”, të miratuar me vendimin nr. 454, datë 2 nëntor 2022. Çdo gjykatë ka një pikë kontakti të dedikuar, e cila raporton mbi veprimet konkrete të ndërmarra për realizimin e gjashtë objektivave strategjikë të parashikuar në plan. Një tjetër hap i rëndësishëm në këtë proces ka qenë zbatimi i vendimit nr. 716, datë 6 dhjetor 2023, për “Udhëzuesin Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median”. Ky udhëzues synon të forcojë transparencën, të rrisë besimin e publikut dhe të përmirësojë mënyrën se si sistemi gjyqësor komunikohet dhe perceptohet nga media dhe qytetarët. Ai vendos standarde të qarta për marrëdhëniet institucionale dhe përcakton mekanizma efektivë për shpërndarjen e informacionit gjyqësor. Në përfundim të ciklit të zbatimit të Planit të Komunikimit 2022-2024, KLGJ ka nisur një proces vlerësimi të hollësishëm për të kuptuar efektivitetin e masave të zbatuara dhe për të përmirësuar strategjitë e ardhshme. Të dhënat e mbledhura nga ky proces do të shërbejnë si bazë për formulimin e Planit të Ri të Komunikimit 2025-2027, duke siguruar që sistemi gjyqësor të mbetet i hapur, i aksesueshëm dhe në shërbim të qytetarëve.
1.3.7	<i>Miratimi dhe zbatimi i një programi transparence dhe komunikimi nga KLP-ja për të gjithë elementët e vendimmarrjes së tyre, duke përfshirë vendimet për karrierën, menaxhimin, rekrutimin e stafit në funksion të prokurorive si dhe monitorimi dhe raportimi publik vazhdueshëm (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLP</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka vijuar me zbatimin e një programi të strukturuar transparence (linku https://klp.al/ep-content/uploads/2024/07/Programi_i_transparences.1-1.html) dhe komunikimi, i cili mbulon të gjithë aspektet e vendimmarrjes së institucionit, përfshirë çështjet e karrierës, menaxhimin dhe rekrutimin e stafit në funksion të prokurorive. Ky program është miratuar përpara periudhës së raportimit dhe përditësohet periodikisht për të reflektuar zhvillimet e reja dhe për të garantuar qasje të gjerë të publikut në informacionet e nevojshme. Vendimet e KLP-së publikohen në faqen zyrtare të institucionit pas çdo mbledhjeje plenare linku https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/), duke respektuar parashikimet ligjore mbi transparencën dhe aksesin publik në aktet administrative. Në këtë kuadër, qytetarët dhe palët e interesuara mund të konsultojnë të gjitha vendimet në seksionin përkatës të faqes zyrtare të KLP-së. Për sa i përket menaxhimit të stafit, është krijuar një rubrikë e dedikuar që prezanton strukturën organizative dhe anëtarët e stafit të institucionit (linku https://klp.al/stafi-yne/), duke forcuar transparencën në lidhje me funksionimin e brendshëm. Në të njëjtën linjë, proceset e rekrutimit për pozicionet vakante janë tërësisht të hapura dhe informacioni mbi to është i disponueshëm për publikun (linku https://klp.al/category/vende-vakante-ne-sherbimin-civil/), duke siguruar që çdo kandidat të ketë akses të barabartë në mundësitë e punësimit në institucion. Në përputhje me Ligjin Nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, KLP ka publikuar një listë të informacionit që përdoret si burim i hapur, (linku: https://klp.al/2024/10/15/lista-e-informacioneve-qe-perdoret-si-burime-te-hapura/) duke mundësuar qasje të gjerë dhe lehtësimin e ripërdorimit të të dhënave nga publiku dhe aktorët e interesuar. Përditësimi i programit të transparencës realizohet në mënyrë të vazhdueshme, duke përfshirë çdo vendimmarrje të KLP-së pas mbledhjeve plenare si dhe informacione të tjera që lidhen me veprimtarinë


e institucionit. Këto masa synojnë të sigurojnë që KLP të funksionojë në përputhje me standardet më të larta të transparencës dhe llogaridhënies, duke garantuar një marrëdhënie më të hapur dhe të besueshme me publikun dhe institucionet e tjera

Për OS 1.3 është përcaktuar një tregues performance:

Përqindja këshilltarëve/stafit administrativ të KLGJ-së dhe KLP-së të trajnuar për çështje që lidhen me detyrat e tyre funksionale.

Treguesi mat numrin e këshilltarëve dhe administratës së KLGj-së/ KLP-së, të trajnuar mbi detyrat funksionale, në raport me numrin e gjithë këshilltarëve dhe administratës së KLGj-së/ KLP-së përgjatë periudhës së monitorimit. Ky indikator vlerëson vëmendjen që KLGj-ja/ KLP-ja i kushtojnë rritjes profesionale të stafit (në nivel politik dhe administrativ) dhe realizimin faktik të një prej detyrave që KLGj-ja/ KLP-ja kanë në lidhje me trajnimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe synohet që treguesi të ketë një tendencë në rritje vit pas viti.

Bazuar në raportimet e KLGJ dhe KLP për vitin 2024, KLGJ ka trajnuar 27.6 % të këshilltarëve/stafit administrativ për çështje që lidhen me detyrat e tyre funksionale ndërsa KLP ka trajnuar 100 %, duke raportuar një trajnim të plotë të këshilltarëve/stafit administrativ për çështje që lidhen me detyrat e tyre funksionale me të paktën një trajnim.



Obiektivi Specifik 1.4.

Plani i Veprimit për Obiektivin 1.4 parashikon parashikon tre (3) masa por vetëm 2 masa janë të zbatueshme për vitin 2024, prej të cilave **2 masa janë zbatuar pjesërisht**. 0% e masave janë zbatuar plotësisht.

OS. 1.4. - Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimi thelbësor i komunikimit publik

Kapaciteti i duhur i institucioneve të drejtësisë për të siguruar bashkëpunimin e duhur, si dhe mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin për avancimin e reformës në drejtësi. (pz. 2024-2030)

Institucioni raportues: MD, Institucionet zbatuese të strategjisë

Informacion mbi zbatimin e masës:

Institucionet e drejtësisë kanë ndërmarrë hapa konkretë për të garantuar kapacitetin e duhur në mbledhjen, monitorimin dhe raportimin e të dhënave, duke siguruar bashkëpunimin e nevojshëm për avancimin e reformës në drejtësi. Në këtë drejtim, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka caktuar dy përfaqësues në Grupin Ndërinstitucional për Integrimin Europian (GNPIE), të cilët koordinojnë dhe ofrojnë mbështetjen e kërkuar për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave sipas kërkesave të Ministrisë së Drejtësisë. Përfaqësuesit e ILD-së kanë marrë pjesë rregullisht në takimet e GNPIE-së, duke dhënë kontributin e tyre për përmirësimin e objektivave të reformës.

1.4.1 Për të përmirësuar më tej procesin e monitorimit dhe raportimit, ILD ka ndërmarrë një analizë të brendshme që ka çuar në riorganizimin e disa njësive të strukturës organizative. Kjo ka mundësuar një menaxhim më efikas të të dhënave, duke përfshirë numrin e ankesave, hetimeve, kërkesave për procedim dhe inspektimeve, të cilat përbëjnë bazën e ushtrimit të funksioneve të këtij institucioni. Gjenerimi në kohë i këtyre të dhënave siguron një panoramë të qartë të progresit të reformës në drejtësi.

Një tjetër hap i rëndësishëm në këtë drejtim ka qenë organizimi i mbledhjes së përbashkët vjetore mes Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) më 10 maj 2024, në përputhje me detyrimin ligjor të përcaktuar nga neni 170 i Ligjit Nr. 115/2016. Pas kësaj mbledhjeje, të dy institucionet zhvilluan një tryezë të rrumbullakët për të diskutuar dhe hartuar draft-rregulloren e përbashkët “Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje”. Ky proces u finalizua me miratimin e Rregullores përkatëse nga KLP me vendimin Nr. 112, datë 9 korrik 2024, duke formalizuar një mekanizëm të ri disiplinor për raste të ndërlidhura mes gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në nivel institucional, është krijuar një strukturë e dedikuar brenda Shkollës së Magjistraturës, e cila ka për detyrë mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave të kërkuara në funksion të reformës në drejtësi. Për më tepër, detyrimet që rrjedhin nga Udhërrëfyti për reformën dhe dokumentet e tjera strategjike janë integruar në Strategjinë e Brendshme të Shkollës dhe po zbatohen si pjesë e Projektit të Binjakëzimit të financuar nga Bashkimi Europian.

Vijimi i bashkëpunimit të Këshillave duke intensifikuar mbledhjet e përbashkëta dhe sigurimin e komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun për ndjekjen e konkluzioneve të mbledhjeve. (pz. 2025-2030)

1.4.2 **Institucioni raportues:** KLGJ, KLP

Informacion mbi zbatimin e masës:

Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.

1.4.3 *Planet e komunikimit dhe transparencës të përgatitura nga KLGJ-ja, KLP-ja, SPAK, Gjykatat e Posaçme dhe MD-ja, për të zhvilluar më tej mirëkuptimin dhe rritjen e besimit të publikut tek reforma në drejtësi. (pz. 2024-2030)*

Institucioni raportues: SPAK, KLGJ, KLP, Gjykatat e Posaçme

Informacion mbi zbatimin e masës:

SPAK ka përfunduar Strategjinë e Komunikimit 2025-2028, e cila përfshin menaxhimin e krizave dhe strategjinë për mediat sociale, me qëllim garantimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë publike. Në faqen zyrtare publikohen njoftime mbi hetimet dhe ekziston një dritare “Denonco” për kallëzime qytetare. Një Koordinator për Marrëdhëniet me Mediat është emëruar në tetor 2024 për të trajtuar kërkesat për informacion dhe organizuar takime periodike me gazetarët. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve publikohet çdo muaj. Zbatimi i Planit Vjetor të Komunikimit do të monitorohet nga struktura përkatëse gjatë vitit 2025. Prokuroria e Posaçme ka përfunduar hartimin e Strategjisë së komunikimit për vitin 2025-2028.

KLP ka emëruar një Koordinator për të Drejtën për Informim me Urdhër Nr.152, datë 20.09.2024, i cili menaxhon regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, pasqyruar në faqen zyrtare. Komunikimi me publikun realizohet përmes rrjeteve sociale dhe buletinit mujor në shqip dhe anglisht. KLP po finalizon Strategjinë për Komunikimin me Median dhe Publikun, duke përfshirë objektivat dhe një plan gjithëpërfshirës komunikimi.

Më 12.11.2024, KLP dhe EU4Justice organizuan “Forumin e Medias” për standardet mediatike të BE-së dhe problematikat e rregullores për komunikimin me median. Si rezultat, më 10.12.2024, Këshilli diskutoi shfuqizimin e kësaj rregulloreje dhe shqyrtimin e një kuadri të ri ligjor. Komunikimi institucional gjatë 2024-s u mbështet në kanale elektronike, postë dhe publikime në rrjetet sociale. Deri tani, KLP ka raportuar për këto çështje në raportin vjetor të depozituar në Kuvend.

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe të gjitha gjykatat kanë emëruar nëpunësin përgjegjës që ushtron funksionin e koordinatorit për të drejtën e informimit, në përputhje me masën 1.3.6.2.

Gjykatat kanë vijuar raportimin periodik çdo tre muaj pranë KLGJ-së mbi zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Komunikimit për Gjykatat. KLGJ publikon në faqen zyrtare listën e gjyqtarëve që kandidojnë në procedurat e lëvizjeve paralele dhe ngritjeve në detyrë, si dhe emrat e gjyqtarëve të sapoemëruar, duke garantuar transparencën dhe aksesin e publikut në këtë kategori informacioni. Po ashtu, të gjitha vendimmarrjet e KLGJ publikohen në mënyrë të anonimizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe shpërndahen përmes njoftimeve për shtyp.

Aktualisht, KLGJ është duke finalizuar hartimin e Planit të Ri të Komunikimit 2025-2027 për sistemin gjyqësor. Për këtë qëllim, po vlerësohet niveli i zbatimit të masave të Planit të mëparshëm 2022-2024, për të reflektuar përvojat dhe përmirësimet e nevojshme në planin e ri.

Ndërkohë, KLGJ ka vijuar monitorimin periodik të zbatimit të "Planit të Komunikimit për Gjykatat", të miratuar me vendimin nr. 454, datë 02.11.2022. Monitorimi është kryer nëpërmjet raporteve të dërguara nga pikat e kontaktit të çdo gjykate, duke ndjekur veprime konkrete për realizimin e 6 objektivave strategjikë të parashikuar në këtë plan.

Gjithashtu, vijon edhe zbatimi i vendimit nr. 716, datë 06.12.2023, “Udhëzuesi Standard i Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median”, i cili synon rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe kuptueshmërisë së veprimtarisë gjyqësore nga publiku dhe media, përmes standardizimit të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median.

Gjykata e Posaçme e Apelit zbaton Planin e Komunikimit për Gjykatat, miratuar nga KLGJ, dhe Strategjinë e Komunikimit, miratuar nga Këshilli i saj, për të siguruar informimin e publikut. Këshilli ka emëruar Specialistin për Marrëdhëniet me Publikun, Median dhe me Jashtë, i cili njëkohësisht shërben si Koordinator për të Drejtën e Informimit.

Gjykata raporton çdo tre muaj pranë KLGJ mbi zbatimin e Planit të Komunikimit, duke garantuar transparencë dhe informim të vazhdueshëm.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka miratuar Planin Vjetor të Komunikimit dhe raporton çdo tre muaj pranë KLGJ mbi monitorimin dhe zbatimin e tij.

Me Vendimin nr. 16, datë 15.07.2024, Këshilli i Gjykatës ka vendosur transferimin e përkohshëm të Znj. Elsa Lita për një periudhë 6-mujore në pozicionin e "Specialistit të Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë" brenda Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun.

Deri në shtator 2024, janë dorëzuar raportet tre mujore për monitorimin dhe zbatimin e Planit të Komunikimit. Raporti i fundit, që mbulon muajt tetor, nëntor dhe dhjetor, do t'i dërgohet KLGJ brenda janarit 2025.

Për OS 1.4 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***Numri i takimeve të përbashkëta të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional***

Treguesi synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të detyrimit ligjor që Këshillat të zhvillojnë të paktën një mbledhje të përbashkët në vit me pjesëmarrjen e Ministrisë së Drejtësisë, sipas Nenit 170 të Ligjit nr. 115/2016 për qeverisjen. Ai do të raportohet çdo vit, duke marrë parasysh parashikimet ligjore që synojnë forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) do të raportojnë numrin e mbledhjeve të përbashkëta, duke përfshirë edhe Ministrinë e Drejtësisë, sipas targeteve të përcaktuara. Çdo mbledhje shtesë, event i përbashkët, konferencë apo aktivitet tjetër me këtë qëllim do të konsiderohet një tregues pozitiv për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.


Më 10 maj 2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) zhvilluan mbledhjen e përbashkët vjetore, në përputhje me nenin 170 të Ligjit Nr. 115/2016, për të forcuar mekanizmat disiplinorë në sistemin e drejtësisë. Pas kësaj, dy institucionet organizuan një tryezë të rrumbullakët për hartimin e një draft-rregulloreje mbi bashkimin e procedimeve disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët e përfshirë në të njëjtën shkelje. Ky proces u përmbyll me miratimin e Rregullores nga KLP me vendimin Nr. 112, datë 9 korrik 2024, duke krijuar një mekanizëm të ri disiplinor për raste të ndërlidhura. Për vitin 2024 treguesi raportohen në vlerën 1 (takim).

3.2.2 Qëllimi i Dytë i Politikës


Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë

Qëllimi i Dytë i Politikës: 16 masa

13 masa të zbatueshme



- Plotësisht të zbatuara
- Pjesërisht të zbatuara
- Të pazbatuara



Objektivi Specifik 2.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.1 parashikon parashikon 2 masa, prej të cilave 2 masa janë zbatuar pjesërisht. 0% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.1: Garantimi i emërimeve dhe zhvillimit të karrierës së magistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci.

	<i>Këshillat plotësojnë rregullat e tyre të brendshme me qëllim emërimin dhe zhvillimin e karrierës së magistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLP, KLGJ</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Në zbatim të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, KLGJ ka kryer në çdo rast verifikimin e kriterit të pasurisë dhe figurës përpara ngritjeve në detyrë të gjyqtarëve. KLGJ ka angazhuar një këshilltar ekonomik në mbështetje të komisioneve të përhershme dhe KLGJ, në varësi të ngarkesës do të vlerësoj më tej ngritjen e një mekanizmi të posaçëm. Në bazë të përcaktimeve ligjore, KLGJ miraton programin e vlerësimeve të gjyqtarëve periodikisht çdo vit kalendarik. Konkretisht, me vendimin nr. 18, datë 18.01.2024 ka miratuar programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024, si dhe me vendimin nr. 679, datë 20.11.2024 ka miratuar programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2025. KLP raporton se lidhur me procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës, ky proces zhvillohet sa herë shpallen procedura për ngritjen në detyrë, për të gjithë kandidatët konkurrues, sipas standardeve të procesit të rivlerësimit. KLP monitoron procedurat e kalimit të vetingut dhe në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në pozicion drejtuesi apo SPAK, vendimmarrjet kanë qenë në përputhje me vendimet përfundimtare të vetingut. Me vendimin Nr.381, datë 30.11.2023, KLP miratoi programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional individual përgjatë vitit 2024. Me vendimin Nr.406, datë 28.12.2023, KLP miratoi caktimin me short të prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit 2024. Më parë KLP me vendimet Nr.140, datë 6.6.2022 dhe Nr.313, datë 30.11.2022 ka miratuar programet që përcaktojnë listën e prokurorëve që do të vlerësohen përgjatë viteve 2022 dhe 2023. Njëkohësisht, me vendimet Nr.65, datë 17.05.2024 dhe Nr.73, datë 10.06.2024, KLP ka miratuar listën e vlerësimeve të përshpejtuara, në referim të nenit 97 të ligjit Nr.96/2016, me kërkesë të magistratit. Komisioni përkatës i Vlerësimit ka realizuar takime në vijueshmëri me EU4Justice me synim reduktimin e numrit të mbetur të vlerësimeve.
2.1.2	<i>KLGJ-ja dhe KLP-ja sigurojnë më tej promovimin transparent të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke publikuar rregullisht procedurat e ngritjes në detyrë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLP, KLGJ</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Gjatë vitit 2024 KLGJ ka ngritur në detyrë 4 gjyqtarë (3 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 1 në Gjykatën Administrative të Apelit). KLGJ nis procesin duke shpallur një thirrje për aplikime për pozicionet vakante, duke ftuar gjyqtarë të kualifikuar që plotësojnë kriteret e përcaktuara. Pas mbylljes së afatit të aplikimit, KLGJ publikon listën e kandidatëve të kualifikuar në faqen e tij zyrtare, duke siguruar një procedurë të qartë dhe transparente. Gjithashtu KLGJ publikon në faqen zyrtare të internetit vendimet e arsyetuara, të anonimizuara sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Për vitin 2024, rezultojnë 75 vakanca të përhershme dhe 61 vakanca të përkohshme në sistemin gjyqësor. Problematikat që ndikojnë në procedurat e ngritjes në detyrë janë faktorë të cilët nuk varen vetëm nga Këshilli. Të tillë janë: procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, proceset gjyqësore që shoqërojnë këto procedura (ankimet lidhur me vlerësimin etik-profesional, vendimmarrjet e organeve të rivlerësimit. Në mënyrë të veçantë për ngritjet në detyrë në gjykatat e posaçme veprimtaria verifikuese e Këshillit për kandidatët në këto pozicione është e ndërruar nga veprimtaria e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve që është pjesë e strukturës së institucioneve që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Ndërkohe KLP, përgjatë vitit 2024, ka kryer 3 procedura të ngritjes në detyrë në pozicion drejtuesi (1 riemërim dhe 2 ngritje në detyrë) dhe nuk ka kryer procedura të ngritjes në detyrë si prokuror nga një prokurori e nivelit të ulët, në një prokurori të një niveli më të lartë. Nga këto tre procedura, për 1 drejtues është kryer procesi i vlerësimit etik dhe profesional në pozicion drejtuesi sipas ligjit Nr.96/2016, ndërsa dy drejtuesit e tjerë kanë konkurruar, duke patur vlerësimet e kryera përpara Reformës në Drejtësi. Në këtë këndvështrim, KLP po punon intensivisht për hartimin dhe miratimin e sa më shumë raporteve etike dhe profesionale, për të ruajtur standardet e barabarta të kandidatëve. Nga ana tjetër, KLP publikon në kohë shpalljet për shprehje interesi dhe të gjithë procesin vendimmarrës sipas hapave përkatës (kushtet ligjore, renditje etj.), në funksion të transparencës dhe komunikimit të drejtëpërdrejtë me të interesuarit dhe çdo palë të tretë.

Për OS 2.1 janë përcaktuar dy tregues performance:

- ***Përqindja e magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) për të cilët është përfunduar vlerësimi i rregullt etik dhe profesional nga KLGJ/KLP në përputhje me planin vjetor respektiv, sipas nivelit të vlerësimit.***

Treguesi synon të masë performancën e Këshillave (KLGj/KLP) në ushtrimin e një prej funksioneve kryesore të tyre, atij të vlerësimit të rregullt periodik të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve etike dhe profesionale (Neni 84 i Ligjit për Statusin), në funksion të vlerësimit të profesionalizmit, si dhe krijimit të premisave për ngritjen në detyrë ose levizje paralele. Treguesi mat punën e KLGj/KLP lidhur me procesin e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, duke analizuar në shifra masën në të cilën Këshillat zbatojnë në praktikë planifikimin e bërë lidhur me vlerësimin periodik të magjistratëve. Përqindja e gjyqtarëve/prokurorëve të vlerësuar, në raport me numrin e gjyqtarëve të planifikuar për t'u vlerësuar, jep të dhëna mbi përmbushjen e kompetencës së KLGj/KLP kundrejt vlerësimit etik e profesional të gjyqtarëve/prokurorëve.

Për vitin 2024, KLGJ në Programin e Vlerësimit Etik e Profesional të vitit 2024 ka parashikuar vlerësimin për 35 gjyqtarë dhe Këshilli ka miratuar 34 raporte vlerësimi për 31 gjyqtarë, duke pasur në fokus vlerësimet në kuadër të zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve.

Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka realizuar vlerësime periodike për 11% të prokurorëve, sipas planeve vjetore të viteve 2022, 2023 dhe 2024. Të gjithë prokurorët janë vlerësuar me nivelin "shkëlqyeshëm". Përqindja e llogaritur përfshin 5 vlerësime periodike, 3 vlerësime të përshpejtuara dhe një vlerësim drejtuesi. Me vendimin Nr.100, datë 18.06.2024, KLP miratoi disa ndryshime në Rregulloren "Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve", ndërsa me vendimin Nr.111, datë 27.06.2024, miratoi ndryshimet në ankesat Nr.2, 5, 6 dhe tabelat përkatëse të rregullores.

Këto ndryshime mundësuan miratimin e 9 vendimeve të para të vlerësimit, me prioritet për "backlog"-un e vlerësimeve të mbetura. Nga këto 9 vlerësime, vetëm 3 i përkasin planit vjetor të vitit 2024, duke rezultuar që vetëm 6.3% e prokurorëve të kenë një vlerësim periodik për këtë vit.


➤ ***Përqindja e magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) në sistemin e drejtësisë të vlerësuar me të paktën një vlerësim të plotë etik dhe profesional.***

Qëllimi i treguesit është të vlerësojë nivelin e monitorimit të rregullt të standardeve etike dhe profesionale të magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) në sistemin e drejtësisë gjatë karrierës së tyre. Treguesi mat përqindjen e magjistratëve, sipas kategorisë, që kanë marrë të paktën një vlerësim të plotë etik dhe profesional (neni 84 i Ligjit për Statusin). Vleresimet e rregullta etike dhe profesionale sigurojnë panshmërinë, meritokracinë dhe transparencën e procedurave për ngritjen në detyrë ose lëvizje paralele, të cilat bazohen në vlerësimet periodike të magjistratëve. Kjo është një pjesë thelbësore e sigurimit të integritetit dhe besueshmërisë së sistemit gjyqësor.

KL Gj raporton se deri në përfundim të vitit 2024 janë 115 gjyqtarë të cilët janë vlerësuar me të paktën një vlerësim të plotë etik dhe profesional nga 272 gjyqtarë efektivë.

Ndërkohë KLP raporton se nga organika prej 341 prokurorë, deri në datën 31.12.2024 ka patur 218 prokurorë efektivë. Shifra në total është 9 vlerësime të plota etike dhe profesionale. Këto 9 vlerësime janë miratuar në vitin 2024 dhe nuk ka patur vlerësime të tjera të kryera për vitet paraardhëse.

% e magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) në sistemin e drejtësisë të vlerësuar me të paktën një vlerësim të plotë etik dhe profesional.



Objektivi Specifik 2.2.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.2 parashikon 3 masa, prej të cilave **2 masa janë zbatuar plotësisht dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht**. 66.7% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 2.2 Forcimi i kapaciteteve institucionale, magjistratëve edhe jomagjistratëve për parandalimin dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme.

2.2.1 ***Forcimi i integritetit dhe trajnimi i ofruar nga Shkolla e Magjistraturës dhe institucionet e qeverisjes. (pz. 2024-2030)***

Institucioni raportues: KLP, KL Gj, SHM

	<u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Shkolla e Magjistraturës garanton standardet e pavarësisë, paanësisë, transparencës dhe llogaridhënies në cdo proces vendimmarrës të saj dhe siguron, me anë të tyre, cdo proces rekrutues në Shkollë, duke nisur nga rekrutimi i kandidatëve për në Programin e Formimit Fillestar, e duke vijuar me rekrutimin e stafit pedagogjik, të brendshëm dhe të jashtëm, në të gjitha programet trajnuese në Shkollë. Nëse ligji do të sjellë ndryshime në kriteret vlerësimi apo rekrutimi, ato do të zbatohen nga SHM. Shkolla e ka përfshirë trajnimin mbi çështjet që parashikohen në këtë masë në të dy programet e saj dhe zbaton mekanizma vlerësimi për matjen e tyre. Shkolla është në proces reformimi dhe ndryshimi të kurrikulave të saj dhe është parashikuar dhe miratuar një rritje e elementëve trajnues dhe vlerësues të këtyre çështjeve në kurrikulën që ofron. Projekti i Binjakëzimit po asiston në këto përmirësime. Në vitin 2024 janë organizuar disa trajnime për magjistratët mbi temat e etikës, paragjyqimeve, korrupsionit dhe integritetit. Në total, kanë marrë pjesë 274 persona në trajnimet e mëposhtme: • Etika dhe Integriteti Gjyqësor (3 ditë, 31 janar – 2 shkurt) – 31 pjesëmarrës. • Paragjykimet dhe njëanshmëria e pavetëdijshme në gjykim (1 ditë, 15 shkurt) – 5 pjesëmarrës. • Prezumimi i pafajësisë (1 ditë, 29 mars) – 21 pjesëmarrës. • Veprat penale të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të lartë (1 ditë, 4 prill) – 8 pjesëmarrës. • Korrupsioni aktiv i funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve vendorë (1 ditë, 5 prill) – 23 pjesëmarrës. • Korrupsioni aktiv në sistemin e drejtësisë dhe juridik ndërkombëtar (1 ditë, 25 prill) – 16 pjesëmarrës. • Paragjykimi dhe njëanshmëria (3 ditë) – 49 pjesëmarrës. • Integriteti (3 ditë) – 65 pjesëmarrës. • Paanshmëria (3 ditë) – 56 pjesëmarrës. Trajnimet kanë trajtuar temat e etikës, paragjyqimeve dhe ndikimit të tyre në vendimmarrjen gjyqësore, korrupsionin aktiv në sistemin e drejtësisë dhe rëndësinë e integritetit dhe paanshmërisë së magjistratëve. Ndërkohë KLGJ me vendimin nr. 71, datë 20.02.2024 ka miratuar Raportin vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2023. Këshilltari i Etikës nuk ka vendosur rekomandime për tu ndjekur gjatë vitit 2024, por në vijimësi të raportimeve të tij, ka bërë me dije se në mbështetje të nenit 83, pika 4, shkronja c) të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, është duke vijuar puna për hartimin e një manuali të etikës gjyqësore. KLP raporton se nuk ka zhvillime për këtë periudhë.
2.2.2	<i>Këshillat reagojnë ndaj deklaratave publike ku ushtrohet ndikim i padrejtë mbi magjistratët dhe marrin masa parandaluese. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLP, KLGJ</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> KLGJ raporton se kjo masë zbatohet në vazhdimësi në bazë të rasteve të ndikimit të padrejtë të ushtruar ndaj gjyqtarëve. Gjatë vitit 2024, KLGJ ka dalë me 3 deklarata publike në mbrojtje të gjyqtarëve ndaj të cilëve është ushtruar ndikim i padrejtë. Për periudhën raportuese në Këshillin e Lartë Gjyqësor janë paraqitur 2 kërkesa për mbrojtje për influencë të padrejtë nga gjyqtarët dhe në raste të tjera është vijuar me deklaratat publike mbi bazë të informacioneve mediatike. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka mbrojtur publikisht pavarësinë dhe integritetin e Prokurorisë së Posaçme (SPAK) përballë presioneve dhe sulmeve denigruese. Më 16 prill 2024, KLP dënoi gjuhën fyese dhe çdo përpjekje për të ndikuar apo intimiduar prokurorët e SPAK, duke theksuar se çdo kundërshtim ndaj veprimtarisë së tyre duhet të trajtohet në rrugë ligjore. Më 11 nëntor 2024, KLP rikonfirmoi mbështetjen e saj për SPAK, duke e konsideruar çdo formë presioni ndaj prokurorëve dhe drejtuesit të tyre si kërcënim serioz për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.
2.2.3	<i>Mbledhja e të dhënave, analiza dhe vlerësimi i çështjeve ku Këshillat do të reagojnë përmes deklaratave publike ndaj presionit politik, intimidimit dhe akuzave ndaj magjistratëve. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, KLP</u>

Informacion mbi zbatimin e masës:

Këshilli i Lartë Gjyqësor me nismë ose bazuar në kërkesat e gjyqtarëve, mund të bëjë deklarata publike në mbrojtje të gjyqtarëve të veçantë kur gjykon se të drejtat e tyre njerëzore rrezikohen të shkelen për shkak të kryerjes së detyrës, ose se kryerja e funksioneve të tyre ligjore po rrezikohet ose mund të rrezikohet si rezultat i veprimeve ose qëndrimeve të çdo subjekti publik ose privat. Pra, vlerësimi dhe analizimi i çështjeve bëhet rast pas rasti nga Këshilli.

KLP raporton se në dhënien e deklaratave nuk ka patur kërkesë nga ndonjë subjekt. Këshilli ka vlerësuar dhe analizuar kryesisht pengimin që i bëhet punës së Prokurorisë së Posaçme në ushtrimin e kompetencave të dhëna me ligj, nga gjuha denigruese dhe fyese e subjekteve të treta.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka mbrojtur publikisht pavarësinë dhe integritetin e Prokurorisë së Posaçme (SPAK) përballë presioneve dhe sulmeve denigruese. Më 16 prill 2024, KLP dënoi gjuhën fyese dhe çdo përpjekje për të ndikuar apo intimiduar prokurorët e SPAK, duke theksuar se çdo kundërshtim ndaj veprimtarisë së tyre duhet të trajtohet në rrugë ligjore. Më 11 nëntor 2024, KLP rikonfirmoi mbështetjen e saj për SPAK, duke e konsideruar çdo formë presioni ndaj prokurorëve dhe drejtuesit të tyre si kërcënim serioz për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Për OS 2.2 është përcaktuar një tregues performance:

- ***Shkalla (%) e përdorimit të shortit elektronik në hedhjen e shortit për plotësimin e trupit gjykues***

Qëllimi i treguesit është të vlerësojë nivelin e përdorimit të rregullt të mekanizmit elektronik për ndarjen e rastësishme të çështjeve. Zhvillimi i shortit në gjykata kryhet nëpërmjet algoritmeve që vërtetojnë autenticitetin e shortit, integritetin e të dhënave, sigurinë dhe auditimin e tyre. Sipas rregullores nr.554 date 19.12.2022 të KLGJ për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore, me paraqitjen në gjykatë, çështjet regjistrohen menjëherë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe Kryetari i Gjykatës merr masa për organizimin e ndarjes së çështjeve nëpërmjet shortit elektronik. Ndarja e çështjeve me short, si rregull, realizohet çdo ditë pune në rrugë elektronike dhe në rast pamundësie të realizimit të shortit brenda ditës së punës, çështjet e regjistruara shortohen jo më vonë se dita e nesërme e punës. Gjithashtu, rregullat mbi ndarjen me short të çështjeve gjyqësore parashikojnë se "në rastin kur sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk funksionin në mënyrë të dokumentuar, për më shumë se dy ditë pune, ndarja e çështjeve realizohet përmes shortit manual" i cili kryhet duke respektuar parimin e transparencës, ndarjes së barabartë të çështjeve mes gjyqtarëve të së njëjtit seksion, si dhe caktimit rastësor të gjyqtarëve. Treguesi synon të masë nivelin e përdorimit të shortit elektronik në një fushë specifike, atë të ndarjes së çështjeve me short në lidhje me plotësimin e trupit gjykues.

KLGJ raporton se për vitin 2024, të gjitha gjykatat përdorin sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS, me përjashtim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (GJSHPJP Tiranë) dhe Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO). Shortimi elektronik për plotësimin e trupës gjykuese është implementuar në GJKKO në muajin shtator 2024 ndërsa në GJSHPJP Tiranë pritet të implementohet brenda 3 muajit të parë të 2025.

Shkalla në % e përdorimit të shortit elektronik për plotësimin e trupit gjykues për gjykatat që

përdorin ICMIS është 100%.

KLJGJ nuk kryen monitorime mbi shkallën e përdorimit në % të shortimit manual lidhur me plotësimin e trupave gjyqësore, pasi ky monitorim referuar kuadrit ligjor bëhet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Objektivi Specifik 2.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.3 parashikon 3 masa, prej të cilave **2 masa rezultojnë të pazbatuara** dhe 1 masë rezulton e pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 0% e masave (të zbatueshme) janë plotësisht të zbatuara.

Objektivi specifik 2.3 Sigurimi i zbatimit të njëtrajtshëm të standardeve të ndarjes së rastësishme të çështjeve.	
2.3.1	<i>Monitorimi i vazhdueshëm kryhet nga Këshillat lidhur me çështjet gjyqësore penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në gjyqësor. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KLJGJ, KLP <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
2.3.2	<i>KLJGJ-ja kryen një analizë për vendosjen e sistemit të paralajmërimit të hershëm të monitorimit të ndarjes së çështjeve nga gjykatat për të garantuar zbatimin konsistent të ndarjes së rastësishme të çështjeve dhe masat e duhura korrigjuese kur është e nevojshme. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KLJGJ <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Zhvillimi i shortit në njësi përpunimi dhe ruajtje kryhet nëpërmjet algoritmeve që vërtetojnë autenticitetin e shortit, integritetin e të dhënave, sigurinë dhe auditimin e tyre. Sistemi i shortit përdor algoritme për autentifikimin e gjykatës që kërkon procesin e shortimit. Çdo gjykatë përdor “çelësa të ndarë” (shared key) për të gjeneruar kod unik të çastit (One Time Passëord). Kjo procedurë synon garantimin e procedimit të mesazheve të dërguara vetëm nga gjykatat dhe çdo mesazh i tillë ka një autentifikimin të paimitueshëm në rast të gjurmimeve në rrjet (Man In The Middle Attacks). Të dhënat e shortimeve ruhen të plota, në mënyrë historike, të lidhura në mënyrë unike të paimitueshme me mesazhet sekuenciale, duke bërë procesin e auditueshëm dhe të dhënat e pa modifikueshme. Sistemi elektronik i shortimit auditohet në mënyrë të automatizuar, nëpërmjet verifikimit të ekuivalencës së rezultatit të ruajtur lokalisht me atë në sistemin qendror dhe verifikimit të kodeve për të garantuar integritetin e bllokut të informacionit të ruajtur. Sistemi elektronik i shortimit prodhon raporte periodike të auditimit ose mbi bazë të kërkesave për auditim (gjurmim) nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Zhvillimi mbi ndarjen e çështjeve me short është kryer në kuadër të kontratës së lidhur mbi shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit të çështjeve gjatë vitit 2023 (Kontrata 71/6, datë 20.02.2023), në zbatim të vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Neni 92, të ligjit nr.115/2016, i ndryshuar, ka parashikuar përgjegjësitë e Këshillit në bashkëpunim me QTI në të cilën nuk përfshihet kryerja e një analize të sistemit.

	Sa më sipër, struktura e IT në bazë të nevojave dhe kërkesave të gjykatave kryhen çdo vit një vlerësim të këtyre kërkesave me qëllim marrjen e masave për të përmirësuar veprimtarinë e punës së gjykatave në lidhje me teknologjinë e informacionit. Në bazë të kësaj kryhen dhe planifikimet buxhetore. Masa konsiderohet e përealizuar, pasi nuk janë ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për vendosjen e sistemit të paralajmërimit të hershëm, duke përfshirë kryerjen e analizës së nevojshme. Mungesa e kësaj analize pengon vendosjen efektive të sistemit dhe cenon besimin në transparencën dhe integritetin e sistemit gjyqësor, ku ndarja manuale e çështjeve mbetet një problematikë e vazhdueshme.
2.3.3	<i>KL GjJ-ja dhe PP, sigurojnë se rregullat për ndarjen e rastësishme të çështjeve zbatohen në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme në gjykata dhe prokurori bazuar në kritere transparente dhe të drejta. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KL GjJ, PP</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> KL GjJ ka miratuar vendimin nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore". KL GjJ raporton se inspektimi i shortit referuar ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" është kompetencë e ILD. Rishikimi i rregullave të ndarjes apo rindarjes me short të çështjeve gjyqësore do të vlerësohet nga Këshilli në vijim nëse ka nevojë për rishikim, ndërkohë Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen analiza nga pikëpamja teknike mbi funksionimin e modulit në gjykata, referuar nenit 92, të ligjit nr. 115/2016. Problematika e hasura janë zgjidhur pa cenuar veprimtarinë e punës dhe procesin e shortimit. Pasi janë konstatuar janë marrë masat për tu zgjidhur menjëherë. Në të ardhmen synohet përmirësimi i modulit duke aplikuar teknologji blockchain në sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve. PP raporton se CAMS sistemi aktual i menaxhimit të çështjeve mundëson ndarjen rastësore të çështjeve në të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Në zbatim të kritereve ligjore dhe përcaktimeve të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3/2016, datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori", (i ndryshuar), prokuroria siguron që nëpërmjet përdorimit të sistemit CAMS të realizohet ndarja e rastësishme e çështjeve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, duke siguruar transparencë në shpërndarjen e çështjeve dhe garantim të pavarësisë e paanshmërisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve, edhe nëpërmjet këtij procesi. Prokuroria e Përgjithshme dhe për 9 muajt në 2024 nëpërmjet strukturave përkatëse, Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Sektorit të Monitorimit, ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit nr. 3/2016, si nëpërmjet kërkesave për informacion ashtu dhe nëpërmjet monitorimit të sistemit CAMS, me qëllim mbështetjen teknike të prokurorëve. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, shorti elektronik përdoret sistematikisht në bazë të regjistrimeve ditore, dmth kallëzimi/referimi penal që regjistrohen gjatë një dite, shortohen mes prokurorëve sipas rastit të seksionit ose prokurorisë përkatëse. Shorti kryhet automatikisht sapo bëhet regjistrimi i kallëzimit/referimit penal në sistem, i cili nëpërmjet një algoritmi përzgjedh prokurorin në mënyrë të rastësishme. Sistemi i ndan në numër të barabartë kallëzimet/referimet penale të regjistruara brenda një seksioni apo prokurorie të caktuara brenda një dite. Për sa i përket shqyrtimit dhe vlerësimit nga KL GjJ-ja dhe PP-ja të rregullave për ndarjen rastësore të çështjeve në gjykata dhe prokurori, duke përfshirë përjashtimet. PP raporton se nuk ka kontribut shtesë referuar kësaj masë për vitin 2024. Në kontributin e përcjellë janë përshkruar me detaje hapat e ndjekur për ndarjen rastësore të çështjeve. Të gjitha materialet referuese në prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, i nënshtrohen shortimit elektronik. Kallëzimet/referimet penale, apo ngjarjet kriminale që ndiqen dhe regjistrohen në ditët që prokurori ka gadishmerinë sipas grafikut përkatës nuk hidhen në short, por i caktohen në mënyrë manuale në sistem prokuroritë të gadishmërisë, për arsye se ky prokuror ka filluar kryerjen e veprimeve procedurale dhe është regjistruar procedimi sipas ligjit (neni 287 Kodit të Procedurës Penale), në emrin e këtij prokurori.

Masa do të konsiderohet e përealizuar për vitin aktual, pasi nuk vihet re progres nga institucionet përgjegjëse në rishikimin e rregullave për ndarjen e rastësishme të çështjeve, ndonëse kjo problematikë është raportuar vazhdimisht. Këto rregulla duhet të rishikohen pavarësisht kontrolleve të ILD-së, pasi ky proces përbën një pjesë integrale të veprimtarisë së institucioneve dhe është thelbësor për garantimin e transparencës dhe integritetit në sistemin gjyqësor.

Për OS 2.3 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***Numri i trajnimeve dhe pjesëmarrësve (magjistratë dhe anëtarë të institucioneve) mbi tematika lidhur me rastet e ndërhyrjeve të brendshme dhe të jashtme***


Qëllimi i këtij treguesi është të vlerësojë dhe monitorojë numrin e trajnimeve të ofruara dhe pjesëmarrjen e magjistratëve dhe anëtarëve të institucioneve në trajnimet që trajtojnë tematika lidhur me ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme. Këto trajnime janë thelbësore për forcimin e kapaciteteve dhe njohurive të personelit gjyqësor dhe të institucioneve për të identifikuar dhe menaxhuar rastet e ndërhyrjeve, duke përmirësuar kështu integritetin dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor.

Në vitin 2024 janë organizuar disa trajnime për magjistratët mbi temat e etikës, paragjytimeve, korrupsionit dhe integritetit. Në total, kanë marrë pjesë 274 persona në trajnimet e mëposhtme:

- Etika dhe Integriteti Gjyqësor (3 ditë, 31 janar – 2 shkurt) – 31 pjesëmarrës.
- Paragjykimet dhe njëanshmëria e pavetëdijshme në gjykim (1 ditë, 15 shkurt) – 5 pjesëmarrës.
- Presumimi i pafajësisë (1 ditë, 29 mars) – 21 pjesëmarrës.
- Veprat penale të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të lartë (1 ditë, 4 prill) – 8 pjesëmarrës.
- Korrupsioni aktiv i funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve vendorë (1 ditë, 5 prill) – 23 pjesëmarrës.
- Korrupsioni aktiv në sistemin e drejtësisë dhe juridik ndërkombëtar (1 ditë, 25 prill) – 16 pjesëmarrës.
- Paragjykimi dhe njëanshmëria (3 ditë) – 49 pjesëmarrës.
- Integriteti (3 ditë) – 65 pjesëmarrës.
- Paanshmëria (3 ditë) – 56 pjesëmarrës.

Trajnimet kanë trajtuar temat e etikës, paragjytimeve dhe ndikimit të tyre në vendimmarrjen gjyqësore, korrupsionin aktiv në sistemin e drejtësisë dhe rëndësinë e integritetit dhe paanshmërisë së magjistratëve.

Numri i trajnimeve dhe pjesëmarrësve (magjistratë dhe anëtarë të institucioneve) mbi tematika lidhur me rastet e ndërhyrjeve të brendshme dhe të jashtme



Objektivi Specifik 2.4.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.4 parashikon parashikon 3 masa, prej të cilave **1 masë është zbatuar plotësisht** dhe **2 masa janë zbatuar pjesërisht**. 33.3% e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik: 2.4. Kontrollët e figurës dhe pasurisë në sistemin e drejtësisë kryhen në përputhje me standardet e vetting-ut.

2.4.1	<i>ILDKPKI-ja siguron përditësime të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të deklaratave të pasurisë së anëtarëve të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë dhe heton dhe raporton çështjet, sipas rastit, në prokurori, bazuar në praktikën e vendosur nga standardet e larta të procesit të vetting-ut. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: ILDKPKI</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> ILDKPKI ka përmbyshur rregullisht detyrimin për të garantuar administrimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë të subjekteve deklaruese të sitemit gjyqësor dhe të prokurorisë në formë elektronike nëpërmjet sitemit elektronik të deklarimit EACIDS, si dhe në format shkresor, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Gjatë vitit 2024 ILDKPKI ka kryer kontrollin e plotë të 53 subjekteve magjistratë në sistemin gjyqësor, dhe magjistratë në organet e prokurorisë. Gjatë vitit 2024, në kuadër të verifikimeve të kryera, ILDKPKI ka referuar 5 raste pranë organeve ligj zbatuese lidhur me çështjet kur konstatohen element të veprës penale në përputhje me nenin 31 të Ligjit të ILDKPKI. Rastet e referimeve janë referuar përkatësisht pranë SPAK, Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Agjencisë së Inteligjencës Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve. Në lidhje me rastet e referuara, raportohet se kurdoherë në materialin referues, u parashtrohet organeve përkatësisht edhe kërkesa për përcjelljen e një informacioni mbi konkluzionin e arritur në bazë të veprimeve të kryera në funksion të referimit. Për shkak të procedurave hetimore penale apo administrative, kompleksitetit të çështjeve të referuara, dhe faktit se referimet janë kryer gjatë vitit 2024 dhe afatit të shkurtër nga momenti i referimit, institucionet kompetente mund të mos kenë përfunduar
-------	---

	ende kryerjen e veprimeve të nevojshme në lidhje me to, e për rrjedhojë nuk kemi ende informacion mbi vijueshmërinë e referimeve të kryera gjatë vitit 2024.
2.4.2	<i>KL Gj-jja dhe KLP-jja sigurojnë ndjekjen sistematike të raporteve të deklarimit të pasurisë nga ILDKPKI-jja dhe hetime të mëtejshme në kontekstin e shqyrtimit të pasurisë dhe të figurës së tyre, duke përfshirë sigurimin e hetimeve efikase në vijim dhe referimin në prokurori. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KL Gj, KLP <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> KL Gj raporton se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mban në konsideratë raportet e ILDKPKI-së në çdo rast emërimi apo ngritje në detyrë të gjyqtarëve. Gjatë vitit raportues, KL Gj ka emëruar edhe një Këshilltar Ekonomik i cili mbështet komisionet e përhershme. Ai harton relacione, raporte shpjeguese si dhe përpilon statistika mbi çështje që ka në kompetencë anëtarë i një komisioni për ta asistuar në përmbushjen e detyrës. Pranë KLP funksionon Njësia e Mbështetjes së Komisionieve e përbërë nga Këshilltarë ligjorë jo magjistratë dhe këshilltarë ligjorë magjistratë të komanduar (prokurorë të cilët veprojnë si një njësi e specializuar, e cila merret me hetimin e deklarimit të pasurisë dhe analizimin e figurës së magjistratëve). Për vitin 2024, nuk është parë e nevojshme që të krijohet një njësi tjetër, përse kohë kjo njësi mbulon detyrat dhe përgjegjësitë ligjore të KLP.
2.4.3	<i>Deklaratat e pasurisë së anëtarëve të institucioneve të pavarura të drejtësisë përditësohen dhe verifikohen në mënyrë periodike. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> ILDKPKI <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> ILDKPKI ka përmbushur rregullisht detyrimin për të garantuar administrimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë të subjekteve deklaruese të anëtarëve të institucioneve të pavarura të drejtësisë në formë elektronike nëpërmjet sitemit elektronik të deklarimit EACIDS, si dhe në format shkresor, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Duke qenë se ky proces është një proces me një ecure të vazhdueshme periodike, ILDKPKI do të vijojë të përmbushë këtë qëllim duke garantuar funksionalitetin e sitemit elektronik të deklarimit EACIDS dhe administrimin e deklaratave të subjekteve deklaruese edhe në format shkresor. Gjatë vitit 2024 ILDKPKI ka kryer kontrollin e plotë të 5 subjekteve anëtarë të institucioneve të pavarura të drejtësisë. Skema e kontrollit të plotë është e parashikuar në ligj dhe konkretisht në nenin 25/1 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ku përcaktohet skema dhe periodiciteti i ushtrimit të kontrollit të plotë në varësi të subjekteve deklaruese. Gjithashtu, me kërkesë të institucioneve të sitemit të drejtësisë, ILDKPKI ka kryer kontrollin e plotë për shkak të nevojave të organeve të emërtesës në kuadër të përmbushjes së kompetencave të tyre ligjore lidhur me vlerësimin e magjistratëve apo ecurinë e tyre në karrierë. Lidhur me këtë masë, ILDKPKI gjatë vitit 2024 ka marrë pjesë në programin e organizuar nga Ambasada Amerikane dhe USAID me temë "Promovimi i Transparencës dhe Llogaridhënies në Institucionet Shtetërore". Për vitin 2025 ILDKPKI ka parashikuar marrjen e masave në funksion të rritjes së kapaciteteve të stafit në lidhje me kryerjen e kontrolleve të plota dhe hetimeve administrative të

deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë. Sqarojmë se në programin trajnues të raportuar kanë marrë pjesë 2 punonjës së ILDKPKI, për shkak të numrit të kufizuar, të përcaktuar nga vetë donatorët e programit.

Për OS 2.4 është përcaktuar një tregues performance:


- ***Numri i masave administrative ndaj subjekteve të organeve gjyqësore, si rezultat i kontrolleve të plota të kryera ndaj tyre.***

Qëllimi i këtij treguesi është të vlerësojë nivelin e masave administrative të ndermarra ndaj subjekteve të organeve të gjyqësorit pas kryerjes së kontrolleve të plota periodike nga ILDKPKI. Ai mat numrin e masave administrative të marra ndaj subjekteve të organeve gjyqësore, si gjyqtarët dhe stafi i administratës gjyqësore, që rezultojnë nga kontrollet e plota të kryera nga ILDKPKI për të siguruar që subjektet e ketyre organeve respektojnë standardet dhe procedurat e përcaktuara. Treguesi ndihmon në monitorimin e efikasitetit të mekanizmave të kontrollit dhe të masave kundër shkeljeve në lidhje me deklarin e pasurisë për subjektet që i nënshtrohen këtij detyrimi.

Gjatë vitit 2024 ILDKPKI ka kryer 58 kontrolle të plota për subjektet e organeve gjyqësore në përputhje me skemën e kontrollit, dhe si rezultat i kontrolleve të ushtruara janë marrë 5 masa administrative të shënuara si vlerë për treguesin. Masat administrative të marra dhe të raportuara në pasaportën e treguesve janë masa administrative (gjobë) të marra në përfundim të kryerjes së kontrolleve të plota, në përputhje me parashikimet e nenit 40 të ligjit 9049/2003, i ndryshuar, apo nenit 44 të ligjit 9367/2005 i ndryshuar.

Kjo vlerë përfaqëson nr. e masave administrative të marra nga ILDKPKI gjatë vitit 2024 ndaj subjekteve deklaruese për këtë periudhë ku përfshihen si subjekte (magjistratët në sistemin gjyqësor, magjistratët në organet e prokurorisë, si dhe anëtarët e institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Gjithashtu në kuptim të subjekteve të përcaktuar në nenin 3/1 të ligjit nr. 9049/2003, ILDKPKI ka kryer



gjithashtu edhe kontrollin e plotë të 44 subjekteve kandidatë për ngritje në detyrë apo për kandidim në institucionet e ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe ia ka përcjellë këto raporte organeve të emërtesës.

Objektivi Specifik 2.5.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.5 parashikon 5 masa, prej të cilave **1 masë është zbatuar plotësisht**, **1 masë është zbatuar pjesërisht**, **1 masë nuk është zbatuar** dhe 2 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 33.3% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 2.5: Përforsimi i mekanizmave të llogaridhënies së magistratëve.	
2.5.1	<i>Hartimi i rregullave për përbërjen dhe vjetërsinë e ILD-së, të cilat vendosin garanci të kënaqshme të paanshmërisë, pavarësisë dhe profesionalizmit për mbrojtjen e institucionit nga ndikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i legjislativit dhe ekzekutivit. (pz.2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KUVENDI, ILD, MD <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
2.5.2	<i>Plotësimi gradual i vakancave në rradhët e inspektorëve në ILD, duke synuar që ky pozicion të bëhet i pëlqyeshëm dhe rritja e kapaciteteve të stafit mbështetës të ILD-së për t'ju përgjigjur nevojave objektive të institucionit. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, ILD, KLGJ, KLP, SHM <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> ILD ka hartuar kërkesat për komandim të magistratëve në maj të vitit 2024 dhe nga të dy Këshillat janë shpallur procedurat për komandimin e magistratëve. Nga ana e KLGJ, në përfundim të procedurës së shpalljes është përcjellë për vlerësim të ILD-së 1 kandidaturë, e cila deri dhjetor të vitit 2024 është në proces vlerësimi. Në lidhje me rekrutimin e inspektorëve jomagjistratë, është njoftuar shpallja e 4 vakancave në ILD. gjatë procedurës kanë shfaqur interes 19 kandidatë, për të cilët gjatë periudhës së raportimit, janë duke u zhvilluar procedurat e verifikimit të plotësisht të kriterëve dhe kushteve ligjore për plotësimin e vendit vakant, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 209 të ligjit nr. 115/2016 " Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar si dhe kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në KM nr. 536, 25.07.2019 "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisht të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit".

- Në lidhje me plotësimin e stafit mbështetës, për periudhën e raportimit
Niveli i Mesëm Drejtues

Ndihmës Inspektor, liruar me dorëheqje 4 nëpunës, si dhe plotësuar pozicionet nëpërmejt proceduarve të rekrutimit në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil për 4 pozicione, po ashtu ka një vend vakant i cili është shpallur dhe ka përfunduar pa fitues)

Drejtor i Drejtor Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, shpallur pozicioni por ka rezultuar pa kandidatë, aktualisht është në proces.

- Niveli i Ulët Drejtues

Përgjegjës i Sektorit të Statistikave, Drejtoria e Analizës dhe Standardeve plotësuar nëpërmejt procedurave të rekrutimit në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil

- Nivel Ekzekutiv

5 pozicione plotësuar nëpërmejt procedurave të lëvizjes paralele dhe pranim në shërbim civil, nga të cilat 3 pozicione kanë qenë vakant dhe 2 pozicione janë krijuar vakant për shkak të dorëheqjeve të nëpunësve.

Aktualisht në institucion, janë vakante pozicionet sipas strukturës si më poshtë:

Kabineti 0

Inspektor Magjistratë 6

Inspektor jomagjistratë 5

Ndihmës Inspektor 1

Drejtor drejtorie 1

Përgjegjës Sektori 0

Specialist 3

	Në lidhje plotësimin e vakancave në rradhët e inspektorëve në ILD: 1. numri komandimeve të magjistratëve rradhët e gjyqësorit dhe prokurorisë, nuk ka ndryshime; 2. për inspektorët jomagjistratë janë hapur procedurat e rekrutimit dhe aktualisht vijon procesi i përzgjedhjes së kandidatëve. Tajnimet e zhvilluara janë: • EU4Justice: Identifikimi dhe adresimi i çështjeve të konfliktit të interesit në kuadrin e hetimit disiplinor; Zhvillimi dhe zbatimin e një Sistemi të Menaxhimit të Cilësisë për ILD; • Përmirësimi i efikasitetit të ILD nëpërmjet një Njësie të specializuar të trajtimit të ankesave; • Kryerja e një analize gjithëpërfshirëse të terrenit teknologjik aktual të ILD; • Sesioni I – Përgjegjësia disiplinore e magjistratëve: garancitë procedurale dhe themelore në kuadër të GJEDNJ; • Sesioni II – Liria e të shprehurit të magjistratëve dhe kufizimi i saj: raste nga praktika e GJEDNJ; • Seminar i përbashkët CEPEJ&EE4JUSTICE "Për përgatitjen, kryerjen dhe analizimin e inspektimeve klasike tematike, me fokus shërbimet e prokurorisë. • Rritja e efikasitetit të ILD-së në Inspektimin Tematik dhe Institucional. Shkolla e Magjistraturës: • Integriteti Gjyqësor dhe Sfidat në lidhje me çështjet e etikës së magjistratëve; • Integriteti • Paanshmëria • Vlerësimi etiko profesional i magjistratëve • Paragjykim dhe Njëanshmëria • Inteligjenca Emocionale dhe Stresi • Komunikimi Institucional i magjistratit • Paanësia e Gjyqtarit HELP organization: • Ethics for Judges, Prosecutors and Laëyers (9 hours); • ANTICOR SQI SL_HELP Statement of Accomplishment Introduction to Corruption Prevention; • Combating Hate Speech. • Human Rights Education for legal professionals • Hate Crime Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike • Legjislacioni në fushën e sigurisë kibernetike Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar dhe dy vizita studimore në Francë dhe Spanjë.
2.5.3	<i>KLP-ja dhe KLGJ-ja akordojnë burime konsistente dhe të përshtatshme në lidhje me hetimet disiplinore të iniciuara nga ILD-ja në kohë dhe në mënyrë sistematike. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, KLP</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
2.5.4	<i>Përcaktimi i rregullave të monitorimit periodik të telekomunikacionit të personelit të Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për një sistem funksional në përputhje me parimet e proporcionalitetit, qartësisë dhe parashikueshmërisë. Sistemi është zbatuar në përputhje me standardet evropiane. (pz. 2024-2030)</i>

	<u>Institucioni raportues:</u> Kuvendi, SPAK, Gjykatat e Posaçme <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> SPAK- Ligji nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të ndryshuar, në nenin 6, ka të parashikuar që çdo punonjës duhet të plotësojë kushtet e sigurisë përpara se të caktohet apo punësohet në SPAK. Për shkak të terminologjisë të ndryshme mes dispozitave ligjore, në të cilën është parashikuar termi “përgjim” dhe formularit “Deklarata për kontrollin e figures” në të cilën është parashikuar termi “vëzhgim”, ka krijuar ngërç në mos zbatimin e kësaj dispozite, për të cilën nga ana e BKH-së i është Kuvendit zgjidhje ligjore, për të cilën akoma nuk ka përgjigje. Për këtë arsye, aktualisht komisioni nuk është në funksion. Prokuroria e Posaçme ka të miratuar Manualin e gjurmëve standarte të auditimit, sipas sektorëve, si dhe regjistrat e rriskut, të cilat përditësohen në përputhje me ndryshimet e akteve ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu çdo vit institucioni kryen analizën vjetore mbi zbatueshmërinë dhe monitorimin e të gjithë proceseve të punës. Ministria e Financave kryen auditim periodik në përputhje me pyetësin e vetëvlerësimit të institucionit.
2.5.5	<i>Zbatimi dhe ndjekja e mëtejshme e dokumenteve strategjike të KLGJ-së për hetimin administrativ të sinjalizuesve dhe shqyrtimin e rasteve të korrupsionit brenda KLGJ-së. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KLGJ <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Kjo masë nuk ka zhvillime të mëtejshme.

Për OS 2.5 janë përcaktuar dy tregues performance:

- ***Përqindja e inspektimeve të përfunduara sipas planit vjetor të inspektimeve pranë gjykatave dhe prokurorive***

Qëllimi i këtij treguesi është të vlerësojë sa mirë është zbatuar plani vjetor i inspektimeve nga ILD në gjykata dhe prokurori. Ky tregues mat numrin e inspektimeve që janë përfunduar sipas planit të miratuar për një vit të caktuar. Të dhënat ndihmojnë në monitorimin e përmbushjes së angazhimeve të inspektimit dhe në vlerësimin e efikasitetit të mbikëqyrjes dhe kontrolleve në sistemin e drejtësisë.


ILD raporton se për vitin 2024 në analizim dhe vlerësim të rritjes së efikasitetit të gjyqësorit është miratuar plani i inspektimeve, pjesë e të cilit kanë qenë 6 tematika.

Nga këto 6 inspektime të miratuara për 2024 është realizuar një dhe janë në proces në faza të ndryshme procedurale 5 të tjerë.

Gjithashtu gjatë 2024 janë përfunduar edhe 3 inspektime të tjera të cilat kanë qenë në planin e inspektimeve të vitit 2023.

**% e Përqindja e inspektimeve të përfunduara sipas planit
vjetor të inspektimeve pranë gjykatave dhe prokurorive**

■ Inspektime të përfunduara ■ Inspektime në proces




➤ **Përqindja e vendimeve të KLGJ dhe KLP që pranojnë kërkesën e ILD për masë disiplinore**

Qëllimi i treguesit është të vlerësojë masën në të cilën kërkesat e ILD për aplikimin e një masë disiplinore KLGJ dhe KLP ranohen nga këta të fundit. Nga një anë treguesi mat efektivitetin e punës së ILD, institucion i cili duhet të përcjellë pranë Këshillave kërkesa për masa disiplinore të mirë argumentuara. Nga ana tjetër vlerësohet se sa Këshillat si organe të vetëqeverisjes, respektivisht të gjyqësorit dhe sistemit të prokurorisë, veprojnë me panshmëri në prani të kërkesave për aplikim të një mase disiplinore lidhur me shkelje disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Gjatë vitit 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 11 magjistratë, për 6 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për 5 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. (Për 3 magjistratë prokurorë dhe për 3 magjistratë gjyqtarë, hetimi ka filluar në vitin 2023).



Nga ana e Këshillave për 11 kërkesa për procedim disiplinor, 3 janë pranuar me vendim përfundimtar të Këshillave, njëra prej të cilave me ndryshim mase.



3.2.3 Qëllimi i Tretë i Politikës

Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë

Qëllimi i Tretë i Politikës: 50 masa



Objektivi Specifik 3.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.1 parashikon parashikon 8 masa, prej të cilave **2 masa janë zbatuar plotësisht**, 4 masa janë zbatuar pjesërisht, **1 masë nuk është zbatuar** dhe 1 masë rezulton e pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 33.3% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 3.1: Përmirësimi i kapacitetit të KLGJ dhe gjykatave, përfshirë GJL, për zbatimin e masave që rrisin efikasitetin

Implementimi i Hartes së re Gjyqësore nga KLGJ dhe gjykatat. (pz. 2024-2030)

Institucioni raportues: KLGJ

Informacion mbi zbatimin e masës:

3.1.1

Gjatë fazës së implementimit të hartës së re gjyqësore, janë konstatuar mangësi në infrastrukturë. Pas miratimit të buxhetit të shtetit për vitin 2025, KLGJ ka detajuar fonde për marrjen me qira të një godine për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe do të programojë çdo vit fonde për qira deri në ndërtimin e godinës së re.

Nga ana tjetër, burime financiare janë alokuar për disa përmirësime në infrastrukturën ekzistuese për gjykatat e e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Kukës, Vlorë, Dibër, Korçë dhe Elbasan.

	Në zbatim të akteve të miratuara nga KLGJ, pas përfundimit të implementimit të hartës gjyqësore, Këshillat e Gjykatave kanë miratuar përshkrimet e punës për pozicionet e miratuara në strukturën organizative. Gjithashtu gjatë vitit 2024 referuar rezulton se deri në 13 qershor 2024 janë trajnuar 65 nëpunës civilë gjyqësorë sipas nevojave përkatëse për trajnim. në bazë të informacioni që pritet të përcillet nga gjykatat, KLGJ do përditësoj në vijim informacionin për gjithë vitin 2024. Me vendimin nr. 224, datë 25.04.2024 është miratuar Rregullorja për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë. Me vendimin nr. 44, datë 05.02.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është parashikuar ngritja e Sektorit të Trajnimeve për Magjistratët dhe Administratën, përmes së cilët do të bëhet i mundur zhvillimi i trajnimeve për nëpunësit civilë gjyqësorë. Gjatë vitit 2024, janë trajnuar gjithsej: -117 nëpunës civilë gjyqësor nga KLGJ, Shkolla e Magjistraturës dhe aktorë të tjerë; -23 janë trajnuar nga partnerët ndërkombëtarë; -63 janë trajnuar nga ASPA. KLJGJ do të bëjë analizën vjetore të zbatimit të akteve nënligjore të hartës së re gjyqësore në Raportin vjetor të KLGJ të vitit 2024.
3.1.2	<i>KLJGJ-ja/këshillat e gjykatave harton/jne dhe miraton/jne një strategji efikasiteti/reduktimi të çështjeve të prapambetura/shpërndarje të barabartë të ngarkesës për gjykatat në të gjitha nivelet. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> <i>Gjykatat e Posaçme, KLGJ</i> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> KLJGJ me vendimin nr. 251, datë 09.05.2024, ka miratuar Strategjinë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (2024-2027), e cila përmban masa konkrete ligjore dhe administrative që synojnë zgjidhjen e problematikave që shkaktojnë numrin e madh të çështjeve të prapambetura dhe pakësimin e tyre në tri vitet e ardhshme.
3.1.3	<i>Garantimi i burimeve njerëzore dhe buxhetit të duhur për të siguruar zbatimin praktik të strategjisë së efikasitetit/reduktimit të çështjeve të prapambetura/shpërndarjen e ngarkesës së punës në gjykata. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> <i>KLJGJ</i> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u>

	Në muajin Maj 2024, Këshilli ka publikuar një “Thirrje për aplikim” për stafin që do të rekrutohet në gjykatë për të ndihmuar në procesin e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura, proces ky që do të realizohet me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë. Një nga rezultatet e pritshme të kësaj nisme është ulja e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit duke rekrutuar 11 nëpunës të rinj për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, konkretisht 1 pranë Gjykatës së Lartë, 5 pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 5 pranë Gjykatës së Administrative të Apelit. Në kuadër të përmirësimit dhe rritjes së burimeve njerëzore dhe buxhetit të nevojshëm për zbatimin e strategjisë së reduktimit të çështjeve të prapambetura me vendimin nr.585, datë 09.10.2024 "Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë" KLGJ ka propozuar rritjen e numrit të gjyqtarëve nga 408 në 417 gjithsej. Referuar ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, rezulton se nuk janë miratuar pozicione shtesë për sistemin gjyqësor.
3.1.4	<i>KL Gj-ja përparon me emërimet e gjyqtarëve. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> KL Gj gjatë vitit 2024 ka emëruar dhe caktuar në pozicion 32 gjyqtarë të rinj. KL Gj publikon numrin e kuotave për gjyqtarë çdo vit në muajin janar në bazë të një analize të nevojave të gjykatave, duke plotësuar fillimisht vakancat përmes procedurave të lëvizjes paralele dhe me tej miraton numrin e kuotave. Procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës ndërvaret nga disa institucione të tjera ligjzbatuese, si ILDKPKI, Drejtoria e Tatimeve, etj, me të cilat KL Gj është në komunikim të vazhdueshëm për mbarëvajtjen e këtij procesi. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës asistohet në këto procedura nga Këshilltari Ekonomik.
3.1.5	<i>KL Gj zgjeron më tej procedurat e vlerësimit dhe avancimit në karrierë të gjyqtarëve bazuar në kriteret cilësore dhe sasiore. (pz. 2025-2026)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Në kuadër të publikimit të rregullt dhe në kohë të vendimeve të Këshillit mbi procedurat e vlerësimit të performancës dhe avancimit në karrierë të gjyqtarëve, KL Gj bën publikimin e menjëhershëm të çdo shpallje procedure për ngritje në detyrë në faqen zyrtare të internetit si dhe vendimarrjet mbi ngritjet në detyrë dhe vlerësimet etike e profesionale të gjyqtarëve.
3.1.6	<i>Sigurohet zbatimi në kohë dhe efikas i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD, KLGJ, PP, DPB, DSHP, DPP, ASH, SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u>

	Nga DPP është evidentuar nevoja për plotësim të 7 vendeve vakante për përmbarues gjyqësor. Është mundësuar ndjekja e procedurës dhe plotësimi i 6 vendeve vakante nga 7 të publikuara për përmbarues gjyqësor shtesë. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve është miratuar urdhri nr. 333, datë 18.06.2024 "Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbaruesit gjyqësor, shtetëror". Me miratimin e urdhrave për programin e trajnimit, do të procedohet në vijim rishikimi dhe përditesimi lidhur me procedurat e ekzekutimit. Për sa i përket organizimit të trajnimeve me qëllim ngritjen e një mekanizmi efikas për vlerësimin e pranueshmërisë dhe arsyetimin e ankesave për të shmangur praktiken e ankimit automatik në Avokaturen e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ka ofruar trajnim për avokatët e shtetit, bazuar në nevojën për trajnim që ata kanë paraqitur në Shkollë. Megjithatë nuk ka pasur një trajnim të posaçëm për këtë temë. Megjithatë Shkolla ka trajtuar rolin e avokatit të shtetit në disa lloje çështjesh. Shkolla do të marrë masat për organizimin e këtij trajnimi në vitin e ardhshëm akademik. Masa konsiderohet e përcaktuar për vitin 2024 duke parë mungesën e fokusit në rritjen e kapaciteteve me anë të trajnimeve nga ana e DPP dhe mungesën e një marrëveshjeje mes DPB dhe PP për aksesin në Regjistrin e Gjendjes Gjyqësore.
3.1.7	<i>Zbatimi i qëndrueshëm dhe në kohë i vendimeve të GJEDNJ-së, përfshirë vendimet në fushën e pronësisë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: ASH</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Avokatura e Shtetit ka nisur punën për publikimin e të gjitha vendimeve, duke u fokusuar në përmirësimin e elementeve të kërkueshmërisë sipas udhëzimeve të Strategjisë. Në vazhdim, synohet krijimi i një databaze të veçantë që do të konsolidojë të dhënat dhe do të ofrojë një pamje të qartë për progresin e vendimeve të publikuara, duke siguruar transparencë dhe qartësi për përdoruesit dhe palët e interesuara.
3.1.8	<i>KLGG-ja siguron mbledhjen dhe raportimin e të dhënave përkatëse për krimet e urrejtjes duke reflektuar rekomandimet e ODIHR. (pz. 2026-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGG</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.

Për OS 3.1 janë përcaktuar katër tregues performance:

➤ ***Raporti i dosjeve të ekzekutuara me dosjet e regjistruara (%)***


Treguesi synon të masë numrin e titujve ekzekutiv të ekzekutuar nga Zyrtat Përmbarimore Vendore/ Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit në raport me numrin total të çështjeve të regjistruara për ekzekutim, të shprehur në përqindje. Rritja e vlerës së raportit gjatë kohëzgjatjes së SND III është tregues i rritjes së efikasitetit të ekzekutimeve të vendimeve

gjyqësore.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit raporton se për vitin 2024 në total, numri i dosjeve përmbarimore të regjistruara është 55,201. Nga këto:

- Dosje në ekzekutim: 44,527
- Dosje të ekzekutuara: 7,012
- Dosje të pushuara sipas nenit 616/d: 1,611
- Dosje të refuzuara: 100
- Dosje të pezulluara me vendim gjyqësor: 279
- Dosje të transferuara: 1,131
- Dosje të pushuara sipas nenit 616/c: 541


Në total numri i dosjeve të ekzekutuara (përfshirë pushuar, pezulluar, refuzuar dhe transferuar) është 10,674 dosje dhe mbeten në ekzekutim 44,527 dosje.



- ***Përqindja e zvogëlimit të DT (Disposition Time) për gjykatat sipas shkallëve dhe llojit të çështjeve (civile, penale, administrative)***

Treguesi ka për qëllim të masë përqindjen e zvogëlimit të kohës virtuale së zgjidhjes së çështjeve (DT) në gjykatat e shkallëve të ndryshme (shkalla e parë, apeli, Gjykata e Lartë), në krahasim me vitin parardhës, duke vlerësuar eficiencën e sistemit gjyqësor dhe ofrimin e drejtësisë pa vonesa. Llogaritja e treguesit DT dhe më pas krahasimi i tij me vitin parardhës shfaq trendin e ecurisë së gjykatave lidhur me respektimin e afatit të arsyeshëm. Gjithashtu, llogaritja e treguesit (virtual) Disposition Time është i rëndësishëm pasi mund të krahasohet me afatin e arsyeshëm ligjor, parashikuar në nenin 399/2 të Kodit të Procedurës Penale, që është një detyrim për t'u respektuar nga gjykatat.

Gj.Sh.P.J.P. Berat -154, Gj.Sh.P.J.P. Dibër-107, Gj.Sh.P.J.P. Durrës- 203, Gj.Sh.P.J.P. Elbasan -321, Gj.Sh.P.J.P. Fier -107, Gj.Sh.P.J.P. Gjirokastrë -196, Gj.Sh.P.J.P. Korçë -159, Gj.Sh.P.J.P. Kukës -121, Gj.Sh.P.J.P. Lezhë 113, Gj.Sh.P.J.P. Sarandë -135, Gj.Sh.P.J.P. Shkodër -121, Gj.Sh.P.J.P. Tiranë -192, Gj.Sh.P.J.P. Vlorë -157, Gj. Pos. Shk.1 K.K.O – 18, Gj. Admin. Shk. Parë Lushnje – 247, Gj. Admin. Shk. Parë Tiranë -199, Gj. Apelit Juridiksionit Përgjithshëm – 1546, Gj. Pos. e Apelit K.K.O -15, Gj. Admin. E Apelit Tiranë -3276, Gj. e Lartë -998.



➤ **Plotësimi i vakancave në gjykata**


Qëllimi i këtij treguesi është të monitorojë dhe vlerësojë nivelin e plotësimit të vakancave në sistemin gjyqësor për të siguruar që kapacitetet e nevojshme të jenë në dispozicion për të mbështetur funksionimin efektiv të gjykatave. Ky tregues fokusohet në përpjekjet për të arritur nivelin e caktuar të plotësimit të vakancave për gjyqtarët dhe stafin jo-magjistrat në përputhje me objektivat e parashikuara deri në vitin 2027.

KLJGJ raporton për vitin 2024 se:

Në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, më 31 dhjetor 2024, janë në detyrë 173 gjyqtarë nga 235 të parashikuar në strukturën organizative, duke përfaqësuar 73.6% të kapacitetit.

Në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, më 31 dhjetor 2024, janë aktivë 28 gjyqtarë nga 78 të planifikuar, që korrespondon me një përqindje prej 35.8%.

Për stafin jo-magjistrat (administratën) në të gjitha shkallët e gjykatave, janë plotësuar vetëm 50 pozicione nga 173 të parashikuara në strukturën organizative, duke arritur një përqindje prej 28.9%.



➤ ***Përqindja e reduktimit të çështjeve të mbartura (sipas shkallëve të gjykatave)***

Qëllimi i këtij treguesi është të monitorojë përmirësimin në trajtimin e çështjeve të mbartura në sistemin gjyqësor dhe të vlerësojë sa efektivisht gjykatat arrijnë të reduktojnë numrin e çështjeve të mbartura gjatë një periudhe të caktuar. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e efikasitetit të proceseve gjyqësore dhe në identifikimin e progresit të arritur në zgjidhjen e çështjeve që kanë pritur për një periudhë të gjatë. Çështje të mbartura konsiderohen çështjet që janë akoma në pritje të gjykimit në momentin e përcaktuar të matjes, pavarësisht nëse ka përfunduar apo jo afati ligjor (nëse ka) për zgjidhjen e çështjes.

Sipas të dhënave paraprake për vitin 2024, përqindja e reduktimit të çështjeve të mbartura është 1.9%. Referuar vendimit nr. 47, datë 11.02.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjykatat raportojnë të dhënat e tyre mbi këtë tregues brenda muajit mars të vitit pasardhës. Për këtë arsye, aktualisht, procesi i grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave është ende në vijim, dhe nuk është i disponueshëm informacioni i plotë mbi reduktimin e çështjeve të mbartura për vitin 2024.

Objektivi Specifik 3.2.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.2 parashikon parashikon 8 masa, prej të cilave **2 masa janë zbatuar plotësisht** dhe **6 masa janë zbatuar pjesërisht**. 33.3% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 3.2 Përmirësimi i kapacitetit të PP, KLP dhe zyrave të prokurorisë, për zbatimin e masave që rrisin efikasitetin.	
3.2.1	Implementimi i Hartës së re Gjyqësore nga PP dhe prokuroritë. (pz.2024-2030) Institucioni raportues: PP Informacion mbi zbatimin e masës: PP raporton se në funksion të ruajtjes së nivelit të efektivitetit në veprimtarinë administrative e funksionale të prokurorisë, garantimin e paanshmërisë, shpërndarjen e ekuilibruar të volumit të punës, dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit, me urdhrat: - nr. 18, datë 30.01.2024, “Për caktimin e strukturës faktike në Prokurorinë e Përgjithshme”, - nr. 19, datë 30.01.2024, “Për caktimin e strukturave të prokurorisë pranë gjykatave së shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, - nr. 32, datë 13.03.2024, “Për shtimin e një pozicioni pune Kancelar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”, - nr. 61, datë 13.06.2024, “Për shtimin e 2 prokurorëve në organikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, të Prokurorit të Përgjithshëm, Janë caktuar strukturat organike të prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Për vitin 2024 nuk janë emëruar OPGj në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm. Urdhrat e mëposhtëm janë dhe në kuadër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore. Prokuroria si institucion i pavarur ligjzbatues nuk ka iniciativë ligjvënëse. Aktet nënligjore që nxjerr Prokurori i Përgjithshëm për mbarevajtjen e punës janë të parashikuara në ligjin 97/2016, konkretisht në nenin 38. Për vitin 2024, veçohen Udhëzimet e përgjithshme të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm në funksion të rritjes së efektivitetit, si vijnë: “Për përdorimin e platformës elektronike për raportimin e të dhënave për korrupsionin dhe krimin e organizuar” nr. 03, datë 25.04.2024; “Për zbatimin e ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”, nr. 4, datë 24.04.2024; “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”, nr. 05, datë 12.05.2023; “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër trafikimit të personave”, nr. 06, datë 3.07.2024; “Për masat e sigurimit”, nr. 07, datë 23.07.2024. “Efektiviteti i shërbimit të gatishmërisë”, nr. 08, datë 23.07.2024.
3.2.2	KLP dhe PP hartojnë dhe miratojnë një strategji efikasiteti, shpërndarje të barabartë të ngarkesës për prokuroritë në të gjitha nivelet. (pz. 2024-2030)

	<u>Institucioni raportues: KLP, PP</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Çdo vit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë publikon vendet vakante në sistemin e prokurorisë, duke mbajtur parasysh organikën e miratuar, vakancat e përhershme, vakancat e përkohshme dhe gjendjen faktike. Mbi bazën e këtij publikimi, Këshilli vlerëson mënyrën dhe procedurat që duhet të ndjekë për plotësimin e vakancave në vijimësi (lëvizje paralele, ngritje në detyrë), duke patur parasysh edhe numrin e të diplomuarve që do të ketë për vitin përkatës. Po kështu, çdo fillim viti, Këshilli përcakton edhe numrin maksimal të studentëve që mund të pranohen në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, sikurse përcaktuar në masën 4.1.3 Këto dy analiza, bëjnë të mundur që Këshilli të ndjekë në vijimësi plotësimin e vakancave të prokurorëve në sistem.
3.2.3	<i>Garantimi i burimeve njerëzore dhe buxhetit të duhur për të siguruar zbatimin praktik të strategjisë së efikasitetit/shpërndarjen së ngarkesës së punës në prokurori. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: PP</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Buxheti i realizuar për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm është 3,544,096 mije lekë kundrejt planit 3,593,127 mije lekë ose 99% e buxhetit të rishikuar. Kërkesa shtesë mbi tavanin e miratuar rrjedh nga nevoja për të kryer likuidimet lidhur me pagën e re të magjistratit në zbatim të Ligjit nr.33 ,datë 25.05.2023’Për një ndryshim në ligjin 96/2016 ”Për statusin e gjyqëtareve dhe prokurorëve në R.Sh’të ndryshuar, dhe Vendimit të KM nr.325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve,prefektit,nënprefektit,nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” si dhe efektet financiare qe rrjedhin nga zbatimi i Vendimit nr.35/2023 të Gjykatës Kushtetuese ”Për përlllogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit/prokuror’, paga të prapambetura, duke filluar nga data 1 Janar 2019 deri në datën 01 Prill 2023. Kërkesa shtesë ka ardhur edhe për efektet financiare që rrjedhin nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për pagat e prapambetura. PP në funksion të ruajtjes së nivelit të efektivitetit në veprimtarinë administrative e funksionale të prokurorive, garantimin e paanshmërisë, shpërndarjen e ekuilibruar të volumit të punës, dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit, me urdhrat: • nr. 18, datë 30.01.2024, “Për caktimin e strukturës faktike në Prokurorinë e Përgjithshme”, • nr. 19, datë 30.01.2024, “Për caktimin e strukturave të prokurorive pranë gjykatave së shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, • nr. 32, datë 13.03.2024, “Për shtimin e një pozicioni pune Kancelar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”, • nr. 61, datë 13.06.2024, “Për shtimin e 2 prokurorëve në organikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, të Prokurorit të Përgjithshëm, Janë caktuar strukturat organike të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Për vitin 2024 nuk janë emëruar OPGj në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm. Gjithshtu në datë 27.07.2024 KLP në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, referuar nevojave të numrit faktik të prokurorëve të sistemit të prokurorisë ka bërë shpërndarjen e 23 magjistratëve të sapoemëruar.
3.2.4	<i>KLP-ja përparon me emërimet e prokurorëve. (pz. 2024-2026)</i>

	<u>Institucioni raportues: KLP</u> <u>Informacion mbi zbatimimin e masës:</u> Me vendimin Nr.140 datë 18.07.2024, KLP miratoi shpalljen e vendeve të lira për magjistratët e emëruar në vitin 2024. Kjo shpallje bëhet në përputhje me numrin e studentëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, shifër të cilën Këshilli e ka të njohur paraprakisht, nisur nga numri maksimal që vetë ka miratuar tre vite përpara, në fillim viti, sikurse specifikuar në masën 4.1.3 Pra, emërimi dhe caktimi në pozicione e magjistratëve të rinj, bëhet në përputhje me një plan të miratuar nga Këshilli, i cili nuk është dokument i mëvetshëm, por i lidhur me vendimin e sipërcituar për shpalljen e vendeve të lira. Kjo procedurë paraprihet nga shpallja e vakancave në fillim të cdo viti dhe referuar nenit.43 të ligjit 96 /2016, Këshilli ka detyrimin ligjor të përfundojë të gjitha procedurat e shpallura për lëvizjen paralele apo ngritjen në detyrë përpara se të emërojë dhe të caktojë në detyrë të diplomuarit. Në kuadër të krijimit të një mekanizmi efikas koordinimi me institucionet që ofrojnë informacionin e nevojshëm për kontrollin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve magjistratë KLP raporton se koordinimi me ILDKPKI bëhet zyrtarisht në përputhje me Nenin 32, të ligjit Nr.96/2016 dhe ILDKPKI brenda afateve ligjore të ligjit të tij të posaçëm sjell raportin e hetimit pasuror të kandidatëve. Koordinimi mes dy institucioneve është efikas, i realizuar brenda afateve ligjore. Me vendimet Nr.117-139, datë 18.07.2024, KLP emëroi magjistratët e rinj dhe pas shpalljes së vendeve të lira për ta, dhe me vendimet Nr.153-175, datë 25.07.2024, KLP caktoi në detyrë 23 magjistratët, në përputhje me planin e mëparshëm të emërimeve.
3.2.5	<i>KLP zgjeron më tej procedurat e vlerësimit dhe avancimit në karriere të prokurore bazuar në kriteret cilësore dhe sasiore. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLP</u> <u>Informacion mbi zbatimimin e masës:</u> Për procedurat e vlerësimit publikohen rregullisht: vendimi për miratimin e programit, caktimi me short i relatorit dhe Këshilltarit të Komanduar që do të hartojë raportin analitik dhe vendimi i përfundimtar i Këshillit për vlerësimin e prokurorëve. Sa i përket ngritjes në detyrë në pozicion drejtuesi, për vitin 2024 janë realizuar 6 procedura. KLP ka riemëruar 1 drejtues, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (konfirmuar nga vetting me vendim të formës së prerë), ka ngritur në detyrë dy prokurorë, përkatësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Gjirokastër. Gjithashtu janë ngritur në detyrë 3 prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, (konfirmuar nga vetting me vendim të formës së prerë). Procedurat e ngritjes në detyrë janë transparente, të pasqyruara në ëeb-in e institucionit që nga momenti i shpalljes, shfaqjes së interesit të kandidatëve, kushtet ligjore,verifikimi i pasurisë etj.
3.2.6	<i>Sigurohet zbatimi në kohë dhe efikas i vendimeve penale të formës së prerë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: PP, MD, DPB, DSHP, DSHPSH</u> <u>Informacion mbi zbatimimin e masës:</u> PP raporton se gjatë vitit 2024 janë ekzekutuar 5201 vendime, ndërsa kanë mbetur pa u ekzekutuar vetem 1090 vendime, ose 20,95 % e vendimeve. Numri i vendimeve sipas llojit të tyre të mbetura pa ekzekutuar është 298 vendime me burgim, 220 vendime për dënime me gjobë, 0 dënime plotësuese dhe 572 dënime alternative Në muajin prill të vitit 2024, Prokurori i Përgjithshëm ka zhvilluar analizat vjetore në të gjitha

	Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm ku ndër të tjera si çështje specifike është zhvilluar dhe analiza e çdo prokurorie lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale për vitin 2023. Gjithashtu Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2023, përmban analizë statistikore për ekzekutimin e vendimeve penale. Për të treguesit statistikore dhe zhvillimet institucionale për vitin 2024, analizat vjetore në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm do të zhvillohen në muajt në vijim.
3.2.7	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe PP sigurojnë mbledhjen dhe raportimin e të dhënave përkatëse për krimet e lidhura me gjakmarrjen dhe krimet e urrejtjes bazuar në Udhëzimet e PP-së të vitit 2019 duke reflektuar rekomandimet e ODIHR. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: PP, SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Kodi Penal parashikon në disa dispozita mbrojtjen e barazisë së shtetasve, të drejtave dhe lirive të ligjshme të tyre, pa dallim origjine, seksi, orientimi seksual apo identiteti gjinor, bindje fetare, politike ose etnie, kombësie, race, etj. Konkretisht këto vepra penale janë: Neni 73, Genocidi; Neni 74, Krime kundër njerëzimit; Neni 74/a, Shpërndarja kompjuterike e materialeve komp.pro genocidit ose krimeve kundër njerëzimit; Neni 84/a, Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik; Neni 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet istemit kompjuterik; Neni 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sist. kompjuterik; Neni 253 Shkelja e barazisë së shtetasve; Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve; Neni 266 Thirrja për urrejtje nacionale. Referuar të dhënave statistikore të organit të Prokurorisë për veprat penale të mësipërme, rezulton se per periudhën janar-dhjetor 2024 rezultojnë: • Lidhur me nenin 84/a të Kodit Penal janë regjistruar 3 procedime penale. • Lidhur me nenin 119/a të Kodit Penal, është regjistruar 1 procedim penal. • Lidhur me nenin 265 të Kodit Penal, janë regjistruar 6 procedime penale me 1 të pandehur dhe është dërguar për gjykim 1 procedim penal me 1 pandehur. PP raporton se referuar listës së trajnimeve të përcjellë nga SHM për vitin shkollor 2023-2024 nuk ka pasur tema trajnimi lidhur me gjakmarrjen. Referuar të dhënave statistikore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm për veprat penale të lidhura me gjakmarrjen, e konkretisht; Neni 78/a-Vrasje për gjakmarrje; Neni 83/a Kanosja për hakmarrje/gjakmarrje dhe Neni 83/b, Nxitja për gjakmarrje, per periudhën janar-dhjetor 2024 rezultojnë: • Lidhur me nenin 83/a të Kodit Penal, "Kanosja për gjakmarrje", është regjistruar 1 procedim penal. • Lidhur me nenin 78/a të Kodit Penal "Vrasja për gjakmarrje", nuk ka asnjë procedim të ri të regjistruar por 1 procedim me një të pandehur, është dërguar për gjykim. • Lidhur me nenin Neni 83/b, "Nxitja për gjakmarrje", është regjistruar 1 procedim penal për vitin 2024. ShM raporton se ka bërë pjesë të trajnimit vazhdues edhe temën e krimeve të urrejtjes. Në bashkëpunim me programin Help ka zhvilluar një kurs online në datat 1 korrik-6 shtator 2024 për këtë temë. Në muajin shkurt 2025 është parashikuar një tjetër aktivitet trajnues me temë: "Zbatimi i ndalimit me ligj të krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes me fokus LGBTIQ+ .".
3.2.8	<i>Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme sigurojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: PP, DPPSH</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u>

Prokurori i Përgjithshëm në kuadër të angazhimit institucional për rritjen e sigurisë së gazetarëve ka nxjerrë qarkoren nr. 1355 prot., datë 22.10.2024, drejtuar të gjitha prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, përmes së cilës udhëzon trajtimin nga prokurorët të sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave si prioritet, duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e mbrojtjes së lirisë së medias. Është caktuar pika e kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme (Koordinatori për të drejtën e informimit) për raportimin dhe publikimin e çështjeve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe po krijohet track record i këtyre rasteve.

Referuar të dhënave statistikore, vijon hetimi për 1 procedim penal të regjistruar në vitin 2023. Vijon hetimi për ngjarjen e ndodhur në vitin 2023 pranë një media private kombëtare në Tiranë, ku persona të pidentifikuar duke drejtuar një automjet, kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të godinës së televizionit kombëtar ku si pasojë e të shtënave ka humbur jetë rojtari i këtij televizioni. Ndërkohë për 2 procedime penale të regjistruara në vitin 2023 për shkak të ligjit për amnistinë është pushuar hetimi.

Gjithashtu, vijon gjykimi në shkallën e parë për 2 procedime penale të dërguara për gjykim nga Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm (Një çështje për nenin 237 të Kodit Penal “Goditje për shkak të detyrës” (në bashkëpunim), ndaj dy të pandehurve të akuzuar për sulm ndaj një shtetasi me profesion gazetar; - Një çështje për nenin 237, “Goditje për shkak të detyrës”, 150, “Shkatërrim prone”, 110 “Heqja e paligjshme e lirisë”, të Kodit Penal, ndaj një të pandehuri.)

Për vitin 2024 është regjistruar kryesisht procedimi penal nr.1415, datë 07.11.2024 për veprën penale ‘Kanosje për shkak të detyrës’ ndaj një shtetasi me profesion gazetar i cili ka denoncuar publikisht dhunën e ushtruar ndaj tij. Çështja vijon të jetë në hetim. Gjithashtu, janë regjistruar 2 kallëzime penale të reja ku denoncues janë gazetarë për veprën penale të “Kanosjes për shkak të detyrës”, nga të cilat për 1 kallëzim është vendosur mosfillimi ndërkohë që 1 kallëzim të tjera janë në fazën e verifikimeve paraprake.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë raporton se nuk ka pasur të dhëna për veprime të kryera nga Policia për dhunë ndaj gazetarëve. Do të merren masat sipas ligjit për çdo raportim dhe do të ndiqen hapat ligjore për çdo rast.

Për OS 3.2 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***Numri mesatar i çështjeve për prokuror***

Ky tregues mat mesatarisht numrin e çështjeve që një prokuror ka në hetim gjatë një viti, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve dhe juridiksioneve të ndryshme. Ai shërben për të vlerësuar nivelin e ngarkesës së prokurorëve dhe për të analizuar ndikimin e saj në efikasitetin e punës së prokurorisë. Një ngarkesë e lartë mund të ndikojë jo vetëm në ritmin e trajtimit të çështjeve, por edhe në cilësinë e hetimeve penale, duke ndikuar kështu në funksionimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë.

Referuar të dhënave për vitin 2024 të numrit faktik të prokurorëve në Prokuroritë e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe totalit të çështjeve penale të (regjistruara, mosfilluara, mbartura, rifilluara), ngarkesa mesatare për një prokuror të shkallës së parë është afërsisht 330 çështje.

Objektivi Specifik 3.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.3 parashikon 4 masa, prej të cilave **1 masë është zbatuar pjesërisht** dhe 3 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë-shih metodologjinë).

0% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 3.3 Përmirësimi i kapacitetit të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit me qëllim sigurimin e hetimeve dhe procedimeve penale efikase në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.	
3.3.1	<i>SPAK harton dhe miraton një strategji efikasiteti për shpërndarje të barabartë të ngarkesës për prokurorët dhe OPGJ. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues: SPAK</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit. Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka draftuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të projektit EU4LEA dokumentin strategjik “Udhërrëfyesi dhe Plani i veprimt për reduktimin e çështjeve të prapambetura në Prokurorinë e Posaçme për vitin 2024-2027”. Prioritizimi i çështjeve dhe procedimeve të mbartura është pjesë e Objektivit 5.1 “reduktimi i çështjeve të mbartura”, i parashikuar në Planin Strategjik 2024 - 2027 të Prokurorisë së Posaçme dhe në masat për zbatimin e kësaj strategjie. Ky dokument përshkruan hap pas hapi metodologjinë që duhet të ndiqet nga Prokuroria e Posaçme, duke përfshirë analizën për të identifikuar problemin, masat për zgjidhjen e problemit, monitorimin e zbatimit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë për të parandaluar përsëritjen e tij, me qëllim reduktimin e çështjeve të prapambetura. Përmbyllja e draftimit dhe miratimi i këtij Udhërrëfyesi janë pezulluar për shkak të përfundimit të projektit EU4LEA dhe priten të përfundohen brenda vitit 2025, përmes fondeve të buxhetit të shtetit ose të asistencës ndërkombëtare.
3.3.2	<i>Sigurimi i burimeve njerëzore dhe buxhetit të duhur për zbatimin praktik të strategjisë së efikasitetit për shpërndarjen e ngarkesës së punës në SPAK (Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit). (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: SPAK</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> SPAK aktualisht ka të përmbushur strukturën në lidhje me emërimin e Prokurorëve të Posaçëm, me hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Për vitin 2025, me shtimin e numrit të hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit do të vijojë dhe procedura e rekrutimit të 40 hetuesve. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 do të vijojë dhe plotësimi i strukturës me staf administrativ të Prokurorisë së Posaçme. Ministria e Financave ka alokuar çdo vit fonde sipas kërkesave buxhetore, në përputhje me numrin e strukturës së miratuar për SPAK. Prokuroria e Posaçme ka të miratuar me Urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. 134, datë 07.02.2024 “Për miratimin e dokumentit “Strategjia e Burimeve Njerëzore për vitin 2024 – 2026, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”. Drejtoria e burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve është e ngarkuar për monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie. Në bazë të numrit të strukturës organike, i kërkohen Ministrisë së Financave alokimi i fondeve buxhetore. Bazuar në Strategjinë e Burimeve Njerëzore për vitin 2024 – 2026, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe në Strukturën e miratuar, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar parashikon në projekt buxhet, plotësimin e kërkesave buxhetore në funksion të strukturës së miratuar për SPAK. Me Urdhrin nr. 679, datë 09.10.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e planit të trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026”, është miratuar plani i trajnimeve duke analizuar ekspertizën e SPAK me trajnimet e ofruara nga Shkolla e Magjistraturës, në ndërthurje me asistencën ndërkombëtare, për të koordinuar dhe adresuar kapacitetet e burimeve njerëzore, të cilat janë specifike dhe që kërkojnë shkëmbim eksperiencash me praktikant më të mira

ndërkombëtare. Me shkresën nr.5873/1, datë 30.04.2024, Prokuroria e Posaçme i ka dërguar Shkollës së Magjistraturës temat specifike të trajnimit, që janë të domosdoshme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në përputhje me objektin e veprimtarisë që funksionon kjo strukturë. Gjatë vitit 2024, nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe hetuesit financiarë janë ndjekur trajnime vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës. Ndërsa stafi administrativ i SPAK, ka ndjekur trajnime të ndryshme pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Gjithashtu prokurorët e posaçëm çdo vit në bazë të planit të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë ofrojnë ekspertizën e tyre si lektorë pranë Shkollës së Magjistraturës.

Prokurorët e Posaçëm, Oficerët e Policisë Gjyqësore, Hetuesit Financiar dhe Ekspertët, kanë shprehur interes për pjesëmarrje në trajnime në fushën e pastrimit të parave, duke përfshirë të gjitha temat që janë të lidhura me nenin 287 të Kodit Penal, hetimet paralele financiare, rikuperimin e aseteve dhe dispozitat e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, duke sugjeruar zhvillimin e tyre në bashkëpunim me ekspertë nga agjenci të tjera ligjzbatuese si Agjencia e Inteligjencës Financiare apo Agjencia e Administrimit dhe Konfiskimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2024, në zbatim edhe të planit të trajnimeve 2023 – 2026, ka zhvilluar disa takime me donatorë ndërkombëtarë të cilët ofrojnë ekspertizë për mbështetje në fusha të ndryshme të trajnimeve dhe veçanërisht në fushën e hetimit financiar. Me Urdhrin nr. 679, datë 09.10.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e planit të trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026”, është miratuar plani i trajnimeve duke analizuar ekspertizën e SPAK me trajnimet e ofruara nga Shkolla e Magjistraturës, në ndërthurje me asistencën ndërkombëtare, për të koordinuar dhe adresuar kapacitetet e burimeve njerëzore, të cilat janë specifike dhe që kërkojnë shkëmbim eksperiencash me praktikantë të mira ndërkombëtarë.

SPAK ka marrë pjesë në 12 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (SHM), me temat e mëposhtme:

1. Veprat penale vazhduese dhe dallimi nga përsëritja

- Dallimi mes veprave penale të vazhdueshme dhe përsëritjes.
- Momenti i konsumimit të veprës dhe fillimi i afateve të parashkrimit për ndjekjen penale.
- Veprat penale të qëndrueshme (permanente) dhe komponentët e tyre kryesorë.

2. Rishikimi i vendimeve penale të formës së prerë

- Tiparet dhe ndryshimi i nenit 450 të K.Pr.Penale mbi rishikimin e vendimeve penale.
- Dallimi mes nenit 450, pika 1, germa “e” dhe nenit 420/1 të K.Pr.Penale.

3. Përgjegjësia penale e personave juridikë

4. Gjykimi në mungesë dhe kriteret ligjore të zbatimit

- Gjykimi në mungesë në seancë paraprake dhe në themel.
- Gjykimi në mungesë si shkak ligjor për rivendosje dhe rishikim.
- Problematikat e evidentuara në praktikën gjyqësore.

5. Pastrimi i parave

- Thellimi i njohurive mbi pastrimin e parave dhe mënyrat e hetimit të tij.

6. Ndjekja penale dhe gjykimi i veprave që lidhen me zgjedhjet

- Hetimi dhe procedimi penal i veprave penale që lidhen me zgjedhjet.

	7. Hetimi dhe gjykimi i krimeve seksuale • Standardet e GJEDNJ dhe Komitetit të CEDAË për gjykimin e krimeve seksuale. • Shfrytëzimi seksual online i të miturve dhe metodat e hetimit. • Praktika gjyqësore dhe sfidat në luftën kundër shfrytëzimit seksual të të miturve. 8. Kontrolli konventor dhe kushtetues nga gjyqtari i juridiksionit të zakonshëm • Roli i gjyqtarit në zbatimin e drejtpërdrejtë të standardeve konventore dhe kushtetuese. • Autoriteti i jurisprudencës së GJEDNJ dhe GJK. • Kontrolli nëpërmjet interpretimit pajtues dhe gjykitimit kushtetues. 9. Raporti mes krimit dhe komunikimit me publikun • Rëndësia e informacionit të saktë në burimet e hapura. • Sekretet hetimor dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej tij. 10. Manual për pastrimin e parave • Njohuri dhe udhëzime për hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave. 11. Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes • Shqyrtimi i kërkesave për pushimin e akuzave dhe çështjeve. • Revokimi i vendimeve të pushimit. 12. Trafikimi i qenieve njerëzore • Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar mbi trafikimin e qenieve njerëzore. • Formave të kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore. • Praktika gjyqësore dhe pozicioni procedural i viktimave. • Mbështetja dhe trajtimi i viktimave gjatë procesit gjyqësor. Trajnimet me ekspertë ndërkombëtarë • Shkolla e Magjistraturës ka organizuar një aktivitet trajnues me ekspertë ndërkombëtarë në fushën e pastrimit të parave. • Ky bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë do të vazhdojë për të forcuar më tej kapacitetet në këtë fushë.
3.3.3	<i>Përmirësimi i funksionimit të SPAK dhe specializimi i brendshëm institucional për të kryer hetime proaktive (përfshirë hetime financiare) gjatë ndjekjes penale të korrupsionit. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues: SPAK</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit. Përmirësimi i funksionimit të SPAK dhe specializimi i brendshëm institucional për të kryer hetime proaktive (përfshirë hetime financiare) gjatë ndjekjes penale të korrupsionit. (pz. 2025-2030)

	Në funksion të përmirësimit të punës së hetimeve paralele financiare dhe luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm, terrorizmit dhe pastrimit të parave, Prokuroria e Posaçme, ka miratuar me urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë nr. 1093 prot., datë 11.11.2024 Udhëzimin e Përgjithshëm “Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Struktura të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i standardeve dhe unifikimi i mënyrës së ndjekjes së procedurave penale të ndërmarra nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nga hetuesit e Sektorit të Hetimit Financiar, gjatë kryerjes së hetimit financiar dhe pasuror. Po ashtu ky udhëzim përcakton që për veprat penale të cilat janë në kompetencën e SPAK, krahas hetimit për veprën penale të nisë paralelisht dhe hetimi financiar. Në zbatim të planit të trajnimeve 2023-202 si dhe të specializimit të prokurorëve të posaçëm dhe hetuesve financiarë, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar trajnime në fushën e pastrimit të parave, duke përfshirë të gjitha temat që janë të lidhura me nenin 287 të Kodit Penal, hetimet paralele financiare, rikuperimin e asetëve dhe dispozitat e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Këto trajnime janë zhvilluar në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë, Shkollën e Magjistraturës, agjenci të tjera ligj zbatuese si Agjencia e Inteligjencës Financiare apo Agjencia e Administrimit dhe Konfiskimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Prokurorët e posaçëm, hetuesit financiarë dhe hetuesit e BKH-së, kanë shprehur interes për pjesëmarrje në këto trajnime vazhdueshme, të cilat ofrojnë përditësim me zhvillimet më të fundit në fushë si dhe shkëmbim eksperiencash me praktikantët më të mira ndërkombëtarë. Disa nga temat e trajnimeve të kryera këtë vit, me rëndësi për hetimet financiare dhe kriptovalutave, janë evidentuar si më poshtë: ☐ Monedhat virtuale dhe krimi kibernetik. ☐ Teknikat e hetimit financiar. ☐ Mbështetje për rikuperimin e pasurive në Ballkanin Perëndimor. ☐ Provat digjitale. ☐ Kriptovalutat. ☐ Asetet virtuale. ☐ Përmirësimi i aftësive financiare dhe të kontabilitetit për gjyqtarët dhe prokurorët. ☐ Tryezë e rumbullakët mbi komunikimet në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
3.3.4	<i>Sigurohet zbatimi në kohë dhe efikas i vendimeve penale të formës së prerë. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> SPAK , MD, DPB, DSHP, DPP, Gjykatat e Posaçme <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.

Për OS 3.3 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***Përqindja e konfiskimeve në raport me kërkesat për sekuestrim në procesin penal***

Qëllimi i këtij treguesi është të vlerësojë efektivitetin e sistemit gjyqësor në trajtimin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve në proceset penale lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Matja e tij synon të identifikojë nëse zbatohen në mënyrë efektive kërkesat për sekuestrim të pasurive të paligjshme dhe kriminale, duke treguar një trend rritës të konfiskimeve. Ky tregues ndihmon në monitorimin e përpjekjeve për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke siguruar që masat ligjore të zbatohen me rigorozitet dhe transparencë.

Prokuroria e Posaçme gjatë ushtrimit të funksioneve të saj kushtetuese dhe ligjore, sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive që rrjedhin nga aktiviteti kriminal, mbështetet tek:


1. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, për pasuri të zbuluara gjatë procesit penal.
2. Ligji nr. 10192/2009, që synon parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit përmes masave ndaj pasurisë.
3. Akti Normativ nr. 1/2020, i cili vendos masa parandaluese për forcimin e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar dhe konsolidimin e rendit publik.

Vlera totale e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga SPAK, (për pasuri rrjedhojë e aktivitetit kriminal zbuluar gjatë procesit penal, bazuar vetëm në kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim në dispozitat e Kodit Penal) gjatë vitit 2024 kap shifrën prej rreth 44 milion euro, ku vlera e sekuestrimeve zë 27.27%, ndërsa vlera e konfiskimeve zë 72.73 %, të totalit.

Siç vihet re, vlera e konfiskimeve gjatë vitit 2024 është dukshëm më e lartë se vlera e sekuestrimeve. Ky ndryshim vjen pasi shumë vendime për konfiskim të dhëna nga GJKKO gjatë vitit 2024, rezultojnë të jenë bazuar në kërkesa për konfiskim të Prokurorisë së Posaçme të viteve të mëparshme, çka ka rritur edhe këtë vlerë në raport me atë të sekuestrimeve.

PËRQINDJA E KONFISKIMEVE NË RAPORT ME KËRKESAT PËR SEKUESTRIM NË PROCESIN PENAL

■ Vlera e sekuestrimeve ■ Vlera e konfiskimeve



Objektivi Specifik 3.4

Plani i Veprimit për Objektivin 3.4 parashikon 4 masa, prej të cilave **1 masë është zbatuar plotësisht**, 2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe **1 masë nuk është zbatuar**. 25% e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 3.4 Përkrahja/promovimi dhe rritja e përdorimit të mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.

3.4.1

Dhoma e Ndërmjetësve vazhdon të forcojë sistemin e ndërmjetësimit duke: ofruar trajnime fillestare dhe të vazhduara për kandidatët ndërmjetës dhe ndërmjetësit e akredituar; kryer fushata ndërgjegjësuere për ndërmjetësimin dhe rritur numrin e ndërmjetësve. (pz. 2024-2030)

	<u>Institucioni raportues: DHKND</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKND) ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të forcuar dhe promovuar ndërmjetësimin si mekanizëm alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Për këtë qëllim, janë hartuar nevojat për trajnimin fillestar dhe të vazhduar për vitin 2024, duke u trajnuar 89 kandidatë për t'u licensuar si ndërmjetës, me një trajnim që ka nisur në qershor 2024, si dhe 110 ndërmjetës të akredituar nëpërmjet trajnimeve të vazhduara. Në kuadër të forcimit të kapaciteteve, janë organizuar shtatë ëorkshop-e me gjyqtarë dhe prokurorë, një trajnim me Policimin në Komunitet, si dhe një trajnim për gjyqtarët në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Europës. Për të harmonizuar praktikat ndërmjetësore dhe licencimin e ndërmjetësve në nivel rajonal, janë ngritur dy grupe pune për unifikimin e licencave midis ndërmjetësve të Shqipërisë dhe Kosovës. Një grup pune është angazhuar për hartimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe një tjetër për përgatitjen e Rregullores Teknike për zbatimin e tij. Kjo rregullore u miratua dhe u nënshkrua më 26 nëntor 2024. Në aspektin e promovimit dhe ndërgjegjësimit publik, DHKND ka organizuar një sërë aktivitete për rritjen e përdorimit të ndërmjetësimit. Janë mbajtur katër evente në qytete të ndryshme (Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Durrës) për Ditën Kombëtare të Ndërmjetësimit. Është krijuar një faqe e re në internet (www.dhkn.gov.al) me materiale promovuese, përfshirë video dhe spote informuese. Janë zhvilluar takime ndërgjegjëse me Ndihmën Juridike Falas dhe gjimnazet në Tiranë, Shkodër, Lezhë dhe Durrës për të informuar të rinjtë mbi Kodin e të Miturve. Gjithashtu, janë shtypur dhe shpërndarë 100,000 fletëpalosje në gjykata me logot e DHKND dhe KLGJ. Një tjetër hap i rëndësishëm ka qenë nënshkrimi i një memorandum bashkëpunimi me rrjetin e marketeve “Big Market”, ku janë vendosur postera dhe janë shpërndarë çanta promovuese në 110 pika të rrjetit në mbarë vendin. DHKND ka zhvilluar edhe fushata të gjera ndërgjegjësimi në televizionet kombëtare dhe lokale, radio, si dhe përmes materialeve promovuese si bluza dhe slogane sensibilizuese mbi ndërmjetësimin. Në kuadër të planifikimit për të ardhmen, është bërë një analizë për nevojat e ndërmjetësve për vitin 2025, veçanërisht për qytetet ku janë mbyllur gjykatat. Për më tepër, janë zbatuar rekomandimet e CEPEJ dhe BE për orientimin e palëve drejt ndërmjetësimit, me qëllim uljen e ngarkesës gjyqësore. Për finalizimin dhe zyrtarizimin e këtyre angazhimeve, më 26 nëntor 2024, në Kryeministri, është organizuar një event për implementimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit.
3.4.2	<i>Forcimi i transparencës së procedurave të licencimit me synim rritjen e numrit të ndërmjetësve. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: DHKND, MD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKND), në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, ka ndërmarrë hapa për forcimin e transparencës në procesin e licencimit të ndërmjetësve, me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së tyre. Një ndër masat kryesore ka qenë krijimi i një faqeje të re zyrtare në internet, ku qytetarët mund të konsultojnë listën e ndërmjetësve të licensuar dhe të zgjedhin atë më të kualifikuarin për nevojat e tyre. Gjithashtu, në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit janë publikuar qartë informacionet mbi procedurat e licencimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim. Megjithatë, disa nga masat e planifikuara për përmirësimin e transparencës nuk janë realizuar ende, përfshirë implementimin e plotë të shërbimit online dhe përmirësimin e cilësisë së informacionit për qytetarët. DHKND ka identifikuar nevojën për adresimin e pyetjeve të shumta nga qytetarët në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit, duke theksuar rëndësinë e forcimit të mekanizmave informues dhe rritjes së ndërgjegjësimit mbi procesin e licencimit.
3.4.3	<i>Detyrimi ligjor i gjykatave për të informuar siç duhet palët për mundësinë e përdorimit të ndërmjetësimit vlerësohet nga KLGJ-ja në vlerësimin e performancës. (pz. 2024-2025)</i>


	<u>Institucioni raportues: KLGJ</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> KL Gj mban në vëmendje gjatë vlerësimit të gjyqtarëve kryerjen e veprimeve si: orientimi i palëve për ndjekjen e rrugës alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, sikundër është ndërmjetësimi, sipas parashikimeve të "Metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve", miratuar me vendimin e tij nr. 264, datë 21.11.2019.
3.4.4	<i>Detyrimi ligjor i gjykatave për të informuar siç duhet palët për mundësinë e përdorimit të ndërmjetësimit vlerësohet nga ILD-ja në kuadër të inspektimeve tematike. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: ILD, DHKND/MD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Nga ana e ILD-së është kryer vlerësimi nëpërmjet realizimit të inspektimit nr. 7, datë 15.02.2024 me temë: "Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023", me periudhë realizimi 15.02.2024 – 29.03.2024. Afati për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve është 15.06.2024-15.01.2025. Nga ana e ILD-së është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al, Raporti i inspektimit nr. 500/8 prot., datë 20.05.2024 të ILD "Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023".

Për OS 3.4 janë përcaktuar dy tregues performance:

- ***Raporti midis çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim të referuara nga gjykatat dhe numrit total të çështjeve të referuara për ndërmjetësim nga gjykatat (%)***

Qëllimi i këtij treguesi është të masë efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të ndërmjetësimit në trajtimin e çështjeve gjyqësore të referuara nga gjykatat. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e suksesit të procedurave të ndërmjetësimit dhe në përcaktimin e shkallës së adoptimit të kësaj metode alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga gjykatat.

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit raporton se nga 40 rastet e referuara nga gjykatat për ndërmjetësim, 39 prej tyre janë zgjidhur me sukses përmes kësaj procedure. Ky rezultat tregon një shkallë të lartë efikasiteti dhe efektiviteti të sistemit të ndërmjetësimit, duke dëshmuar se kjo metodë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është një mënyrë efektive për të zbutur ngarkesën gjyqësore.




➤ **Raporti midis çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim dhe numrit total të çështjeve të filluara me ndërmjetësim (%)**

Rapporti midis çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim dhe numrit total të çështjeve të filluara me ndërmjetësim synon të masë performancën e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësim.

Nga 2,150 rastet e filluara me ndërmjetësim, 1,679 prej tyre janë zgjidhur me sukses përmes kësaj procedure. Ky rezultat reflekton një performancë pozitive të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, duke treguar se ndërmjetësimi është një metodë efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Shkalla e zgjidhjes prej rreth 78.1% tregon jo vetëm efikasitetin e procesit të ndërmjetësimit, por edhe një përqafim të mirë të kësaj alternative nga palët e përfshira. Megjithatë, raporti ofron gjithashtu mundësi për analizë dhe identifikim të hapësirave për përmirësim, me qëllim rritjen e mtejshme të suksesit të procedurave të ndërmjetësimit në të

ardhmen.



Objektivi Specifik 3.5

Plani i Veprimit për Objektivin 3.5 parashikon 12 masa, prej të cilave **2 masa janë zbatuar plotësisht**, 4 masa janë zbatuar pjesërisht, **1 masë nuk është zbatuar** dhe 5 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë-shih metodologjinë). 29% e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 3.5 Rritja e efikasitetit në gjykata dhe prokurori me anë të mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit.

Forcimi i efikasitetit të SPAK nepermjet perdorimit te mjeteve te Teknologjise se Informacionit. (pz. 2024-2030)

Institucioni raportues: SPAK

Informacion mbi zbatimin e masës:

3.5.1 Shtimi i sistemeve të sigurisë dhe ruajtjes së të dhënave është një proces i rëndësishëm për të garantuar jo vetëm performancën maksimale, por edhe mbrojtjen dhe menaxhimin e duhur të informacionit të ndjeshëm. Objektivat e SPAK për forcimin e efikasitetit nepermjet perdorimit te TI synojnë automatizimin e proceseve të punës që kanë të bëjnë me bazat e të dhënave, menaxhimin e burimeve dhe sistemeve duke zvogeluar gabimet njerëzore si dhe duke kursyer kohë dhe resurse. Gjithashtu synohet që nëpërmjet përdorimit të mjeteve moderne teknologjike për menaxhimin e informacionit si servera dhe storage të përshpejtohen proceset e përpunimit të të dhënave dhe dokumenteve, duke përfituar në kohe dhe reduktuar mundësinë e gabimeve. Përdorimi i mjeteve si fireëall (NGF), antivirus (EDR), dhe sisteme monitorimi të avancuara të investuara gjatë vitit të fundit të cilat mbrojnë

	informacionin nga sulmet kibernetike dhe qasjet e paautorizuara. Sistemet e detektimit të sulmeve (IDS) dhe parandalimi i sulmeve (IPS) ofrojnë mbrojtje shtesë dhe garantojnë perimetrimin e sigurisë nga lidhjet me sistemet e jashtme dhe internetin dhe deri në sigurimin e pajisjeve fundore nga agjentet e antivirusit të cilët realizojnë mbrojtje nepermjet AI me ndërhyrje minimale njerezore. Prokuroria e Posaçme gjatë 4 muajve të parë të vitit 2024, ka zhvilluar disa takime ndërmjet grupit të punës të ngritur me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë së dhe përfaqësuesve të ICITAP-it, të cilët kanë prezantuar modulet e sistemit të menaxhimit të çështjeve, si dhe fazën e ecurisë së tyre. Pjesa e mbetur e moduleve që janë planifikuar për t'u zhvilluar/ndërtuar dhe testuar janë pilotuar gjatë kësaj periudhe, ku në muajin Dhjetor 2024, janë futur në përdorim pjesa kryesore e moduleve të sistemit dhe po vijohet me pjesën e mbetur të moduleve për pilotimin e tyre. Ky sitem është parashikuar të përfundojë së ndërtuar/funksionuar brenda vitit 2025.
3.5.2	<i>Dizenjimi i Sistemit për Menaxhimin e Integruar të Çështjeve (ICMIS), duke përfshirë hartëzimin e të gjitha proceseve, detajet e funksionaliteteve nga Bordi i Qendrës së QTI-së. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KLGJ, KLP, ILD, PP, SPAK, Gjykatat e Posaçme, MD, QTI <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) ka hartuar Draft Udhërrëfyesin për Digjitalizimin e Sistemit të Drejtësisë, i cili edhe gjatë periudhës raportuese është konsultuar në mënyrë të vazhduar me institucionet e sistemit të drejtësisë si dhe me ekspertë të huaj të delegacionit të BE-së, nëpërmjet takimeve periodike. GNP ka vlerësuar dhe reflektuar në dokument propozimet nga secila palë. Aktualisht është dakordësuar varianti final i Udhërrëfyesit, priten vetëm komente nga UNOPS sa i takon parashikimet të buxhetit të digjitalizimit për çdo institucion të sistemit të drejtësisë. Ky buxhet, është premtuar nga BE që do të përfitohet si donacion nëpërmjet fondeve IPA III. Ndërkohë KLGJ, ka përfunduar miratimin e akteve rregullatore për ndërtimin e një Sistemi të ri të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) dhe është në pritje të çeljes së fondit për të vijuar me procedurën e prokurimit. Gjithashtu, raportohet se falë përparimit në hartimin e Udhërrëfyesit, më 31 maj 2024, u organizua një takim strategjik midis përfaqësuesve të lartë të KLGJ, PP, QTI me Ministrin e Drejtësisë, Ambasadorin e BE-së, Ambasadorin e Ambasadës Suedeze, përfaqësuesen e UNOPS, AKSHI e përfaqësues të tjerë të delegacionit të BE-së, për të diskutuar dhe nxitur hapa konkretë për zhvillimin, implementimin e këtij projekti madhor kombëtar. Në këtë takim të gjithë dakordësuan arritjet e deritanishme dhe shprehën vullnetin e mirë për të bashkëpunuar dhe ndërmarrë hapa të mëtejshëm për implementimin e një Sistemi të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve, i cili do të mundësojë ndërveprim dhe do të ofrojë shërbime digjitale për qytetarin, si një nga shtyllat kryesore të reformës në drejtësi dhe anëtarësimit në BE. Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka vijuar të ndjekë me përparësi pilotimin dhe testimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve. Objektivi i përgjithshëm është zhvillimi dhe implementimi i një sistemi të menaxhimit të gjitha çështjeve të trajtuara nga SPAK, krijimin e një regjistri elektronik /baze të dhënash, i cili mundëson ndjekje dhe administrim më të mirë të çështjeve, ndarje më të mirë të detyrave dhe përgjegjësi midis Prokurorëve, Hetuesve të BKH, zyrës së regjistratit, komunikimin me gjykatën dhe analizimin e këtij informacioni, për të nxjerrë raporte dhe statistika të sakta dhe në kohë reale. Mbi të gjitha për të krijuar një bazë të dhënash të domosdoshme për përditshmërinë, por edhe vazhdimësinë e punës. Sistemi ka një ndërtim modular dhe ka përfunduar zhvillimi/ndërtimi i moduleve. Aktualisht është bërë e mundur vënia në funksion e këtij sistemi pothuajse në tërësinë e moduleve të tij (Portali, Protokolli, Zyra e Drejtuesit, Prokurori, Regjistri dhe Hetuesi). Aktualisht po punohet për vënien në funksion edhe të moduleve të tjera si, raporte e statistika, regjistri i ekzekutimeve dhe regjistri i letër porosive, si dhe të fillojë zbatimin e sistemit elektronik të Menaxhimit të Çështjeve. Për shkak të përfundimit të projektit mbështetës të ICITAP, ky proces është pezulluar përkohësisht dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2025 me financim të BE-së.

3.5.3	<i>Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në gjykata dhe prokurori. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: QTI</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> QTI, gjatë vitit raportues informon se ka miratuar standarde teknike sa i takon specifikimeve minimale teknike të pajisjeve hardëare në institucionet e sistemit të drejtësisë. Gjithashtu ka administruar dhe miratuar kërkesën e PP për implementimin e sistemit të dedektimit dhe përgjigjes ndaj sulmeve kibernetike (EDR/ XDR) me qëllim rritjen e sigurisë në infrastrukturën fizike. Buxheti i alokuar është i pamjaftueshëm, duke sjellë vështirësi në zhvillimin e projekteve të reja, në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës, të institucioneve të sistemit të drejtësisë.
3.5.4	<i>Ngritja e sistemit të menaxhimit të çështjeve të prokurorisë me standardet aktuale teknologjike e legjislative dhe mirëmbajtja e softëare-it të sistemit. (pz. 2025-2025)</i> <u>Institucioni raportues: PP,QTI</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
3.5.5	<i>Mirëmbajtja e Sistemeve te Menaxhimit të Çështjeve. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: QTI, KLGJ, PP, ILD, MD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Nga KLGj dhe QTI nuk ka patur zhvillime të sistemeve të reja të menaxhimit të çështjeve nga institucionet objekt raportimi. Ndërkohë, informojmë se këto institucione, kryejnë mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese çdo vit, nëpërmjet kontratave të mirëmbajtjes. Investimet dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe pajisjeve në institucionet e Sistemit të Drejtësisë kryhet nga institucioni që zotëron aktualisht sistemet. Marrëveshjet e mirëmbajtjes respektojnë afatet e përcaktuara në kontratat ekzistuese. Buxheti i alokuar është i pamjaftueshëm, si dhe mungesa e ekzistencës së sistemeve ICMIS, CAMS dhe IBIS/ESB. Prokuroria e Përgjithshme e ka konsideruar me rëndësi të veçantë për rritjen e efektivitetit të punës, ngritjen dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjes. Në objektivat e PP dhe në kërkesat për bashkëpunim për ndërtimin e këtij sistemi, është; • krijimi i një sistemi që mundëson dixhitalizim të plotë të proceseve të punës; • gjenerimin e statistikave të plota, të sakta dhe të besueshme; • shpërndarjen e çështjeve me short elektronik në përputhje me aktet ligjore e nënligjore; • ndërlikdhje me baza të dhënash; • çdo kërkesë të nevojshme për një sistem me standarde bashkëkohore. Sistemi i ri i Menaxhimit të Çështjeve do të mbështetet nga Bashkimi European. Për këtë qëllim, Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr. 04 datë 04.01.2024 ngriti grupin e punës me ekspertë prokurorë nga të gjithë nivelet e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, me qëllim për sigurimin e mbështetjes së nevojshme në krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes. Grupi i punës, zhvilloi dy vizita studimore të frytshme në zyra prokurorie në Itali dhe Kosovë, vende këto të përzgjedhura përkatësisht, e para për shkak të ngjashmërisë së legjislacionit procedural penal, dhe e dyta për shkak se ka zhvilluar një sistem të ri bashkëkohor të menaxhimit të çështjeve. Në muajin tetor 2024 është nënshkruar marrëveshja midis BE-së dhe UNOPS për implementimin e sistemit CAMS dhe komponentëve të tjerë që lidhen me këtë sistem. Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 2 takime me përfaqësues të UNOPS dhe grupit të punës. Në takimin e

	zhvilluar në datë 05.11.2024 u prezantuan fazat dhe afatet e projektit, duke nisur kështu formalizimi i bashkëpunimit dhe punës së përbashkët për ndërtimin dhe implementimin e këtij sistemi të rëndësishëm. Prokuroria e Përgjithshme ka siguruar angazhim të plotë për të adresuar të gjitha nevojat tona për një sistem efikas dhe mbështetje në plotësimin e kërkesave të tjera të nevojshme për implementimin e projektit. Në datë 8 janar 2025, është zhvilluar takimi i radhës midis përfaqësuesve të UNOPS dhe grupit të punës të ngritur në Prokurorinë e Përgjithshme. Në takim u diskutuan objektivat kyçe që lidhen drejtpërdrejt me implementimin e sistemit CAMS, progresi i deritanishëm dhe masat që do merren nga të dyja palët për vijimin e punës. Procesi i masave që do të përgatisë Prokuroria e Përgjithshme do të kryhet në koordinim të ngushtë me UNOPS, duke dhënë orientimet dhe modelet e duhura në lidhje me çdo fazë të procesit. Pika e kontaktit e grupit teknik në Prokurorinë e Përgjithshme, do të sigurojë komunikimin dhe bashkërendimin e kërkesave të UNOPS për përcjellje informacionesh me prokuroritë apo administratën e tyre. Më 23 janar 2025, Bashkimi Evropian dhe UNOPS nisën zyrtarisht projektin e ri të financuar nga BE EU4Digital Justice: “Mbështetje për Sundimin e Ligjit përmes Transformimit Dixhital”, me një buxhet prej 7.5 milionë euro, i cili ka një kohëzgjatje 4-vjeçare dhe synon të ndihmojë në zbatimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve për shërbimin e prokurorisë. ILD rapoorton se për periudhën raportuese ka rinovuar afatet e licencave të përdoruesve të sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve (SMAD).
3.5.6	<i>Miratimi nga Bordi i Qendrës së TI-së i planit strategjik për zbatimin e sistemit të teknologjisë së informacionit duke përfshirë ndërveprueshmërinë në sistemin e drejtësisë, në lidhje me prokurorinë, gjykatat dhe institucionet e tjera të drejtësisë. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues: QTI</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
3.5.7	<i>Garantimi i burimeve e duhura njerëzore dhe mbështetjes buxhetore për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS) i cili garanton dhe siguron ndërlidhje me bazat e të dhënave dhe sistemet përkatëse bazuar në parashikimet vjetore. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, QTI</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Me miratimin e buxhetit të vitit 2025 për sistemin gjyqësor, pritet të fillojë zbatimin e tij në Janar 2025.
3.5.8	<i>Qendra e TI-së siguron koordinimin e duhur në zbatimin e sistemeve të menaxhimit të çështjeve duke siguruar ndërveprueshmëri. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues: QTI</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.

3.5.9	<i>Qendra e TI-së është e pajisur me burimet e nevojshme njerëzore dhe ka kompetencat e duhura me qëllim funksionimin në mënyrë efikase. (pz. 2025-2027)</i> <u>Institucioni raportues:</u> QTI <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
3.5.10	<i>Ofrimi i trajnimeve për funksionet dhe përdorimin e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve. (pz.2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> QTI, KLGJ, KLP, PP, SPAK , Gjykatat e Posaçme, ILD <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
3.5.11	<i>Zhvillimi i kapaciteteve Teknologjise se Informacionit te GJK dhe mundesimi i aksesit ne praktiken gjyqesore. (pz. 2024-2028)</i> <u>Institucioni raportues:</u> GJK <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Për sa i përket kryerjes së një studimi dhe specifikimit të kërkesave të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me teknologjinë e informacionit, menaxhimin e çështjeve, arkivimin elektronik, nevojën për staf të specializuar etj, GJK raporton se nuk është realizuar; Kjo masë nuk mund të realizohet gjatë vitit 2024, por pritet të realizohet gjatë vitit 2025. Duke qene se kjo mase pritej te realizohet me fondet e donatorit, nuk u be e mundur për shkak të vonesave në zbatimin e marreveshjes se bashkepunimit.
3.5.12	<i>Permiresimi i statistikave kombetare te drejtesise nepermjet miratimit të Urdhërit dhe zbatimit te Udhëzimit te Ministrit per statistikat kombetare te drejtesise, bazuar ne metodologjine e CEPEJ ne konsultim me institucionet e qeverisjes se sistemit te drejtesise. (pz.2024-2026)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Nuk është ngritur një grup pune i dedikuar për këtë proces. Megjithatë, brenda Ministrisë së Drejtësisë ekziston një strukturë e specializuar që përpunon dhe analizon statistikat gjyqësore. Kjo strukturë, së bashku me asistencën teknike të Justal, është angazhuar në përditësimin e Urdhrit të Ministrit për mbledhjen e të dhënave statistikore. Për të siguruar koordinimin ndërinstitutional, në këtë proces janë përfshirë përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe të INSTAT, si institucioni përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare kombëtare dhe përafrimin e tyre me Eurostat. Takimi i parë në kuadër të këtij procesi u zhvillua më 4 mars 2024, ku u diskutua mbi draftin fillestar të Urdhrit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave. Ministria e Drejtësisë ka hartuar një draft paraprak të Urdhrit, i cili është prezantuar në takimin e 4 marsit. Aktualisht, po analizohet metodologjia e CEPEJ me qëllim përfshirjen e disa indikatorëve të rinj në përmbajtjen e urdhrit. Afati përfundimtar për miratimin dhe zbatimin e Udhëzimit të Ministrit është qershor 2025. Megjithatë, për shkak të kërkesave të Komisionit Evropian për raportime të shpeshta, është e nevojshme që procesi të strukturohet në faza të qarta me afate të përcaktuara për çdo hap të rëndësishëm.

	Udhëzimi i ri synon të sjellë përmirësime të konsiderueshme në mënyrën e mbledhjes dhe përdorimit të statistikave gjyqësore, duke përfshirë: • Përmirësimin e standardizimit të të dhënave, në përputhje me kërkesat e BE-së dhe metodologjinë e CEPEJ. • Përditësimin e procedurave të mbledhjes së statistikave, përfshirë përdorimin e sistemeve elektronike për një raportim më të shpejtë dhe të saktë. • Përfshirjen e indikatorëve të rinj, që matin efektivitetin e zgjidhjes së çështjeve, aksesin në drejtësi dhe përdorimin e alternativave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. • Rritjen e transparencës dhe aksesit në të dhëna, duke siguruar që statistikatat të jenë të qasshme për publikun, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile.
--	--

Për OS 3.5 është përcaktuar një tregues performance:

➤ **Shkalla e implementimit të sistemit të menaxhimit të integruar të çështjeve (ICMS)**

Qëllimi i këtij treguesi është të masë përparimin dhe efektivitetin e implementimit të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve (ICMS) në sistemin gjyqësor. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e shkallës së zhvillimit dhe funksionalitetit të ICMS në gjykata dhe prokurori, duke ndikuar në përmirësimin e eficiencës së administrimit të drejtësisë, rritjen e cilësisë së vendimeve dhe përmirësimin e transparencës në proceset gjyqësore. Natyra e këtij treguesi është në përqindje, që tregon nivelin e implementimit të ICMS në krahasim me objektivat e përcaktuara për një periudhë të caktuar kohore. Treguesi do të masë nivelin e implementimit të ICMS, në dy momente kohore të ndryshme: zhvillimi i softëare-it i cili synohet të arrihet brenda 2027, dhe implementimi i plote me të gjitha funksionalitetet e ICMS i cili synohet të arrihet brenda 2029.

QTI raporton se me miratimin e buxhetit për sistemin gjyqësor për vitin 2025, përfshihen fondet për projektin e ri të ICMIS (projekt që përfshin 5 vite buxhetore) si dhe marrëveshjen e grantit midis Suedisë dhe KLGJ. Kësti i parë i grantit suedez u disbursua në dhjetor 2024. Projekti i ri i ICMIS do të fillojë zbatimin në Janar 2025.

Objektivi Specifik 3.6

Plani i Veprimit për Objektivin 3.6 parashikon 14 masa, prej të cilave **3 masa janë zbatuar plotësisht**, 10 masa janë zbatuar pjesërisht dhe **1 masë nuk është zbatuar**. 21% e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 3.6 Përmirësimi i kapacitetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të varesise për të përforcuar aksesin në drejtësi	
3.6.1	<i>Konsolidimi i Masterplanit të Burgjeve duke përfshirë masa për rinovimin e infrastrukturës së burgjeve dhe rritjen e kapaciteteve akomoduese për të dënuarit me burgim . (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, DPB

	<u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masterplani i Burgjeve është miratuar me Urdhër Nr.41, datë 16.09.2024 të MD. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) ka ndërmarrë një sërë masash dhe aktiviteteve konkrete në kuadër të zbatimit të objektivave të Masterplanit të Burgjeve, duke synuar përmirësimin e kushteve infrastrukturore, rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit dhe përmirësimin e proceseve të rehabilitimit dhe ri-integrimit të të burgosurve. Më poshtë paraqiten masat specifike të ndërmarra për secilin objektiv. 1. Konsolidimi i Masterplanit të Burgjeve DPB ka zbatuar një plan të detajuar për ndërtimin dhe rinovimin e burgjeve, duke përfshirë: • Projekti për ndërtimin e objekteve të reja, të cilat do të rrisin kapacitetet akomoduese për të dënuarit me burgim. • Rinovimi i objekteve ekzistuese për të siguruar një ambient më të sigurt dhe më të favorshëm për rehabilitimin e të dënuarve. • Zbatimi i standardeve evropiane në infrastrukturën e re dhe të rinovuar për të garantuar kushte të dinjitetshme dhe të përshtatshme për të dënuarit. 2. Ngritja e Kapaciteteve të Stafit të Burgjeve DPB ka vënë në zbatim aktivitete specifike për të rritur profesionalizmin dhe motivimin e stafit, përfshirë: • Organizimi i trajnimeve të rregullta për stafin e burgjeve me fokus në çështjet e sigurisë, rehabilitimit dhe të drejtave të njeriut. • Zhvillimi i moduleve të veçanta trajnimi për situata emergjente, menaxhimin e konflikteve dhe komunikimin efektiv me të dënuarit. • Krijimi i një sistemi të vlerësimit të performancës së stafit, që përfshin kritere të qarta për promovimin, bazuar në integritetin dhe rezultatet e arritura. • Nxitja e një kulture profesionale dhe motivuese përmes aktiviteteve të brendshme, që përfshijnë ndarjen e praktikave të mira dhe shpërblimin e arritjeve të stafit. 3. Forcimi i Procesit të Rehabilitimit dhe Ri-Integrimit të të Burgosurve Në këtë drejtim, DPB ka ndërmarrë hapa konkretë për të ndihmuar të burgosurit të rikthehen me sukses në shoqëri: • Zbatimi i programeve edukative, që përfshijnë kurse profesionale dhe trajnime që ndihmojnë të dënuarit të fitojnë aftësi të reja për tregun e punës. • Realizimi i aktiviteteve sociale dhe kulturore brenda institucioneve penitenciare, për të përmirësuar mirëqenien psikologjike dhe për të nxitur ndërveprimin pozitiv. • Bashkëpunimi me institucione të arsimit, organizata joqeveritare dhe entitete të tjera për të ofruar mbështetje psiko-sociale dhe mundësi punësimi për të burgosurit që dalin nga institucioni. • Integrimi i instrumenteve të posaçme për të identifikuar nevojat individuale të secilit të dënuar dhe për të hartuar një plan të personalizuar rehabilitimi dhe ri-integrimit. Përmes këtyre masave, DPB synon të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetës së të dënuarve gjatë qëndrimit në burg, si dhe të rrisë mundësitë e tyre për një ri-integrim të suksesshëm në shoqëri pas përfundimit të dënimit.
3.6.2	<i>Miratimi i Planit të Integritetit që adreson risqet e integritetit në sistemin penitenciar. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD, DPB</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Plani i Integritetit është në process draftimi dhe do të miratohet në periudhat e ardhshme të raportimit.
3.6.3	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve miraton rregullat e brendshme për çdo institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, duke synuar adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Komitetit të Helsinkit dhe CPT-së. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD, DPB</u>

	<u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> DPB ka draftuar ndryshimet për rregullat e brendshme për çdo institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, duke synuar adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Komitetit të Helsinkit dhe Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT). Këto rregulla janë hartuar për të përmirësuar sigurinë, transparencën dhe standardet e trajtimit të të dënuarve në përputhje me standardet ndërkombëtare.
3.6.4	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Ministria e Drejtësisë vazhdojnë të ndërmarrin masa për ngritjen e kapaciteteve për të rritur aftësinë raportuese dhe zbatuese të rekomandimeve të CPT-së. (pz.2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD, DPB</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Raportimi dhe zbatimi i rekomandimeve të CPT-së është deleguar në disa drejtori dhe nuk ka akoma një njësi të veçantë.
3.6.5	<i>Optimizimi i ndërhyrjes dhe pasurimi i portofolit të stafit me instrumente psiko-edukative dhe terapeutike, këshillim klinik, qasje terapeutike, maksimizimi i mbështetjes psiko-sociale. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD, DPB</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Në kuadër të zbatimit të masës për optimizimin e ndërhyrjes dhe pasurimin e portofolit të stafit me instrumente psiko-edukative dhe terapeutike, janë ndërmarrë këto veprime: Miratimi i Udhërrëfyesit për Rehabilitimin dhe Riintegrimin e të Burgosurve: U miratua me Urdhër Nr. 1687, datë 27.09.2024. Ky udhërrëfyes ofron qasje të integruar për rehabilitimin dhe riintegrimin, duke përfshirë qasje terapeutike dhe instrumente psiko-edukative për stafin dhe të burgosurit. Implementimi i Projektit “Shkolla - Aftësitë për Jetën”: Projekti po zbatohet me sukses nën kujdesin e American Community Corrections Institute (ACCI), duke ofruar trajnime për stafin dhe përfshirje të të burgosurve në programe terapeutike dhe psiko-edukative. Rezultate Konkretë për Vitin 2024: • 11,725 të burgosur kanë marrë pjesë në programe terapeutike dhe psiko-edukative. • Trajnimi i stafit me metodologji të reja psiko-terapeutike dhe qasje terapeutike për ofrimin e mbështetjes psiko-sociale. Përforsimi i Qasjes Edukative dhe Terapeutike: Në kuadër të të drejtës për arsim dhe riintegrim të shtetasve në konflikt me ligjin, është miratuar Marrëveshja e Bashkëpunimit Nr. 3414/1 prot., datë 18.06.2024, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, për të fuqizuar qasjen edukative dhe mbështetjen psiko-sociale. Protokolli i Trajtimit të Pacientëve me Masa Mjekësore: Është miratuar protokollin i trajtimit të pacientëve me masa mjekësore, duke përfshirë një qasje të unifikuar për incidentet që lidhen me shëndetin mendor dhe përmirësimin e kushteve për pacientët mjeko-ligjorë. Asistenca nga Këshilli i Evropës (KiE): • Gjatë një takimi pune më 3-4 korrik 2024, me 17 profesionistë, u përmirësua drafti i Protokollit të Incidentit për të burgosurit me çrregullime të shëndetit mendor.

	• KiE ka mbështetur krijimin e një qasjeje të unifikuar për ofrimin e shërbimeve psiko-sociale në sistemin penitenciar shqiptar, në kuadër të projektit “Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të burgosurve në Shqipëri”.
3.6.6	<i>Qeveria siguron burime të përshtatshme për ndërtimin dhe rinovimin e IEVP-ve. (pz. 2024-2026)</i> <u>Institucioni raportues: MD, DPB</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> IEVP “Pojskë” funksionon që nga 30.06.2024 si një institucion me qëllime të veçanta rehabilitimi për kategori të caktuara të burgosurash, duke i përfshirë ato në aktivitete dhe programe që synojnë riintegrimin e tyre në shoqëri pas lirim. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë , është një ndër Institucionet penitenciare në Shqipëri që ka për detyrë ekzekutimin e vendimeve penale, duke siguruar mbajtjen, trajtimin dhe risocializimin e të dënuarave. Institucioni ndodhet në zonën e Pogradecit dhe funksionon për mbajtjen e të dënuarave gra dhe vajza që janë në konflikt me ligjin. Struktura dhe organizimi i IEVP “Pojskë” është i përqendruar në sigurimin e kushteve të sigurisë, trajtimit të ligjshëm të të burgosurave dhe ofrimin e programeve për risocializimin dhe rehabilitimin e tyre. Në kuadrin ligjor të funksionimit të këtij institucioni, ligji shqiptar për ekzekutimin e vendimeve penale vendos theks të veçantë në respektimin e të drejtave të të burgosurave, përfshirë trajtimin e dinjitetshëm, qasjen në shërbime shëndetësore, edukative dhe profesionale. Ky institucion ka kapacitet maksimal të ofruar për 96 persona. Me urdhërin e Ministrit të Drejtësisë Për kategorizimin e Institucioneve të Ekzekutimeve Penale, është kategorizuar si burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion për grate dhe vajzat e dënuara dhe një seksion për gratë e paraburgosura. Për të dënuarat në IEVP Pojskë ofrohen këto shërbime: • Trajtim psikologjik për të dënuarit; • Punë studimore në lidhje me fenomene psikologjike që rrjedhin si pasojë e privimit nga liria; • Mbështetje psiko-emocionale për stafin; • Asistencë psiko-emocionale për nënat me fëmijë, ndjekje e zhvillimit psiko-motor të këtyre fëmijëve; • Programe terapeutike për menaxhimin e stresit dhe ish përdoruesit e substancave; • Programi prindërimi në distancë; • Programi i të dënuarve në prag lirim.
3.6.7	<i>Ngritja dhe funksionimi institucionit për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masën mjekësore në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (pz.2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MSHMS, MD, DPB</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Në të njëjtën kohë, në funksion të trajtimit të gjetjeve të raportit të fundit (2024) të KPT-së, si dhe në mbështetje të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ, Strazimiri kundër Shqipërisë: DPB-ja ka marrë asistencë nga KiE-ja sa lidhet me kushtet dhe trajtimin e pacientëve mjeko-ligjorë në Shqipëri. Përkatësisht, më 3-4 korrik u mbajt një takim, në cilësinë e një grupi pune, me praninë e 17 profesionistëve, në funksion të përmirësimit të draftit të parë të Protokollit të Incidentit për të burgosurit me çrregullime të shëndetit mendor. Këshilli i Evropës po ndihmon DPB-në në krijimin e një qasjeje procedurale të unifikuar lidhur me incidentet që përfshijnë të burgosurit me probleme të shëndetit mendor / çrregullime shëndetësore. Ky Protokoll do të integrohet si një shtojcë e Procedurave Standarde të Veprimit që rregullojnë praktikën e reagimit të parë, mjetet e kufizimit, ndarjes, trajtimin e vullnetshëm dhe të pavullnetshëm, etj.

Me qëllim sigurimin e qasjes së standardizuar për ofrimin e shërbimeve të kujdesit psiko-social në sistemin penitenciar shqiptar, në bashkëpunim me KiE-në është punuar lidhur me hartimin e procedurave standarde të veprimit lidhur me komponentin e shëndetit mendor, në kuadër të projektit të KiE-së “Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të burgosurve në Shqipëri”.

Stafet nga sektorët e shëndetësisë, drejtësisë dhe sistemit të burgjeve kanë punuar për optimizimin e mundësive për sigurimin e financimit të Institucionit Mjekësor të Posaçëm (për burra), sipas AD të hartuar për këtë qëllim nga këta ekspertë. Projekti për ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor (për pacientët meshkuj psikiatrikë ligjorë) është rikonfirmuar nga MSHMS si një nga projektet prioritare të NSPP, në kuadër të procesit të rishikimit afatmesëm të koordinuar nga SASPAC dhe është kërkuar mbështetja e MF për të optimizuar këtë financim. Gjithashtu, është rikonfirmuar edhe në dhjetor në kuadër të procesit të koordinuar nga SASPAC për miratimin e NSPP brenda muajit janar 2025. Ndërkohë, vazhdon puna për ngritjen e Institucionit Mjekësor të Posaçëm për gra në Shkodër dhe transferimin e grave me çrregullime të shëndetit mendor nga Qendra Spitalore e Burgjeve në këtë institucion të ri, në zbatim të grupit të punës të ngritur për këtë qëllim.

Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm të MSHMS dhe MD për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me nr. 4787 Prot., datë 23.11.2021, dhe për MD me nr. 6111 Prot., datë 23.11.2021 “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore”, si dhe aneksit të saj “Plani i Përbashkët i Veprimit për Përmirësimin e Kushteve dhe Trajtimin të Personave me Çrregullime të Shëndetit Mendor me Masë Mjekësore”, MSHMS vijon të sigurojë diagnostikimin (ekzaminime kliniko-biokimike, imazherike, konsultat e specializuara, etj.) dhe trajtimet e specializuara (ndërhyrje kirurgjikale, etj.) për problematika të ndryshme shëndetësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë, nëpërmjet Spitalit Rajonal Lezhë dhe strukturave të tjera spitalore universitare.

Gjithashtu, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, MSHMS ofron ekzaminime laboratorike, depistime epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë, nëpërmjet Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik, sipas nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, pranë Spitalit Rajonal Lezhë është emëruar një mjek psikiatër me detyrimin e ofrimit të shërbimit psikiatrik në Institucionin Tranzitor Lezhë, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit.

Janë realizuar takime periodike të grupeve ndërsektoriale të punës të ngritura, si dhe janë hartuar dokumente të praktikës klinike për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore (në Institucionin Tranzitor Lezhë). Me Urdhrin nr. 391, datë 17.07.2024, është miratuar “Plani i trajtimit për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore ‘mjekim i detyruar’”, dokument që synon të ofrojë një format të unifikuar të planit të trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, në një institucion me shtetë, si Institucioni Tranzitor Lezhë.

Me Urdhrin e MSHMS nr. 327, datë 19.06.2024, “Për miratimin e Protokollit të Kujdesit Diagnostik dhe Terapeutik për Pacientët e Axhituar”, i cili është përcjellë për zbatim edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për trajtimin e pacientëve me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore dhe të dënuarve apo të paraburgosurve me çrregullime të shëndetit mendor.

Vijojnë ndërhyrjet për rritjen e kapaciteteve të stafeve të Institucionit Tranzitor Lezhë dhe ndërhyrjet e rehabilitimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore të akomoduar në këtë institucion, me mbështetjen e ekspertëve të Sant’Egidio. Në zbatim të Projektit HF III të KiE, MSHMS, MD dhe DPB, në bashkëpunim dhe mbështetje të KiE, ka realizuar trajnimin dyditor (10-11 dhjetor) “Për përdorimin e mjeteve të menaxhimit të riskut – HCR20/v3 për Institucionin e Posaçëm Provizor Lezhë” me stafet klinike që ofrojnë shërbim në Institucionin Tranzitor Lezhë.

Të burgosurit dhe personat me çrregullime të shëndetit mendor kanë përfituar barna sipas Listës së Barnave të Rimbursueshme, në zbatim të Udhëzimit të Përbashkët të MSHMS dhe MD nr. 1, datë 17.03.2023. Vlera e rimbursimit të barnave për IEVP për vitin 2024 është 11,626,046 lekë, për 11,356 receta, për 2,532 përfitues të akomoduar në sistemin e burgjeve.

3.6.8	<i>Rritja e efektivitetit të IEVP-ve nepermjet rekomandimeve të inspektiveve të brendshme dhe të jashtme. (pz.2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, DPB <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Kjo masë është në process.
3.6.9	<i>Rritje e efikasitetit të Shërbimit të Provës nëpërmjet përmirësimit të organizimit të punës dhe forcimit të kapaciteteve. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, DSHP <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Në kuadër të rritjes së efikasitetit të Shërbimit të Provës dhe forcimit të kapaciteteve të stafit, gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 76 trajnime, të ndara si më poshtë: • 60 trajnime me prezencë fizike • 56 trajnime online Trajnimet janë organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, në bashkëpunim me 22 zyrat territoriale të këtij shërbimi. Një pjesë e konsiderueshme e trajnimeve online është realizuar nëpërmjet Shkollës së Administratës Publike (ASPA). Kostot për pjesëmarrjen në trajnimet me prezencë janë mbuluar nga vetë pjesëmarrësit. Trajnimet e zhvilluara gjatë vitit 2024 kanë mbuluar fusha të ndryshme me qëllim rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të Shërbimit të Provës. Disa nga temat kryesore përfshijnë: • Korniza e përbashkët metodologjike e vlerësimit të kapaciteteve të strukturave për integrimin evropian (CAF) – Përmirësimi i metodave të vlerësimit të kapaciteteve institucionale. • Facilituesit dhe Coach-Yeep – Zhvillimi i aftësive për lehtësimin dhe trajnimin e të rinjve në konflikt me ligjin. • Mbi funksionimin e Sistemit të Integruar për të miturit në konflikt me ligjin – Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitutional për rehabilitimin e të miturve. • Trajnim për profesionistët që punojnë me familjet e rikthyer nga zonat e luftës – Përgatitja e specialistëve për trajtimin e rasteve të ndjeshme sociale dhe ligjore. • Sistemi elektronik i gjurmimit të veprave penale të kryera nga të miturit – Rritja e njohurive mbi përdorimin e sistemeve të reja të monitorimit. • Trajnim për rritjen e kapaciteteve të të rinjve nga shtresat vulnerabël për t’u integruar në tregun e punës dhe formimin profesional – Përfshirja e të rinjve në procesin e rehabilitimit dhe integrimin shoqëror.
3.6.10	<i>Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për mirëfunksionimin e DNJF. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, DNJF <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas kryen analizë të vlerësimit të nevojës për trajnim dhe hartim të planit/kurrikulave/programeve të trajnimit, në përmbushje të detyrave funksionale të saj në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike kryejnë trajnimin e punonjësve të rinj që rekrutohen për herë të parë, por këto punonjës me trajnim të posacëm trajnohen në vazhdimësi të nevojave në funksion të pritjes së parë të subjekteve përfituese sipas kategorive të veçanta të parashikuara në Ligjin nr.111/2017.

	Për vitin 2024, në komunikim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me qëllim dakordësimin mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit me trajnim të posaçëm, si detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën “g”, të nenit 8 të ligjit nr.111/2017 Shkresë nr. 420, datë 09.02.2024 Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore me lëndë: Përcjelljen e tematikave të evidentuara si të nevojshme për kryerjen e trajnimeve vazhduese në drejtim të forcimit të kapaciteteve. Dërguar shkresë DAP/ASPA nr. 514, datë 21.02.2024, me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim për miratimin e programit të planifikimit të trajnimeve vazhduese për vitin 2024, si dhe zhvillimin e trajnimeve, si detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 9 shkronja “g” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. DNJF i është drejtuar për mbështetje edhe organizatave ndërkombëtare me shkresën me nr. 733 prot., datë 19.03.2024. Kjo kërkesë është marrë në konsideratë nga ana e organizatës Expertise France dhe Prezencës së OSBE në Shqipëri, të cilat kanë bërë të mundur zhvillimin e trajnimeve si më poshtë vijon: - Trajnim i ofruesve të shërbimit të Ndihmës Ligjore Falas mbi të Drejtat Pronësore të Grave, datë 02.07.2024, në bashkëpunim me Expertise France. - Trajnim Interaktiv “Komunikimi dhe Pritja e Qytetarëve nga Kategoritë e Veçanta” datë 31.10.2024, në bashkëpunim me OSBE. - Manual “Si të përfitojmë ndihmë juridike” në gjuhën Brail, në bashkëpunim me OSBE. Janë zhvilluar edhe 8 trajnime vazhduese nga ASPA ne vijim te kursit "Ndihma juridike parësore e garantuar nga shteti".
3.6.11	<i>Rishikimi i paketës rregullatore në lidhje me konsolidimin e praktikës për ofrimin e ndihmës ligjore. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: DNJF, MD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> DNJF zhvilloi një analizë, referuar praktikës dhe raporteve të vlerësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit, mbi ndryshimet e nevojshme që duhen bërë apo përmirësuar në kriteret e vlerësimit të cilësisë së dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike falas. Shkresa nr. 1053 prot., datë 07.05.2024, me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve juridike”, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë. Shkresa nr. 1054 prot., datë 07.05.2024, me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim për disa shtesa në Urdhrin nr. 225, datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”, duke bashkëlidhur relacionin dhe projekt-urdrin. Me anë të shkresës nr. 2009/1 prot., datë 08.11.2023, me lëndë “Mbi propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në aktet nënligjore të nxjerra në funksion të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka përcjellë projekt-propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në aktet nënligjore si më poshtë: Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”; Një ndryshim në VKM nr. 55, datë 06.02.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, ndryshuar me VKM nr. 14, datë 09.01.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 55, datë 06.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 5, datë 13.01.2025.

	Shkresa nr. 2526 prot., datë 06.12.2024, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për një ndryshim në Urdhrin nr. 424, datë 18.12.2020, “Për disa shtesa në Urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.
3.6.12	<i>Informimi, ndergjegjesimi dhe rritja e aksesit te subjekteve te ligjit per Ndihmen Juridike Falas mbi te drejtat e tyre dhe zgjidhjen e mosmarrveshjeve. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: DNJF, MD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Nga DNJF, ne bashkepunim me Ministrine e Drejtesise ka zhvilluar nje tryeze te rrumbullaket me te gjithte aktoret te cilet bashkepunojne ne sistemin e ndihmes juridike falas. Propozimi për zhvillimin e kësaj tryeze është dërguar në Ministrinë e Drejtësisë në muajin Qershor 2024 (Shkresa nr. 1406 prot., datë 20.06.2024) kjo tryezë, pas koordinimit dhe dakordësimit të agjendës me të gjithë pjesëmarrësit, u zhvillua më datë 19 Korrik 2024. Qëllimi i kësaj tryeze ishte parashtrimi i rekomandimeve të KLSH, natyra e të cilave kërkon ndërveprimin e një sërë institucioneve (Gjykatat, Dhoma e Avokatisë së Republikës së Shqipërisë, Avokatet ofrues të ndihmës juridike dytësore, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve si dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuar). DNJF ka hartuar analizën me qëllim forcimin dhe maksimizimin e impaktit në ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e ndihmës juridike. Kjo analizë është përcjellë në KLSH dhe Ministrinë e Drejtësisë me shkresën me nr. 155/1 prot., datë 15.01.2024. Në këtë analizë përcaktohen elementët ku duhet të bazohet Drejtoria në konceptimin e Kalendarit Vjetor të Aktiviteteve. Konkretisht: Zhvillimi i Aktiviteteve Ndërgjegjëse me fokus kategoritë përfituese të ligjit të cilat referuar Analizave Statistikore janë më të pakta në numër pëfituesish; Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjëse duke patur në fokus informimin e qytetarëve në bashkitë më të vogla (Çdo qendër e shërbimit të ndihmës juridike parësore e vendosur në qark do të zhvillojë aktivitete ndërgjegjëse në të gjitha bashkitë përbërëse të qarkut që kjo qendër mbulon. Psh: Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan do të angazhohet në sesione informuese sensibilizuese në qytetin e Belshit, Cërrikut, Gramshit, Librazhdit, Peqinit dhe Prenjasit).
3.6.13	<i>Rritja e efektivitetit te Sherbimit te Noterise nepermjet rritjes se kapaciteteve, llogaridhenies dhe digjitalizimit. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Për periudhën janar-dhjetor 2024, Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale ka realizuar 78 inspektime pranë zyrave noteriale në Republikën e Shqipërisë, nga të cilat janë marrë masat si më poshtë: • 13 heqje përfundimtare të licencës për ushtrimin e profesionit të noterit; • 5 pezullime të veprimtarisë noteriale; • 14 masa disiplinore për shkeljet e konstatuara. Problemet e konstatuara kryesisht gjatë inspektimeve të noterëve lidhen me përpilimin e akteve noteriale, si kontratat e shitjes së pasurive të paluajtshme, mosrealizimi i verifikimit të pasurisë për të konfirmuar nëse është e lirë përpara se të tjetërsohet, dëshmitë e trashëgimisë, si dhe mungesat e raportimeve në ish-DPPPP, kur është e nevojshme. Në bazë të ligjit nr. 110/2018 "Për noterin", i ndryshuar, dhe "Rregullores së Programit të Detyrueshëm të Formimit Vazhdues për Noterët", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 344, datë 15.10.2020, çdo vit Qendra Shqiptare e Trajnimit të Noterëve propozon kalendarin vjetor të trajnimeve, i cili miratohet nga Këshilli i DHKN dhe Ministri i Drejtësisë. Noterët kanë detyrimin ligjor për të ndjekur trajnimet çdo vit pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit. Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 188, datë 03.04.2024, “Për miratimin e kalendarit vjetor të trajnimeve vazhduese për vitin 2024”, u organizuan trajnimet e planifikuara, ku noterët pjesëmarrës u vlerësuan me 25 kredite dhe u pajisën me certifikatë pjesëmarrjeje në trajnimin e detyrueshëm vazhdues për vitin 2024.

	Noterët që nuk marrin pjesë në trajnimet e detyrueshme vazhduese nuk përfitojnë kredite dhe as certifikatë nga Qendra Shqiptare e Trajnimit të Noterëve.
3.6.14	<i>Rritja e efektivitetit të Shërbimit të Përmbartimit nepermjet rritjes se kapaciteteve, llogaridhenies dhe digjitalizimit. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> DPP raporton se janë kryer inspektime pranë 22 Zyrave Përmbartimore Vendore, në zbatim të planit vjetor të inspektimeve. Nga inspektimet e kryera janë evidentuar problematika të ndryshme, ndër të cilat: • Ngarkesë e lartë e dosjeve përmbartimore për një përmbartues gjyqësor. Për shembull, pranë Zyrës Përmbartimore Tiranë, një përmbartues gjyqësor ka mesatarisht 1,500 dosje përmbartimore në ngarkim për ekzekutim. • Mosrespektimi i afateve procedurale për shkak të ngarkesës së lartë të dosjeve në ekzekutim. • Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga institucionet e tjera, si: • IKMT për çështjet që lidhen me lirimin dhe dorëzimin e sendeve apo prishjen e objekteve. • ASHK dhe DRSHT, të cilat nuk zbatojnë urdhrat e sekuestros konservative pa pagesën e një tarife aplikimi online, edhe pse shumica e dosjeve kanë shtetin si kreditor. • Mungesa e një praktike të unifikuar përmbartimore, për shkak të boshllëqeve ligjore dhe mungesës së parashikimeve të qarta në ligj apo aktet nënligjore për procedurat specifike. • Raportet e inspektimeve nuk publikohen, pasi përmbajnë të dhëna mbi dosjet përmbartimore, palët dhe vendimet gjyqësore. Megjithatë, në bazë të Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror", vendimet për arkivimin ose fillimin e një hetimi disiplinor u janë njoftuar ankuesve që kanë kërkuar nisjen e procedurës disiplinore ndaj një përmbartuesi gjyqësor. Ministria e Drejtësisë raporton se, bazuar në Urdhrin nr. 12, datë 16.01.2024, të Ministrit të Drejtësisë, gjatë vitit 2024 janë kryer: 15 inspektime të përgjithshme pranë përmbartuesve gjyqësorë privatë. 12 inspektime të posaçme, të bazuara në urdhra të Ministrit të Drejtësisë për fillimin e hetimit disiplinor, si rezultat i ankesave të paraqitura. Nga inspektimet e kryera në vitin 2024, Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Përmbartimore ka marrë këto masa: • Fillimi i procedimit disiplinor për 2 përmbartues gjyqësorë privatë, ku: Në një rast është propozuar heqja e licencës. Në një rast është propozuar pezullimi i ushtrimit të veprimtarisë përmbartimore gjyqësore. • 4 raste të hetimit disiplinor janë pezulluar, pasi çështjet janë ende në shqyrtim nga gjykata. • 2 raste janë mbyllur, pasi nuk janë konstatuar shkelje disiplinore. • 7 licenca për përmbartues gjyqësorë privatë janë hequr, për shkak të mosushtrimit të aktivitetit. Gjatë inspektimeve pranë përmbartuesve gjyqësorë privatë, janë konstatuar problematika si: -Parregullsi në procedurat e zhvillimit të ankandev. -Mosevidentimi i veprimeve përmbartimore në dokumentacionin përkatës. -Mungesa e dokumentacionit për njoftimin e palëve në proces për të gjitha fazat e procedurës përmbartimore. Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 26/2019 "Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat", përmbartuesit janë të detyruar të ndjekin trajnime të detyrueshme vjetore pranë Qendrës së Trajnimit, sipas një programi të hartuar nga Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, i cili miratohet me urdhr të Ministrit të Drejtësisë.

Mosndjekja e trajnimeve të detyrueshme, sipas nenit 37 të Ligjit nr. 26/2019, përbën shkelje disiplinore. Për këtë arsye, trajnime të detyrueshme vazhduese do të vijnë të organizohen për të gjithë përmbaruesit gjyqësorë privatë, në përputhje me objektivat dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Për OS 3.6 janë përcaktuar tre tregues performance:

➤ ***Përqindja e personave të burgosur të punësuar, që ndjekin kurse profesionale ose që ndjekin arsimin e detyruar, përkundrejt numrit total të personave që vuajnë dënimin***

Qëllimi i këtij treguesi është të masë nivelin e përfshirjes së personave të burgosur në aktivitetet rehabilituese, si punësimi, ndjekja e kurseve profesionale dhe arsimit të detyruar. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e përpjekjeve për rehabilitimin e të burgosurve dhe integrimin e tyre të mëvonshëm në shoqëri.

Në vitin 2024, përfshirja e të burgosurve në aktivitetet rehabilituese, si punësimi, ndjekja e kurseve profesionale dhe arsimit të detyruar, ka qenë një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e përpjekjeve për riintegrimin e tyre në shoqëri pas dënimit.

Sipas të dhënave, nga të burgosurit që po vuajnë dënimin, 335 kanë qenë të punësuar, një shifër që tregon një angazhim domethënës në punësimin brenda institucioneve penitenciare, edhe pse kapaciteti i miratuar me urdhrin nr. 372, i datës 05.03.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm për vende pune ka qenë 418.

Përveç punësimit, një numër i konsiderueshëm i të burgosurve ka marrë pjesë në programe arsimore dhe profesionale. Mesatarisht gjatë vitit, 153 të burgosur kanë ndjekur kurse profesionale, duke u pajisur me aftësi që mund t'i ndihmojnë në punësim pas lirimit. Po ashtu, 124 të burgosur kanë ndjekur arsimin e detyruar, një faktor kyç për rritjen e mundësive të tyre për riintegrim.


➤ ***Raporti i numrit të shtretërve me numrin e të burgosurve (%)***

Treguesi synon matjen e numrit të popullsisë së përgjithshme në burgje në raport me numrin e shtretërve në burgje. Numri i popullsisë së përgjithshme në burgje do të ndahet në numrin e të burgosurve që po vuajnë dënimin dhe numrin e të burgosurve që janë në paraburgim (të cilët nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë), në krahasim me numrin total të popullsisë në burgje. Kjo matje është e rëndësishme për të vlerësuar përdorimin e paraburgimit dhe për të identifikuar sfidat në sistemin e drejtësisë, si dhe për të përcaktuar nevojën për reforma ligjore ose praktike.

Ky tregues ndihmon në vlerësimin e gjendjes së mbipopullimit në burgje, si edhe në vlerësimin e efektivitetit të politikave të paraburgimit, duke treguar nëse ka një tendencë të përdorimit të tepër të paraburgimit, që mund të çojë në mbipopullim në burgje dhe të shkelë të drejtat e të akuzuarve që ende nuk janë dënuar. Gjithashtu, ky indikator mund të tregojë nevojën për alternativa ndaj paraburgimit dhe përforcimin e garantive ligjore për të paraburgosurit.

Në vitin 2024, kapaciteti i burgjeve ka qenë 5,747 vende, ndërsa mesatarisht gjatë vitit në sistemin penitenciar kanë qenë të pranishëm 5,212 të burgosur. Kjo do të thotë se burgjet kanë qenë nën nivelin e plotësisë të kapaciteteve me 535 të burgosur, duke reflektuar një nivel mbipopullimi prej rreth - 9%.

Në ndarjen e popullsisë së burgjeve, vihet re se shumicën e tyre e përbëjnë personat në paraburgim. Nga 5,212 të burgosur, 2,941 kanë qenë të paraburgosur – persona që ende nuk janë dënuar me një vendim përfundimtar. Kjo do të thotë se mbi 56% e popullsisë së burgjeve ka qenë në pritje të një vendimi gjyqësor. Ndërkohë, 1,800 të burgosur kanë qenë të dënuar dhe po vuanin dënimin e dhënë nga gjykata, duke përbërë vetëm 34.5% të totalit. Një tjetër kategori e pranishme në burgje ka qenë ajo e personave të cilëve u është dhënë masë mjekimi i detyruar, të cilët kanë përbërë rreth 9% të popullsisë së përgjithshme.



➤ ***Kohëzgjatja mesatare midis kërkesës për ndihmë juridike parësore falas dhe dhënies së ndihmës juridike parësore falas***

Ky tregues mat kohëzgjatjen mesatare për përfitimin e shërbimeve nga DNJF, dmth. kohëzgjatjen mesatare midis momentit të kërkesës për ndihmë juridike parësore falas dhe dhënien efektive të saj që rezulton me mbylljen e dosjes për një çështje të caktuar. Ky tregues në vetvete synon që kohëzgjatja mesatare e procedurave për dhënien e ndihmës juridike parësore të jetë sa më e arsyeshme, me qëllim moszvarritjen e procedurave, duke iu siguruar qytetarëve akses efektiv në drejtësi.


Treguesi do të raportohet për herë të parë në vitin 2025 , viti i parë i zbatimit.

3.2.4 Qëllimi i Katërt i Politikës


Forcimi i cilësisë së drejtësisë

Qëllimi i Katërt i Politikës: 22 masa

14 masa të zbatueshme



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara



Objektivi Specifik 4.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.1 parashikon 3 masa, prej të cilave **1 masë është zbatuar plotësisht** dhe 2 masa janë zbatuar pjesërisht. 33.3% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 4.1: Sigurimi i burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore për mirë-funksionimin e sistemit të drejtësisë.

4.1.1

Qeveria/Kuvendi siguron vazhdimësi të nivelit të duhur të alokimit të burimeve për institucionet e sistemit të drejtësisë. (pz. 2024-2030)

Institucioni raportues: MD, KLGJ, ILD, KLP, PP, SPAK

Informacion mbi zbatimin e masës:

Në kuadër të masave për sigurimin e vazhdimësisë së alokimit të burimeve për institucionet e sistemit të drejtësisë, procesi i buxhetimit për vitin 2024 ka kaluar në disa faza kryesore:

Së pari, Ministria e Drejtësisë ka propozuar një buxhet prej 17 miliardë lekësh gjatë përgatitjes së Planit të Buxhetit Afatmesëm (PBA). Ky propozim është bazuar në nevojat operationale dhe strategjike të institucioneve të drejtësisë, duke synuar sigurimin e fondeve të nevojshme për funksionimin dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të sektorit.

Në fazën e miratimit, Ministria e Financave ka aprovuar një buxhet më të ulët se kërkesa fillestare, duke e reduktuar në 14.78 miliardë lekë. Ky proces pasqyron balancën mes kërkesave të sektorëve të ndryshëm dhe mundësive financiare të shtetit, duke e përshtatur buxhetin e alokuar sipas prioriteteve të qeverisë.

Në lidhje me realizimin e buxhetit, të dhënat tregojnë se deri në fund të periudhës raportuese janë ekzekutuar 13.93 miliardë lekë nga fondet e miratuara.

ILD raporton se buxheti i kërkuar në PBA për vitin 2024 është në vlerën 403,430 mijë lekë, nga të cilat 104,900 mijë lekë për shpenzime kapitale dhe 298,530 mijë lekë për shpenzime korente.

Buxheti i miratuar me ligjin 97/2023 " Për buxhetin e vitit 2024" është në vlerën 347,300 mijë lekë, ose në masën 86% të kërkesave të PBA-së, nga të cilat 73,000 mijë lekë për shpenzime kapitale dhe 274,300 mijë lekë për shpenzime korente .

Buxheti i realizuar për vitin 2024 është në total 361,859 mijë lekë, ose në masën 91.9% të buxhetit të rishikuar prej 393,600 mijë lekë. Nga këto, shpenzimet kapitale realizuar në vlerën 138,204 mijë lekë, ose në masën 99.4% të buxhetit të rishikuar prej 139,000 mijë lekë; shpenzimet korente realizuar në vlerën 223,655 mijë lekë, ose në masën 87.9% të buxhetit të rishikuar prej 254,600 mijë lekë.

KLGJ - Kërkesat buxhetore për sistemin gjyqësor sipas PBA 2024-2026 janë në shumën 7,331,450 mijë lekë,

- Buxheti i miratuar për vitin 2024 është në shumën 4,967,459 mijë lekë,
- Buxheti i miratuar për vitin 2024 është 67.7 % e kërkesave buxhetore për vitin 2024,
- Buxheti i realizuar për vitin 2024 është në shumën 4,734,658 mijë lekë,
- Buxheti i realizuar për vitin 2024 është 95% e buxhetit të miratuar për vitin 2024.

PP raporton se buxheti i miratuar me Ligj për Prokurorinë e Përgjithshme për vitin 2024 në fillim të vitit ka qenë 3.287.800 mijë lekë kundrejt kërkesave 3.290.187 mijë lekë. Buxheti i rishikuar për vitin 2024 në fund të vitit është 3.593.127 mijë lekë. Buxheti miratuar për vitin 2024 për investime ka qenë 130.000 mijë lekë aq sa ishin dhe kërkesat dhe realizimi deri tani 117.237 mijë lekë ose 90% kundrejt planit.

Buxheti i realizuar deri tani nxjerrte të dhënat nga sistemi informatik i thesarit (pasi nuk janë mbyllur akoma veprimet për llogaritë të vitit 2024) është 3.391.564 mijë lekë ose 94.4% kundrejt buxhetit të rishikuar.

Prokuroria e Posaçme ka parashikuar shpenzime korente në planin vjetor fillestar për vitin 2024 në shumën 1,351,063.0 lekë, plani vjetor i rishikuar në shumën 1,042,547.0 dhe shpenzime faktike në shumën 968,800.0 leke. Planin vjetor i parashikuar në shpenzime korente për vitin 2025 është në shumën 1,669,613,000.0 lekë. Shpenzime kapitale me financim të brendshëm janë parashikuar në planin vjetor fillestar për vitin 2024 në shumën 550,000.0 lekë, plani vjetor i rishikuar në shumën 268,000.0 lekë dhe shpenzime faktike në shumën 66,157.0 lekë. Planin vjetor i vitit 2025 në shpenzime kapitale me financim të brendshëm është 700,000,000.0 lekë.

KLP raporton se:

Komisioni Planifikimit Strategjik, Buxhetit dhe Administrimit ka parashikuar vlerën e përgjithshme të buxhetit prej 218.678.000 lekësh duke konsideruar realizimin e vitit paraardhës, duke iu referuar SPAG, SOPE dhe SINV.

	Buxhet i miratuar ndaj kërkesave të PBA për vitin 2024 është 214.083.000 lekë. Diferenca prej 3% është si rrjedhojë e mosmiratimit në vlerën e kërkuar nga KLP sa i takon zërit të shpenzimeve operative. Buxhet i realizuar ndaj buxhetit të miratuar është 199.959.900. Raporti fakt-plan jo 100%, është rezultat i mosrealizimit të zërit investime. SHM Raporton se: Propozimet për buxhetin vjetor 2024 ishin: 473.736.440 lekë; Buxhet i miratuar ndaj kërkesave të PBA për vitin 2024 është 473.736.440 lekë, pra 100%; Buxhet i realizuar ndaj buxhetit të miratuar është 462.601.702 lekë, pra 98%.
4.1.2	<i>Përmirësimi gradual i infrastrukturës gjyqësore, duke përfshirë ambiente të përshtatshme për Gjykatën e Apelit. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, PP</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka siguruar fonde për marrjen me qira të një objekti për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm deri në ndërtimin e godinës së re, me një kosto prej 330 milionë lekësh për pesë vjet. Ndërtimi i godinës së re është planifikuar me një kosto totale prej 726 milionë lekësh, e shtrirë në tre vite. Aktualisht, po vijojnë diskutimet me Bashkinë e Tiranës dhe Ministrinë e Drejtësisë për sigurimin e truallit. KLGJ dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë finalizuar dokumentin e Detyrës së Projektimit për ndërtimin e një godine të përbashkët për Gjykatën dhe Prokurorinë e Apelit, si dhe Gjykatën dhe Prokurorinë e Shkallës së Parë në Tiranë. Ndërkohë, janë alokuar fonde për përmirësime infrastrukturore në gjykatat e Kukësit, Vlorës, Dibrës, Korçës dhe Elbasanit. Po ashtu, ekziston një marrëveshje ndërmjet KLGJ dhe Prokurorisë së Përgjithshme për funksionimin e godinave sipas hartës së re gjyqësore. PP raporton se gjatë vitit 2024, është punuar për përmirësimin e kushteve të punës në prokuroritë respektive, përfshirë zgjerimin e hapësirave në Prokurorinë e Dibrës për akomodimin e stafit të shtuar.
4.1.3	<i>Plotesimi i vendeve vakante për magjistratë nga Këshillat dhe për këshilltar ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, KLP, SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Çdo fillim viti, Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcakton numrin e kandidatëve për magjistrat të profilit prokuror në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin pasardhës akademik. Ky numër përcaktohet bazuar në një projeksion të gjendjes së sistemit të prokurorisë për tre vitet e ardhshme, duke marrë parasysh elementë si procesi i rivlerësimit (vakanca të përkohshme të shkaktuara nga vendimet e KPK) dhe vakancat e përhershme (shkarkimet, dorëheqjet, arritja e moshës së pensionit, etj.). Për vitin akademik 2024-2025, me vendimin nr. 11, datë 02.02.2024, KLP ka përcaktuar që numri i kandidatëve do të jetë 25. Ky projeksion synon që deri në vitin 2030 të arrihet objektivi i përcaktuar në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës. Gjykata Kushtetuese raporton se gjatë vitit 2024 nuk ka mundur të plotësojë vakancat për këshilltarët nga radhët e magjistratëve. Sipas nenit 14/a, pika 2 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese (ligji nr. 8577, datë 10.02.2000), "Jo më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë emërohen nga radhët e magjistratëve". Aktualisht, njësia e shërbimit ligjor ka vetëm 12 këshilltarë ligjorë jo-magjistratë, ndërkohë që sipas organikës duhet të kishte gjithsej 24 këshilltarë, prej të cilëve 12 nga radhët e magjistratëve. Për të plotësuar këto pozicione, magjistratët duhet të komandohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, të cilit GJK i është drejtuar dy herë shkresërisht gjatë viteve 2023 dhe 2024. KLGJ, me vendimin nr. 69, datë 15.02.2024, ka vendosur hapjen e procedurës së komandimit dhe shpalljen e kërkesave për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, nuk ka pasur interes nga magjistratët për t'u komanduar në këtë

gjykatë. Për këtë arsye, do t'i kërkohej Kuvendit ndryshimi i nenit 14/4, pika 2 të Ligjit Organik, duke e zëvendësuar parashikimin "jo më pak se gjysma" me "jo më pak se 20%". Ky ndryshim synon të lejojë punësimin e këshilltarëve jo-magjistratë, duke pasur parasysh ngarkesën e lartë të çështjeve dhe mungesën e interesit nga magjistratët për t'u komanduar në GJK.

Analiza vjetore dhe planifikimi për tre vitet e ardhshme për përcaktimin e numrit të studentëve që mund të pranohen në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës realizohet çdo fillim viti nga KLGJ dhe SHM, bazuar në nevojat e sistemit. Pas kësaj, KLGJ vendos për kuotat e kandidatëve për magjistratë përkatës për vitin kalendarik.


Shkolla e Magjistraturës ka pranuar në PFF të gjithë konkurentët e shpallur fitues dhe ka ofruar trajnim për ta, pavarësisht nëse Këshillat kanë sjellë konfirmimet për këta kandidatë brenda afateve të përcaktuara nga ligji. Ky vendim i marrë nga Këshilli Drejtues është vlerësuar si i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të garantuar vijueshmërinë e procesit formues të kandidatëve dhe diplomimin e tyre në kohën e duhur për të hyrë në sistem. Megjithatë, vonesat e Këshillave në miratimin e kandidatëve të shpallur fitues për të marrë statusin e kandidatit për magjistrat kanë sjellë problematika dhe çështje për diskutim.

Për OS 4.1 është përcaktuar një tregues performance:

➤ **Raporti (%) midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit të kërkuar nga institucioni (për shpenzime kapitale dhe korrente)**

Ky tregues synon të masë diferencën midis buxhetit të kërkuar nga institucioni dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi. Secili institucion raporton në bazë vjetore vlerën totale të buxhetit të kërkuar dhe atë të miratuar, të ndarë në shpenzime kapitale dhe shpenzime korrente. Treguesi synon që raporti midis vlerës së buxhetit të kërkuar dhe të miratuar të jetë sa më afër 100 %. Ndarja e buxhetit sipas dy zërave do të evidentojë nëse diferencat (nëse ka) lidhen me fondet e dedikuara për pagat e stafit (shpenzimet korrente) apo për investimet (shpenzimet kapitale).

Të dhënat për vitin 2024 tregojnë se raporti midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit të kërkuar ndryshon nga njëri institucion në tjetrin. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka marrë 68% të buxhetit të kërkuar, duke pasur diferencën më të madhe. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është financuar në



masën 97%, duke qenë më pranë buxhetit të kërkuar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë 86%, ndërsa Ministria e Drejtësisë ka siguruar 87%. Shkolla e Magjistraturës është i vetmi institucion që ka marrë 100% të buxhetit të kërkuar.

Objektivi Specifik 4.2.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.2 parashikon 5 masa, prej të cilave **1 masë është zbatuar pjesërisht**, dhe 4 masa janë të pazbatueshme. 0% e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 4.2: Përmirësimi i performancës së magjistratëve në gjykata dhe prokurori	
4.2.1	<i>Këshillat përparojnë me miratimin e akteve nënligjore të mbetura për vlerësimin e performancës. (pz. 2025-2025)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KLGJ, KLP <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
4.2.2	<i>Këshillat rishikojnë metodologjinë e tyre për vlerësimin e performancës për të arritur një balancë më të madhe ndërmjet kriterëve cilësorë dhe sasiorë, si dhe rritje të transparencës së procesit dhe zbatim të metodologjisë. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KLGJ, KLP <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
4.2.3	<i>Monitorimi dhe vlerësimi periodik i akteve nënligjore që lidhen me cilësinë e punës dhe rishikimi i tyre sipas nevojës. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> PP, KLGJ <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> PP raporton se nuk ka zhvillime të reja. KLGJ po vijon vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve sipas metodologjisë së miratuar në 2019, si dhe rregullave shtesë të vlerësimit, bazuar në kriterë të qarta, objektive dhe meritokratike të cilat janë të përafëruara me standardet e CEPEJ-it, me fokus efikasitetin dhe cilësinë e drejtësisë. Këshilli angazhohet të rishikoj dhe përmirësoj metodologjinë pasi të ketë përfunduar procesi i vlerësimit për gjithë trupën gjyqësore në proces promovimi. Rishikimi përpara këtij momenti do cënonte sigurinë juridike të procesit dhe standardet e vendosura në lidhje me trajtimin e magjistratëve.
4.2.4	<i>Përmirësimi i performancës së magjistratëve bazuar në rekomandimet e inspektimeve tematike dhe institucionale të kryera nga ILD. (pz. 2025-2030)</i>

	<u>Institucioni raportues: PP, KLP, KLGJ, SHM, ILD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
4.2.5	<i>Performanca e gjykatave përmirësohet nëpërmjet anketave të përmbushjes së pritshmërive të përdoruesve të gjykatave të kryera nga KLGJ-ja/gjykatat. (pz 2025-2029)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.

Për OS 4.2 është përcaktuar një tregues performance:

- ***Niveli i përmbushjes së pritshmërive të përdoruesve të gjykatave në lidhje me funksionimin e gjykatave/prokurorive, aksesin në drejtësi dhe besimin në institucione***

Treguesi bazohet mbi anketime periodike që synojnë të masin nivelin e përmbushjes së pritshmërive të përdoruesve të gjykatave në lidhje me funksionimin e gjykatave/prokurorive, aksesin në drejtësi dhe besimin në institucione. Anketat e kënaqshmërisë së përdoruesve janë një nga elementët kryesorë të politikave që synojnë vlerësimin e proceseve të cilësisë, veçanërisht në sistemet gjyqësore. Të dhënat e mbledhura mund të përdoren, ndër të tjera, për të identifikuar pikat e forta dhe dobësitë në shërbimet e ofruara ne gjykata dhe prokurori, për të përmirësuar vazhdimisht shërbimin e ofruar dhe për të rritur besimin e përdoruesve në administrimin e drejtësisë.

Metodologjia për anketimin mund të mbështetet dhe të reflektojë standardet e përcaktuara në pyetësorët e modelit që gjenden në Udhëzuesin e CEPEJ-it për anketat e kënaqshmërisë, të përshtatur me nevojat specifike të gjykatave dhe grupeve të përfshirë në anketim.

Treguesi do të matet për herë të parë gjatë vitit 2025.

Objektivi Specifik 4.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.3 parashikon 8 masa, prej të cilave **3 masa janë zbatuar plotësisht**, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 janë të pazbatueshme. 50% e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 4.3 Forcimi i kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës me qëllim përmirësimin e trajnimit gjyqësor dhe kurrikulave të trajnimit.

4.3.1	<i>SHM rishikon Rregulloren e saj të Brendshme duke siguruar që provimi i pranimit është në përputhje standardet më të mira të BE-së dhe shkollave homologe të trajnimit gjyqësor dhe siguron që konkurrentët të vlerësohen mbi bazën e aftësisë dhe jo vetëm mbi bazën e njohurive mbi ligjin. (pz.2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Shkolla e Magjistraturës ka kryer një rishikim të rregullores dhe modelit të tezës së provimit, duke hartuar një tezë tërësisht të re për fazën e dytë dhe duke përfshirë një rast praktik në të drejtën administrative. Gjithashtu, janë rishikuar tezat e fazës së parë (scantron), me qëllim përmirësimin e vlerësimit. Modeli i ri i tezës, i përbërë nga katër rubrika, është hartuar për të testuar në mënyrë më të plotë aftësitë argumentuese, logjike dhe praktike të kandidatëve. Në këtë kuadër, projekti i Binjakëzimit që po zbatohet nga Shkolla ka si një nga komponentët kryesorë përmirësimin e provimit hyrës, me zhvillime të reja në vazhdim. Më 17 prill 2024, Shkolla organizoi një seancë trajnimi për konkurrentët, ku u shpjeguan rregullat e testimit, mënyra e plotësimit të fletës scantron, si dhe procesi elektronik i vlerësimit. Gjithashtu, pjesëmarrësve iu prezantua metodologjia e fazës së dytë të provimit (Testit Profesional), duke u shpjeguar struktura e tezës, tipologjia e pyetjeve dhe menaxhimi i kohës. Ky aktivitet organizohet çdo vit akademik, me qëllim përgatitjen sa më të mirë të konkurrentëve për procesin e provimit.
4.3.2	<i>ShM-ja siguron staf dhe burime të përshtatshme në bazë të analizave, rishikimit dhe parashikimit të nevojave për burime njerëzore dhe akademike. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Në kuadër të sigurimit të burimeve të duhura njerëzore, Shkolla e Magjistraturës ka kryer një analizë të hollësishme mbi nevojat për burime të reja dhe ka miratuar ndryshime në organigramë. Më 19 dhjetor 2024, Këshilli Drejtues ka miratuar ndryshime strukturore, duke shtuar një pozicion të ri për pedagog të brendshëm në të drejtën e BE. Gjithashtu, në shtator 2024, me kërkesë të Shkollës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë komandoi një magjistrat nga radhët e prokurorëve si pedagog të brendshëm. Në janar 2024, Shkolla zhvilloi takime me gjykatat dhe prokuroritë në të gjitha nivelet, me qëllim forcimin e rolit dhe kontributit të magjistratëve në procesin e mësimdhënies dhe trajnimit. Për këtë arsye, ajo publikoi një thirrje të hapur për pedagogë të jashtëm dhe ekspertë/lehtësues, duke i njoftuar të gjithë magjistratët për mundësinë e angazhimit në këtë proces. Këshilli Drejtues, gjatë përzgjedhjes së stafit pedagogjik për Programin e Formimit Vazhdues, i dha prioritet aplikimeve nga magjistratët e sistemit. Në shtator 2024, para nisjes së vitit akademik, Shkolla organizoi një takim me pedagogët e jashtëm dhe mentorët, për të rritur rolin e tyre në vlerësimin e kandidatëve dhe për të përmirësuar mekanizmat e këtij procesi. Shkolla do të vazhdojë me takime dhe grupe pune, duke synuar rritjen e bashkëpunimit me magjistratët. Në aspektin e zhvillimit profesional, 83% e stafit të Shkollës ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga ASPA dhe SHM, ku shumica ka ndjekur më shumë se një trajnim. Objektivi i Shkollës është që çdo vit të trajnojë 100% të stafit të saj.
4.3.3	<i>Përforcimi i programit dhe rritja e kapaciteteve të mentorëve nga SHM-ja/gjykatat. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u>

	Përmirësimi i procesit të mentorimit është vlerësuar si një nevojë imediate nga ana e Shkollës, për shkak të rëndësisë që paraqet mentorimi, si në lidhje me përmbushjen e objektivave mësimore të tij, ashtu edhe në lidhje me vlerësimin që i bëhet kandidatëve për magjistratë nga mentorët. Për këto arsye, Shkolla organizoi një tryezë të përbashkët diskutimi më 23 shtator 2024, me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Tiranës dhe Kryetarin e Gjykatës së Tiranës. Gjithashtu, Shkolla organizoi takime të veçanta në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor. Si konkluzion i këtyre takimeve, të gjithë aktorët e përfshirë ranë dakord për ngritjen e një grupi të përbashkët pune, i cili do të hartojë udhëzime të përbashkëta lidhur me të drejtat dhe detyrimet që burojnë për të gjithë subjektet e përfshira në praktikën paraprofesionale dhe profesionale. Ky grup pune ka nisur tashmë punën për hartimin e këtij manuali/udhëzuesi. Shkolla është duke zhvilluar Projektin e Binjakëzimit dhe, për këtë komponent, po përfiton nga ekspertiza e Shkollës Hollandeze (SSR). Së bashku me ekspertët e SSR, ka nisur puna për vlerësimin dhe përmirësimin e programit të mentorimit. Në tetor 2024 është realizuar një aktivitet trajnues për mentorët e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Shkolla do të vijojë trajnimet për mentorët edhe në vitin e ardhshëm akademik.
4.3.4	<i>Rishikimi i kurrikulës së formimit fillestar, miratimi dhe zbatimi i saj gjatë vitit akademik.</i> <u>Institucioni raportues: SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të mbështetjes nga Projekti i Binjakëzimit me BE, po vijon procesin e analizës, rishikimit dhe hartimit të lëndëve të reja për programin e formimit fillestar, në përputhje me standardet evropiane. Për këtë qëllim, janë zhvilluar takime me ekspertët e projektit, duke u fokusuar në përmirësimin e përmbajtjes dhe metodologjisë së trajnimit. Shkolla ka ngritur tre grupe pune për rishikimin e kurrikulave në tre drejtime kryesore: e drejta civile, e drejta penale dhe e drejta administrative. Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2024, Këshilli Drejtues ka miratuar ndryshime të rëndësishme për kurrikulën e vitit të dytë, duke përfshirë një komponent të ri për trajnimin dhe vlerësimin e praktikës paraprofesionale. Ky komponent synon zhvillimin e aftësive praktike të kandidatëve, vlerësimin përmes dosjeve individuale të praktikës dhe forcimin e rolit të mentorit në këtë fazë. Gjithashtu, Shkolla ka ngritur një grup pune për hartimin e një kurrikule të re mbi "Digjitalizimin e procesit gjyqësor", me asistencën e Këshillit të Europës, i cili ka ofruar ekspertizë për përmbajtjen e kësaj lënde. Në këtë kuadër, Shkolla ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme mbi digjitalizimin e drejtësisë. Aktualisht, po vijon puna për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulave për vitin akademik 2025-2026, duke siguruar që ato të jenë të përditësuara me zhvillimet më të fundit në fushën e drejtësisë dhe teknologjisë.
4.3.5	<i>Përmirësimi dhe pasurimi i programit të formimit të vazhduar që i përgjigjet nevojave të identifikuara për specializimin e magjistratëve në detyrë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: SHM, KLGJ, KLP, SPAK, PP</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> SHM në muajin janar 2024 nisi procesi i analizës së nevojave për trajnim, i koordinuar nga Drejtori i Shkollës në bashkëpunim me Pedagogun Përgjegjës të Programit të Formimit Vazhduar, stafin e brendshëm pedagogjik dhe stafin administrativ. Përmes Këshillave, Prokurorisë së Përgjithshme, SPAK, përmes kryetarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit, si dhe të prokurorëve të rretheve gjyqësore dhe të apelit, u koordinua marrja e nevojave dhe kërkesave për tematikat e Programit të

Formimit Vazhdues të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend. Programi dhe kalendari u hartuan me kujdes, duke respektuar një metodologji eficiente dhe bashkëkohore, duke ndërthur mënyra të ndryshme marrje të informacionit dhe nevojave të sistemit. Hapat që u ndoqën ishin:

- mbledhja dhe analizimi i pyetësorëve të pjesëmarrësve dhe raporteve të ekspertëve/lehtësuesve pas çdo aktiviteti trajnues;
- evidentimi dhe analizimi i interesit të shfaqur gjatë realizimit të diskutimeve të drejtpërdrejta gjatë sesioneve trajnuese ose aktiviteteve specifike të natyrës së brainstorming të përcjella nga ekspertët ose/dhe lehtësuesit;
- mendimi i të gjitha institucioneve të interesuara të sistemit të drejtësisë;
- konsultimi me partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë të Shkollës;
- harmonizimi me legjisllacionin e ri që ndikon në veprimtarinë e drejtësisë dhe në kuadrin e përqasjes me legjisllacionin e BE-së, dokumentet strategjike, reformën ligjore dhe institucionale, si dhe angazhimeve të marra nga Shqipëria, në kuadër të procesit të Integritetit Evropian, njohjes me detyrimet që burojnë nga instrumente ndërkombëtare të ratifikuara;
- konsultimi me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe të GJED-së; - konsultimi me praktiken e Gjyqates se Larte (nepermjet buletineve te publikuara), etj.

Shkolla do te rifilloj procesin e analizes se nevojave serish, ne muajin shkurt-mars 2025.

Pas mbledhjes së të gjitha nevojave për Formimin Vazhdues, përgjegjësi i Programit të Formimit Vazhdues, në bashkëpunim me stafin e Sektorit të Formimit Vazhdues u kujdes për hartimin e projekt programit tematik, i cili u diskutua fillimisht nga Këshilli Pedagogjik dhe Drejtori i Shkollës dhe më tej u diskutua e u miratua në Këshillin Drejtues. Në përcaktimin e numrit të aktiviteteve u mbajt në konsideratë edhe e drejta/detyrimi i magjistratëve për të marrë pjesë në të paktën pesë ditë të plota në vit (ligji nr. 96/2016, neni 5, pika 3).

Këshilli Drejtues miratoi Projekt Programin Tematik, program i cili iu dërgua Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe kryetarëve të gjykatave dhe drejtuesve të prokurorive të rretheve dhe të apeleve. Kryetarët e gjykatave dhe prokurorive dërguan listat e pjesëmarrësve, mbi bazën e formularëve të aplikimit për çdo temë. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratuan pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Formimin Vazhdues, sipas këtij kalendari.

Shkolla ka realizuar aktivitete trajnuese për të gjitha keto kategori temash. Konkretisht, 4 aktivitete për korrupsionin, 2 aktivitete për hetimin financiar, 4 aktivitete për të drejtat themelore, 1 aktivitet për lirinë e shprehjes dhe 4 aktivitete për diskriminimin. Format i moduleve filloi të zbatohet vitin akademik 2024-2025 dhe sistemi me module është pjesë e këtij kalendari, që do referohet në vijim. Në vitin 2025 janë parashikuar module për të gjitha keto tema.

Shkolla ka pilotuar organizimin e trajnimeve sipas kesaj mase ne vitin akademik 2023-2024 dhe realizoi me sukses aktivitetin me teme "Provat ne procesin civil". Gjithashtu nisi nga modulet për këte kategori pjesëmarrësish prej muajit tetor 2024 dhe ka realizuar disa aktivitete trajnuese, vecanerisht ne ceshtjet e etikes, komunikimit, integritetit, paanesise dhe provave, si ne procesin civil, edhe ne procesin penal.

Ka pasur problematike lidhur me shtyrjen e trajnimeve dhe caktimin e datave te tjera per shkak te ngarkeses se madhe te eksperteve qe vijne nga gjyqesori.

Në muajin tetor 2024 Shkolla realizoi 1 aktivitet trajnim trajneresh për metodat interaktive dhe moderne të trajnimit gjyqësor, ku moren pjesë ekspertët dhe lehtësuesit e rinj. Shkolla do të vijojë në mënyrë të përvitshme trajnimin e trajnerëve. Për vitin 2025 ka parashikuar edhe trajnime trajneresh që lidhen me lëndet e reja që synohet të përfshihen në Programet mesimore.

Shkolla ka mbledhur dhe përpunuar të dhënat e formulareve të vlerësimit të bera nga pjesëmarrësit në trajnim dhe nga vete ekspertët. Shkolla po analizon nevojën për përmirësim të metodave të vlerësimit, në bashkëpunim edhe me shkollën italiane, si komponent i projektit të binjakëzimit që është duke u zbatuar.

KLP raporton se bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës ka vijuar gjatë vitit 2024. KLP-ja ka përmblusur detyrimet e saj ligjore, në komunikim të vazhdueshëm me Sh.M, për emërimin dhe caktimin në detyrë të prokurorëve të rinj, verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve që aplikojnë për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik, miratimit të listës së trajnerëve pranë SH.M nga rradhët e prokurorëve. Me Vendimin Nr.67, datë 17.05.2024, KLP ka miratuar Rregulloren për përmblajtjen e programeve të formimit vazhdues, shërbimet lehtësuese të lejuara, si dhe për procedurën e paisjes me leje për ndjekjen e trajnimeve. Në vijim të bashkëpunimit mes dy institucioneve, në datë 01.10.2024, Shkolla e Magjistraturës prezantoi projektin e binjakëzimit me homologët francezë,


	italianë dhe holandezë. KLP nënvizoi rëndësinë e hartimit të kurrikulave dedikuar integritetit të prokurorit, të hartuar mbi bazën e modeleve të vendeve të BE-së apo SHBA-ve. Nga Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit 2024 i është kërkuar Shkollës së Magjistraturës, përfshirja në programin e trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe temave konkrete lidhur me viktimat e krimit dhe drejtësinë për të mitur. Nëpërmjet drejtuesve të prokurorive u inkurajuan oficerët e policisë gjyqësore, për të aplikuar në program sipas fushave dhe nevojave të tyre. Prokuroria e Posaçme çdo vit i dërgon Shkollës së Magjistraturës temat specifike të trajnimit, që janë të domosdoshme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në përputhje me objektin e veprimtarisë që funksionon kjo strukturë, në funksion të rritjes së kapaciteteve. Gjithashtu prokurorët e posaçëm çdo vit në bazë të planit të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë ofrojnë ekspertizën e tyre si lektorë pranë Shkollës së Magjistraturës.
4.3.6	<i>Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë për vlerësimin e trajnerëve sipas standardeve evropiane. (pz. 2026-2026)</i> <u>Institucioni raportues: SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
4.3.7	<i>Përgatitja e metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë. (pz. 2025-2025)</i> <u>Institucioni raportues: SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
4.3.8	<i>Shkolla e Magjistraturës angazhohet në veprimtari studimore dhe hulumtuese në fusha prioritare të së drejtës dhe harton produkte shkencore dhe informuese në funksion të institucioneve të sistemit të drejtësisë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: SHM</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Gjatë vitit 2024, Shkolla e Magjistraturës ka publikuar dy buletine të formimit vazhdues, të cilat janë bërë publike dhe u janë dërguar magjistratëve në adresat e tyre elektronike. Aktualisht, Shkolla është në proces botimi të buletineve të tjera. Për sa i përket botimeve periodike, janë publikuar tre numra të revistës "Magjistrati" dhe një numër i revistës "Jeta Juridike", ndërsa procesi i botimit të numrave të tjerë të "Jeta Juridike" është në vazhdim. Në lidhje me përfshirjen e aktorëve të sistemit të drejtësisë në botim dhe publikim, Shkolla ka bërë thirrje të hapur për kontribute dhe ka kontaktuar vazhdimisht subjektet e mundshme të interesuara, përfshirë studiues, kërkues dhe shkruar. Po ashtu, stafi i brendshëm dhe i jashtëm akademik është ftuar rregullisht të kontribuojë në këtë drejtim. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm është krijimi i Forumit Magjistratura, një hapësirë miqësore për komunikim profesional, e cila ka nisur aktivitetin e saj në vitin 2024. Deri më tani janë realizuar dy tema brenda këtij forumi, megjithatë angazhimi i më shumë magjistratëve mbetet ende një sfidë. Shkolla do të vazhdojë të mbështesë dhe inkurajojë këtë proces, duke kërkuar metoda sa më efektive për përfshirje më të gjerë.

Për OS 4.3 është përcaktuar një tregues performance:

- ***Përqindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë marrë pjesë në të paktën 3 ditë trajnimi në vit***

Treguesi synon të masë efektivitetin e programit të formimit vazhdues në SHM duke marrë në konsideratë numrin e magjistratëve të trajnuar gjatë një viti. Neni 5 i Ligjit për Statusin përcakton se magjistrati duhet të ndjekë formimin vazhdues për "jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve". Treguesi - tre ditë në vit - është përcaktuar si mesatare realiste bazuar në të dhënat e SHM, duke patur parasysh se magjistati mund të përmbushë detyrimin ligjor edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në programe tajnime të organizuara nga institucione të tjera të njohura nga Këshillat.

Shkolla e Magjistraturës (SHM) raporton se për vitin 2024, 78.3% e prokurorëve dhe 89.3% e gjyqtarëve kanë marrë pjesë në të paktën tre ditë trajnimi. Ky rezultat reflekton një nivel të lartë angazhimi në formimin vazhdues dhe përputhet me objektivin e programit të SHM-së, si dhe me kërkesat ligjore të përcaktuara në Nenin 5 të Ligjit për Statusin e Magjistratit.



- ***Raporti i konkurrentëve që kanë marrë pjesë në provimin e pranimit në SHM me kuotën e përcaktuar nga SHM-ja***

Qëllimi i këtij treguesi është të masë nivelin e pjesëmarrjes së konkurrentëve në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës (SHM) në përputhje me kuotën e përcaktuar nga SHM-ja. Treguesi ndihmon në vlerësimin e interesit dhe përgatitjes së kandidatëve për të hyrë në SHM dhe të kuotave të vendosura nga institucioni për pranimin e studentëve të rinj.

Shkolla e Magjistraturës (SHM) raporton se për tre vitet e fundit akademike është vërejtur një rritje e ndjeshme e interesit për provimin e pranimit, duke tejkaluar ndjeshëm kuotat e përcaktuara.

- **Për vitin akademik 2022-2023**, me 85 kuota të planifikuara (45 për gjyqtarë, 35 për prokurorë dhe 10 për ndihmës ligjorë), morën pjesë 316 konkurrentë, duke arritur një përqindje pjesëmarrjeje prej 3.7 konkurrentë/kuotë.

- **Për vitin akademik 2023-2024**, kuotat u rritën në 95 (40 për gjyqtarë, 40 për prokurorë dhe 15 për ndihmës ligjorë). Numri i konkurrentëve arriti në 382, duke e çuar raportin në 4 konkurrentë/kuotë
- **Për vitin akademik 2024-2025**, me 60 kuota të përcaktuara (20 për gjyqtarë, 25 për prokurorë dhe 15 për ndihmës ligjorë), pjesëmarrja arriti kulmin me 411 konkurrentë, duke reflektuar një raport të lartë prej 6.85 konkurrentë/kuotë.

Këto të dhëna tregojnë një interes në rritje për programet e SHM-së dhe një konkurrencë më të madhe për vendet e disponueshme, duke përmirësuar cilësinë e përzgjedhjes së kandidatëve për sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

➤ ***Përqindja e magjistratëve që ndjekin rregullisht trajnimet për të cilat janë përzgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës***

Qëllimi i këtij treguesi është të masë përkushtimin dhe pjesëmarrjen e rregullt të magjistratëve në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës duke përllogaritur përgjigjen ndaj ftesave të cilat u drejtohen atyre që kanë shprehur interes për këto trajnime dhe kanë aplikuar. Treguesi ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të programeve të trajnimit dhe angazhimit të magjistratëve për zhvillimin e tyre profesional.

Për vitin 2024, përqindja e magjistratëve që ndjekin rregullisht trajnimet për të cilat janë përzgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës është vlerësuar me përafërsi në 30%. Kjo shifër është llogaritur duke marrë në konsideratë mesatarisht 50 ftesa për aktivitet dhe një pjesëmarrje prej rreth 15 magjistratësh.



Objektivi Specifik 4.4.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.4 parashikon 6 masa, prej të cilave **3 masa janë zbatuar plotësisht**, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 2 masa janë të pazbatueshme. 75% e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi specifik 4.4: Sigurimi i aksesit në vendimet e gjykatave dhe qëndrueshmërisë së praktikave gjyqësore me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsytimit të vendimeve dhe rritjes së transparencës për publikun.

	<i>Gjykata Kushtetuese përmirëson aksesin në praktikën e saj gjyqësore. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> GJK <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Procesi i ri-dizenjimit të faqes zyrtare të Gjykatës Kushtetuese (GJK) është realizuar me mbështetjen e donatorëve dhe u përfundua në dhjetor 2024. Faqja e re do të lançohet në janar 2025, me synimin për të përmirësuar aksesin e përdoruesve në informacion mbi çështjet, seancat dhe veprimtarinë e Gjykatës.
4.4.1	Një fokus i veçantë është treguar në optimizimin e databazës së vendimeve, e cila është krijuar nga e para dhe mundëson kërkime më të avancuara me fjalë kyçe. Aktualisht, vendimet vijnë të publikohen në faqen e vjetër zyrtare, ku kërkimi sipas kriterëve të veçanta nuk është i mundur. Për një periudhë tranzitore prej 6 muajsh, të dy faqet do të qëndrojnë funksionale për të lehtësuar kalimin te platforma e re. Gjithashtu, është përfunduar dhe publikuar udhërrëfyshi i parë i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, me mbështetjen e donatorëve. Ai është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Gjykatës në linkun: https://www.gjk.gov.al/ëeb/GUIDA_3084_1.php. Udhërrëfyshi është financuar nga donatorët me një vlerë prej 3,800,000 lekësh për ekspertizën dhe botimin (450 kopje fizike). Gjykata ka kontribuar gjithashtu me organizimin e një tryeze të rumbullakët për prezantimin e tij dhe përmes angazhimit të gjyqtarëve, këshilltarëve ligjorë dhe stafit administrativ në procesin e rishikimit dhe redaktimit.
4.4.2	<i>KL GjJ-ja siguron publikimin dhe përmirëson kërkueshmërinë e vendimeve gjyqësore, veçanërisht të Gjykatës së Lartë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KL GjJ, GJL <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Gjykata e Lartë administron një portal të pavarur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KL GjJ), i cili mundëson publikimin dhe aksesin në vendimet gjyqësore. Paralelisht, KL GjJ ka përmirësuar portalin www.gjykata.gov.al, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky portal përditësohet rregullisht me informacion mbi aktivitetin e gjykatave, duke përfshirë listën e shortit, kalendarin e seancave dhe vendimet gjyqësore. Përdoruesit mund të aksesojnë të dhëna të plota të paanonimizuara përmes numrit të çështjes dhe kodit të anonimizimit, të cilat mund të merren pranë gjykatës përkatëse. Ndërkohë, të dhënat mbi veprimtarinë gjyqësore janë të aksesueshme në formë të anonimizuar për publikun, për qëllime statistikore ose gazetareske, duke siguruar transparencë dhe mbrojtjen e privatësisë. Në kuadër të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, do të kryhen përmirësime të mëtejshme në ofrimin e shërbimeve online. Fondet për këtë proces janë përdorur për mirëmbajtjen e faqes zyrtare përmes procedurave të prokurimit publik. Përmirësimet përfshijnë pasqyrimin në kohë reale të vendimmarrjes në faqen ëeb, krijimin e algoritmeve të rinj në motorin e kërkimit për të rritur efikasitetin e kërkimeve në databazën e vendimeve gjyqësore dhe rritjen e sigurisë së sistemit.


	Sekretaria Gjyqësore dhe Sektori IT sigurojnë publikimin e vendimeve të kolegjeve menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, si dhe publikimin e vendimeve të arsyetuara pas nënshkrimit nga trupa gjyqësore.
4.4.3	<i>SHM-ja ofron trajnime për hulumtimin dhe analizën e çështjeve gjyqësore. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> SHM <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
4.4.4	<i>GJL-ja vazhdon të unifikojë vendimet e gjykatave dhe si rrjedhojë praktika gjyqësore përmirësohet më tej. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> GJL <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e Buletinit Informativ për vendimet e rëndësishme po vijon rregullisht nga Qendra e Dokumentacionit dhe Sektori IT. Buletini publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe u shpërndahet abonentëve përmes email-it, duke garantuar informim të vazhdueshëm dhe akses të lehtë në vendimet kyçe.
4.4.5	<i>Vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KLGJ-ja dhe KLP-ja, përfshin, ndër të tjera, standardet e arsyetimit të vendimeve gjyqësore. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KLGJ, KLP <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
4.4.6	<i>Sigurohet monitorim dhe vlerësim transparent i aktiviteteve të gjykatës. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KLGJ <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ka përmirësuar portalin www.gjykata.gov.al, ku gjykatat përditësojnë informacion publik mbi aktivitetin e tyre, duke përfshirë listën e shortit, kalendarin e seancave, vendimet gjyqësore dhe të dhëna të tjera për çështjet gjyqësore. Për të aksesuar rubrikat me të dhëna të plotë të pa anonimizuara, përfaqësuesit apo palët mund të kërkojnë numrin e çështjes dhe kodin e anonimizimit pranë gjykatës. Gjithashtu, të dhënat mbi veprimtarinë gjyqësore janë të aksesueshme të anonimizuara edhe për publikun, për qëllime statistikore ose gazetareske, në formë anonimizuar, duke siguruar transparencë dhe mbrojtje të privatësisë. Gjykata e Lartë e përdor një portal i cili administrohet nga vetë Gjykata e Lartë dhe jo nga KLGJ.

Për OS 4.4 është përcaktuar një tregues performance:

➤ **Përfundimi i digjitalizimit të arkivave në gjykata**

Ky tregues synon të mat progresin dhe përfundimin e procesit të digjitalizimit të arkivave në gjykata. Digjitalizimi i arkivave është një pjesë e rëndësishme e modernizimit të sistemit gjyqësor, duke lehtësuar aksesin në dokumente dhe përmirësuar eficiencën në menaxhimin e çështjeve. Treguesi ndihmon në vlerësimin e shkallës së përfundimit të këtij procesi, duke treguar se sa afër është sistemi gjyqësor në përmbushjen e objektivave të tij për një arkivë plotësisht digjitale.

KLJGJ raporton se deri në dhjetor 2024, procesi i digjitalizimit të arkivave në gjykata ka përfunduar në 27 gjykata, ndërsa në 11 gjykata ende nuk është përfunduar dhe është parashikuar të rifillojë në vitin 2025.




3.2.5 Qëllimi i Pestë i Politikës


Drejtësi më e afërt me qytetarët

Qëllimi i Pestë i Politikës: 24 masa

14 masa të zbatueshme



- Plotësisht të zbatuara
- Pjesërisht të zbatuara
- Të pazbatuara



Objektivi Specifik 5.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.1 parashikon 13 masa, prej të cilave **3 masë janë zbatuar plotësisht**, 5 masa janë zbatuar pjesërisht, **1 masë nuk është zbatuar** dhe 4 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 33.3% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht

Objektivi specifik 5.1: Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e drejtësisë përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave inovative të komunikimit

5.1.1 Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme lidhur me organizimin, kompetencat dhe funksionimin e gjykatave dhe përditësimi periodik i tyre. (pz. 2025-2030)

Institucioni raportues: KLGJ, Gjykatat

Informacion mbi zbatimin e masës:

Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.

5.1.2	<i>Intervista në media me qëllim informimin mbi ndryshimet/risitë/përfitimet që solli Reforma në Drejtësi dhe promovimi i rezultateve të arritura. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, GJK</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Gjatë periudhës raportuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka zhvilluar dy intervista në media me fokus në sfidat e përballimit të ngarkesës në punë në gjyqësor dhe mbi strategjinë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Realizuar përmes intervistave të transmetuara nga Zëri i Amerikës, Tv Klan, etj. Gjykata e Lartë nuk ka pasur intervista në televizionet kombëtare apo lokale, por ka organizuar rregullisht konferencën për shtyp me përfaqësuesit e medias në fund të çdo viti. Ky aktivitet do të vijojë edhe në të ardhmen me të njëjtin format, duke siguruar një komunikim të vazhdueshëm dhe transparent me median. Konferenca për Shtyp të Kryetares së GJK-së: • 25 Janar – Çështja mbi shfuqizimin e disa neneve të ligjit nr. 60/2023 për studentët e Mjekësisë, kërkuar nga një grup deputetësh dhe studentësh. • 29 Janar – Kërkesa e 30 deputetëve për shpalljen si antikushtetues të Protokollit me Italinë mbi bashkëpunimin për migracionin. • 30 Janar – Çështja mbi shfuqizimin e ligjit nr. 38/2021 për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, kërkuar nga disa shoqata dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit. • 2 Shkurt – Prezantimi i raportit vjetor të GJK për vitin 2023 dhe diskutim me median mbi vendimet kryesore dhe çështjet me interes publik. • 13 Shkurt – Çështja mbi shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit nr. 77/2022 për pronat, kërkuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. • 24 Prill – Kërkesa për shfuqizimin e ligjit nr. 50/2022 mbi administrimin e Butrintit dhe pezullimin e zbatimit të tij deri në vendimin përfundimtar të GJK-së. • 19 Qershor – Çështja mbi shfuqizimin e disa dispozitave të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. • 27 Qershor – Çështja për shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit për tatimin mbi të ardhurat për të vetëpunësuarit në shërbime profesionale. • 9 Korrik – Kërkesa e 33 deputetëve për shfuqizimin e ligjit nr. 106/2023 mbi komisionet hetimore. • 10 Korrik – Çështja mbi kundërshtimin e vendimit të Kuvendit për mosdërgimin e mocionit në GJK mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka. • 6 Nëntor – Çështja mbi shfuqizimin e disa dispozitave të VKM nr. 457/2023 për çmimet referuese të ndërtimit në Tiranë dhe vendimarrja për përjashtimin e një gjyqtareje nga një çështje me kërkues Sali Berisha. • 21 Nëntor – Çështja me kërkues Sali Berisha mbi shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për masat e sigurisë “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë vendit.” Tryeza Bashkëbisedimi me Median • 24 Maj – Diskutim me gazetarë, ekspertë komunikimi dhe opinionistë mbi transparencën e GJK-së dhe aksesin e qytetarëve në drejtësinë kushtetuese. Nuk ka patur intervista të përfaqësuesve të Gjykatës Posaçme të Apelit gjatë vitit 2024 Nuk ka patur intervista të përfaqësuesve të Gjykatës së Shkallës së Parë KKO gjatë vitit 2024
5.1.3	<i>Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut lidhur me sistemin gjyqësor nëpërmjet platformave të mediave sociale. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, Gjykatat</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk disponon llogari në rrjetet sociale. Ndërkohë, KLGJ dhe Gjykata e Lartë kanë realizuar këtë masë duke kryer përditësime periodike në llogarinë e saj zyrtare në rrjetet sociale.

5.1.4	Hartimi dhe Publikimi i informacioneve shpjeguese për qytetarët mbi aksesin në intitucionet e drejtësisë dhe publikimi i tyre në faqet zyrtare të institucioneve të drejtësisë. (pz. 2024-2030) <u>Institucioni raportues:</u> KLGJ, KLP, ILD, Gjykatat, PP, MD, GJK <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Gjykata Kushtetuese nuk e realizoi këtë masë gjatë vitit 2024, pasi financimi i parashikuar nga donatori nuk u siguria për arsye objektive. Megjithatë, pritet që kjo masë të realizohet gjatë vitit 2025.
5.1.5	Hartimi dhe publikimi i buletinit periodik të gjykatave. (pz. 2024-2030) <u>Institucioni raportues:</u> GJK <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Për herë të parë u realizua buletini dy-mujor i vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, me mbështetjen e donatorëve. Ky buletin vijon të përgatitet dhe të shpërndahet gjerësisht në mënyrë periodike.
5.1.6	Hartimi i materialeve informuese mbi procedurën që ndiqet në çështjet penale, civile dhe ato administrative; mënyrën e paraqitjes së çështjeve, kërkesave/ankesave drejtuar gjykatës; formatet standarde; shërbimet që mund të merren nga Gjykatat; e drejta e ankimit/rekursit dhe afatet. (pz. 2025-2030) <u>Institucioni raportues:</u> KLGJ, Gjykatat <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
5.1.7	Perditesimi i materialeve informuese mbi procedurën që ndiqet në çështjet penale ; mënyrën e paraqitjes së kallzimeve drejtuar Prokurorisë; formatet standarde; shërbimet që mund të merren nga Prokuroria; e drejta e ankimit/rekursit dhe afatet. (pz. 2024-2030) <u>Institucioni raportues:</u> PP <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. 70, datë 29.06.2021, ka miratuar “Programin e Transparencës të Prokurorisë së Përgjithshme”, i publikuar në faqen zyrtare www.pp.gov.al, në seksionin “Programi i Transparencës”. Ky program përcakton kategoritë e informacionit të detyrueshëm për publikim, mënyrën e shpërndarjes dhe bazën ligjore përkatëse, me qëllim rritjen e aksesit të publikut në informacion pa kërkesë të drejtpërdrejtë, duke reduktuar nevojën për kërkesa individuale. Në kuadër të këtij programi, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm kanë përditësuar faqet e tyre zyrtare, ku tashmë publikojnë: • Raporte vjetore mbi kriminalitetin, treguesit e performancës në hetime, ndjekjen penale, përfaqësimin e akuzave në gjykatë dhe ekzekutimin e vendimeve. • Çështje të veçanta e sensitive, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretin hetimor, përfshirë masat e sigurimit personal/pasuror dhe kërkesat për gjykim. • Listën e kërkesave nga publiku dhe media, bashkë me përgjigjet përkatëse, të renditura sipas datave për respektimin e afateve ligjore. • Materiale informuese, si broshura dhe formate të tjera, të përditësuara periodikisht për informimin e publikut.

5.1.8	<i>Informimi i publikut mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posacme dhe BKH, aksesit i qytetarëve, llojet e çështjeve që trajtojnë, e drejta e ankimit/rekursit dhe afatet. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> SPAK <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
5.1.9	<i>Organizimi i aktiviteteve informuese rreth kompetencave të ILD-së, procedurave, afateve, të drejtave të palëve në procese, etj. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> ILD <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Gjatë vitit 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar gjashtë takime kryesore: • Takim me studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodrës. • Pjesëmarrje në takimin e katërt të IDM Morning Briefing, organizuar nga Instituti për Drejtësi dhe Ndërmjetësim. • Takim në Akademinë Diplomatike të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. • Takim me organizatat e shoqërisë civile për monitorimin e Reformës në Drejtësi. • Vizitë e studentëve dhe pedagogëve nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Prishtinës, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. • Takimi i fundvitit me gazetarët, për bilancin e punës së ILD. • Njëri nga takimet përfundoi me nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi. Ndërsa për këto aktivitete nuk janë përgatitur broshura të veçanta, ato janë përfshirë në buletinin mujor, ku pasqyrohen informacionet mbi takimet, marrëveshjet, sesionet informuese dhe takimet zyrtare. Buletini është i aksesueshëm në faqen zyrtare: https://ild.al/sq/buletini/. Për më tepër, janë thjeshtuar disa rubrika kërkimi në faqen zyrtare, duke lehtësuar aksesin dhe shfaqjen e rezultateve të dëshiruara.
5.1.10	<i>Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi mjetet alternative të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> DHKND, DNJF <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
5.1.11	<i>Informimi i publikut mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> DNJF, MD <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u>

	Gjatë vitit 2024, janë mundësuar materiale informuese dhe manuale nga organizata ndërkombëtare, si: • Manuali “Hoë to Get Legal Aid” – OSBE • Manuali udhëzues për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore mbi mënyrën e komunikimit dhe pritjes së qytetarëve të kategorive vulnerabël – OSBE • Manuali “Si të përfitojmë ndihmë juridike” në gjuhën Braille – OSBE Në zbatim të Kalendarit Vjetor 2024, Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore kanë organizuar aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere në 51 bashki të vogla. Për bashkitë ku nuk u realizuan aktivitete, ato janë përfshirë në Kalendarin Vjetor të vitit 2025. Shifra kryesore për vitin 2024: • 642 aktivitete informuese/ndërgjegjësuere të zhvilluara • 205 aktivitete me fokus kategoritë e veçanta të përfituesve DNJF ka hartuar një analizë për përmirësimin e ndërgjegjësimit mbi sistemin e ndihmës juridike, e cila është dorëzuar pranë KLSH dhe Ministrisë së Drejtësisë (shkresa nr. 155/1 prot., datë 15.01.2024). Kjo analizë synon të udhëzojë konceptimin e Kalendarit Vjetor të Aktiviteteve, duke theksuar: • Fokusin tek kategoritë më pak të përfaqësuara në ndihmën juridike • Shtrirjen e aktiviteteve në të gjitha bashkitë përbërëse të qarqeve, p.sh., Qendra e Elbasanit do të zhvillojë sesione në Belsh, Cërrik, Gramsh, Librazhd, Peqin dhe Prrenjas Komunikimi publik: 25 intervista televizive të realizuara nga Drejtori i Përgjithshëm i DNJF dhe specialistët, në televizionet kombëtare dhe lokale.
5.1.12	<i>Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese në "Javën e Drejtësisë". (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD, KLGJ, KLP, ILD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> MD në kuadër të "Javës së Drejtësisë dhe të Drejtave të Njeriut", më 8 dhjetor, u organizua një aktivitet me rastin e Ditës së Rinisë në Sheshin Skënderbej. Gjatë këtij aktiviteti, u shpërndanë 100 libra dhe 200 kode QR për të informuar qytetarët mbi rëndësinë e të drejtave të njeriut dhe proceset integruere me Bashkimin Evropian. Më 10 dhjetor 2024 u zhvillua takim në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, i kryesuar nga Ministri dhe Zëvendësministri i Drejtësisë ku morën pjesë 45 studentë nga universitete private. Qëllimi kryesor ishte ndërgjegjësimi mbi procesin e integritetit, garantimi i të drejtave procedurale dhe rëndësia e forcimit të sundimit të ligjit. Gjithashtu u shfaqën gjashtë video edukuese të Rule of Laë. Ky takim ishte një mundësi e shkëlqyer për të thelluar bashkëpunimin dhe për të shkëmbyer mendime mbi sfidat dhe përparimet që Shqipëria ka bërë në fushën e drejtësisë dhe të drejtave themelore, si dhe për të diskutuar mënyrat për të përmirësuar shërbimet ligjore për qytetarët. Më 10 Dhjetor 2024, në Ministrinë e Drejtësisë, u vendos një stendë edukative për të drejtat themelore të njeriut. Stenda u mbështet nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Projektve në Fushën e Drejtësisë dhe Negociatave, si dhe përfaqësues të institucioneve si Drejtoria e Burgjeve, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve dhe Ndihma Juridike. Përgjatë gjithë ditës, stenda ofroi 200 broshura me kode QR për ndërgjegjësimin dhe procesin e integritetit, si dhe shpërndau 50 libra për të rinjtë të moshave 9-11 vjeç dhe 50 libra për moshën 12- 16 vjeç si dhe për informimin e vizitorëve. Pjesëmarrësit, mbi 100 persona, u informuan mbi rëndësinë e të drejtave themelore dhe angazhimet e Shqipërisë në fushën e integritetit evropian. Në datën 12.12.2024, në Fakultetin Ekonomik u zhvillua një leksion i rëndësishëm mbi procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ku u diskutuan sfidat dhe mundësitë që përballet

	vendi në këtë rrugëtim. Gjatë leksionit, u theksua rëndësia e reformave të brendshme dhe bashkëpunimit rajonal për përshejtimin e këtij procesi, si dhe ndikimi i faktorëve ndërkombëtarë. Po ashtu, pjesë e diskutimit ishte edhe "Java e Integritetit", ku u analizua roli i etikës dhe transparencës në institucionet publike si elemente kyçe për arritjen e standardeve të kërkuara nga BE. Më datë 13.12.2024 në ambientet e Rogner Hotel u zhvillua një takim i rëndësishëm organizuar nga Drejtoria e Integritetit dhe Negociatave në Ministrinë e Drejtësisë drejtuar nga Ministri i Drejtësisë, Z. Ulsi Manja dhe pjesëmarrjen e shumë prej krerëve të institucioneve të cilat janë pjesë e grupit të punës për Kapitullin 23 dhe Funksionimin e Institucioneve Demokratike. Ministri i Drejtësisë, Z. Manja, theksoi në këtë takim rëndësinë e procesit të negociatave duke falenderuar dhe ftuar serish institucionet të vijnë me bashkëpunimin e frytshëm për të çuar përpara procesin. Pjesëmarrës në takim ishte dhe z. Andre Rizzo, përfaqësues i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, i cili mbajti fjalimin e tij përshëndetës duke përgëzuar Shqipërinë për punën e mirë dhe njëkohësisht duke inkurajuar të vijonim në të njëjtat ritme. Gjatë takimit u paraqit një prezantim i shkurtër i asaj çfarë pritet prej këtij procesi duke përfshirë analiza, afate, disa rekomandime dhe sqarime për vijimësinë. Në datën 12.12.2024 u zhvillua Java e Integritetit në Universitetin "Epoka" - Zevendesministri i Drejtësisë, z. Tedi Dobi, diskutoi me studentët në një leksion hapur mbi kuptimin e gjerë të konceptit "integritet" si domosdoshmëri institucionale dhe personale për të vendosur të mirën e përbashkët në qendër. Gjatë takimit, z. Dobi diskutoi impaktin e drejtpërdrejtë të sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit në anëtarësimin në Bashkimin Evropian . ILD raporton se është hartuar një program për Informimin, edukimin ligjor dhe sensibilizimin e qytetarëve, që zyra e ILD-së, e ka ndërmarrë bazuar në nevojën dhe të gjitha të dhënat që janë mbledhur përmes ankesave, informacioneve të tjera dhe rrugëve të informimit publik. Ky program përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për informimin, edukimin ligjor dhe sensibilizimin e qytetarëve, bazuar në objektin e veprimtarisë së ILD, por edhe rekomandimeve dhe Rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë. Këto takime do të zhvillohen në të gjitha vendin, me nxënës (gjimnazistë) të shkollave të ndryshme studentët e drejtësisë, shoqatat e ndryshme që mbrojnë të Drejtat e Njeriut, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, zyrat lokale të Avokatit të Popullit dhe mediat lokale. Pjesëmarrës të Akademisë së Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN) zhvilluan një vizitë studimore në ambientet e ILD-së, gjatë së cilës zhvilluan një bashkëbisedim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani, në kuadër të modulit "Shteti i së drejtës". Të angazhuar në administratën publike, institucione jo publike, organizata jo qeveritare, nga radhët e juristëve e medias, pjesëmarrësit e kësaj akademie u njohën nga z. Metani me rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe sfidat e institucionit, si pjesë e rëndësishme e strukturës së re të krijuar nga reforma në drejtësi e më tej, të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Janë planifikuar 3 takime në shkollat e mesme të vendit për informim rreth ILD, kompetencave, objektin e veprimtarisë, afatet e ankesave, trajtimin e tyre, llojin dhe mënyrën e ankesës, rrugët si mund të ankoresh në ILD, etj KLJGJ raporton se në datën 10 Maj 2024, dy KLJGJ dhe KLP zhvilluan mbledhjen e përbashkët vjetore në përbashkësi të detyrimit ligjor përcaktuar nga neni 170 i Ligjit 115/2016 " Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Kjo mbledhje, e cila u mbështet nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Projekti EU4Justice, u mbajt në Ditën e Drejtësisë. Në këtë takim u prezantua Rregullorja për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje. Rregullore kjo e cila është rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm mes dy Këshillave, me kontributin e rëndësishëm të ekspertëve ndërkombëtar. Në bazë të informacioneve të përcjella nga gjykatat për periudhën raportuese, rezulton se 6 prej gjykatave kanë raportuar mbi zhvillimin e aktiviteve në kuadër të Javës së Drejtësisë. KLP raporton se nuk ka zhvillime për këtë periudhë.
5.1.13	<i>Planifikimi dhe organizimi i takimeve në ditë të vecanta për sistemin e Drejtësisë dhe të drejtave të njeriut (Dita e Drejtësisë, Dita e të Drejtave të Njeriut). (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, KLJGJ, KLP, ILD, GJK

Informacion mbi zbatimin e masës:

ILD është përgatitur një plan për edukimin ligjor që ka për qëllim të informojë dhe të njohë qytetarët me kompetencat që ushtron ILD. Ky program siguron planifikimin, vlerësimin e zbatimit, si dhe ndryshimin apo përmirësimin e përmbajtjes së aktiviteteve konkrete, të cilat do të ndiqen nga ana e institucionit në kuadër të edukimit, informimit dhe sensibilizimit të qytetarëve. Përmes këtij programi synohet të përcillet informacion tek të gjitha kategoritë, që mendojnë se ILD është një mundësi për ta, për pretendimet që ata kanë për magjistratë të ndryshëm. Hetimi i ankesave në mënyrë të drejtë dhe pa cënuar pavarësinë e magjistratëve do të jetë objekti kryesor që do të shënjojë qëllimin e programit të edukimit. Këto aktivitete do të zhvillohen në disa qarqe të vendit.

Në Ditën Kombëtare të Drejtësisë, KLP në bashkëpunim me KLGJ organizoi një aktivitet me pjesëmarrjen e personaliteteve të larta të shtetit dhe drejtësisë, si dhe ambasadorë e përfaqësues të organizmave të huaja në Shqipëri.

GJK me rastin e 26 vjetorit të Kushtetutës, u realizua ditë e hapur në Gjykatën Kushtetuese me nxënësit e dy shkollave në Tiranë, për të cilët u përgatit dhe u shpërnda (me fondet e donatorëve) një doracak shpjegues i tekstit të Kushtetutës.

KLGJ në praninë e përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë, gjykatave, media dhe përfaqësues të shoqërisë civile, prezantoi më 10.05.2024 Strategjinë Kombëtare të Uljes së Numrit të Ceshtjeve në Gjykata (2024-2027). Ky takim me natyrë informuese, shërbeu si një platformë për ndarje mendimesh në bazë të problematikave që ka gjyqësori.

MD- Në 8 dhjetor, në Sheshin Skënderbej, u zhvillua një aktivitet me rastin e Ditës së Rinisë, i organizuar në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Gjatë panairit, u shpërndanë libra informues mbi Bashkimin Evropian dhe broshura me QR kod, për të ofruar mundësi më të mira informacioni për të rinjtë. Ky aktivitet theksoi rëndësinë e njohjes dhe përfshirjes aktive të rinisë në proceset integruese të Shqipërisë në BE.

Më 10 Dhjetor 2024, në Ministrinë e Drejtësisë, u vendos një stendë edukative për të drejtat themelore të njeriut. Stenda u mbështet nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Projektve në Fushën e Drejtësisë dhe Negociatave, si dhe përfaqësues të institucioneve si Drejtoria e Burgjeve, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve dhe Ndihma Juridike. Përgjatë gjithë ditës, stenda ofroi 200 broshura me kode QR për ndërgjegjësimin dhe procesin e integritetit, si dhe shpërndau 50 libra për të rinjtë të moshave 9-11 vjeç dhe 50 libra për moshën 12- 16 vjeç si dhe për informimin e vizitorëve. Pjesëmarrësit, mbi 100 persona, u informuan mbi rëndësinë e të drejtave themelore dhe angazhimet e Shqipërisë në fushën e integritetit evropian.

Më 10 dhjetor 2024 u zhvillua takim në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, i kryesuar nga Ministri dhe Zëvendësministri i Drejtësisë ku morën pjesë 45 studentë nga universitete private. Qëllimi kryesor ishte ndërgjegjësimi mbi procesin e integritetit, garantimi i të drejtave procedurale dhe rëndësia e forcimit të sundimit të ligjit. Gjithashtu u shfaqën gjashtë video edukuese të Rule of Laë.

Ky takim ishte një mundësi e shkëlqyer për të thelluar bashkëpunimin dhe për të shkëmbyer mendime mbi sfidat dhe përparimet që Shqipëria ka bërë në fushën e drejtësisë dhe të drejtave themelore, si dhe për të diskutuar mënyrat për të përmirësuar shërbimet ligjore për qytetarët

Në datën 12.12.2024, në Fakultetin Ekonomik u zhvillua një leksion i rëndësishëm mbi procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ku u diskutuan sfidat dhe mundësitë që përballet vendi në këtë rrugëtim. Gjatë leksionit, u theksua rëndësia e reformave të brendshme dhe bashkëpunimit rajonal për përsheptimin e këtij procesi, si dhe ndikimi i faktorëve ndërkombëtarë. Po ashtu, pjesë e diskutimit ishte edhe "Java e Integritetit", ku u analizua roli i etikës dhe transparencës në institucionet publike si elemente kyçe për arritjen e standardeve të kërkuara nga BE.


Në 8 dhjetor, në Sheshin Skënderbej, u zhvillua një aktivitet me rastin e Ditës së Rinisë, i organizuar në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Gjatë panairit, u shpërndanë libra informues mbi Bashkimin Evropian dhe broshura me QR kod, për të ofruar mundësi më të mira informacioni për të rinjtë. Ky aktivitet theksoi rëndësinë e njohjes dhe përfshirjes aktive të rinisë në proceset integruese të Shqipërisë në BE.

Për OS 5.1 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***Numri i sesioneve të informimit mbi sistemin e drejtësisë (çdo vit)***

Ky tregues ka si qëllim të masë numrin total të sesioneve informuese të mbajtura mbi sistemin e drejtësisë gjatë një viti të caktuar nga institucionet e Drejtësisë, duke përfshirë aktivitete edukative, trajnime, takime me komunitetin dhe fushata ndërgjegjëse. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e përpjekjeve për të rritur transparencën, aksesin në drejtësi dhe ndërgjegjësimin publik mbi të drejtat dhe procedurat ligjore.

Gjatë vitit të raportuar, institucionet e drejtësisë kanë mbajtur gjithsej tetë sesione informuese mbi sistemin e drejtësisë. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka organizuar dy sesione informuese, ndërsa Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet të tillë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka realizuar gjashtë sesione informuese, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e ndërgjegjësitë publik mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë.



Objektivi Specifik 5.2.

Plani i Veprimit për Objektivin 5.2 parashikon 7 masa, prej të cilave **2 masa janë zbatuar plotësisht** dhe **1 masë është zbatuar pjesërisht** dhe 4 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 66.7% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht

Objektivi specifik 5.2: Forcimi i bashkëpunimit efektiv të institucioneve të sistemit të drejtësisë për realizimin e ELP dhe rritja e aksesit të qytetarëve në informacionin mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë

Zhvillimi i fushatave të përbashkëta të institucioneve të drejtësisë mbi ELP. (pz. 2025-2030)

Institucioni raportues: MD

Informacion mbi zbatimin e masës:

Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.

Fushata ndërgjegjëse dhe edukuese për publikun mbi legjislacionin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. (pz. 2024-2030)

Institucioni raportues: KDIMDP

Informacion mbi zbatimin e masës:

Zyra e Komisionerit, ka hartuar Raportin Vjetor Monitorues për vitin 2023 “Mbi marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust, në lidhje me zbatimin e detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale”, drejtuar Eurojust, ku reflektohet gjendja aktuale lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, masat e marra dhe strategjitë e përdorura në mbështetje të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin e sigurisë, mbrojtjen dhe privatësinë e të dhënave të përpunuara gjatë veprimtarisë së organeve hetimore. Në zbatim të marrëveshjes së Republikës së Shqipërisë me Eurojust, Zyra e Komisionerit ka hartuar 5 Raporte Monitoruese për kontrolluesit:

- Prokuroria e Përgjithshme;
- Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë;
- Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan;
- Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm, Lezhë;
- Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).

Zyra e Komisionerit është përgjegjëse për verifikimin e përpunimit të të dhënave personale të pasagjerëve, në përputhje me Udhëzimin e përbashkët nr. 464 “Për transmetimin e të dhënave të pasagjerit të Njësia e Informacionit të Pasagjerit”. Ky udhëzim përcakton procedurat dhe rregullat për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, duke synuar një balancimin mes nevojave të sigurisë së të dhënave dhe mbrojtjes së privatësisë. Në zbatim të detyrimeve ligjore, Zyra e Komisionerit ka hartuar një Raport Vlerësimi pranë Njesisë së Informacionit të Pasagjerit (NIP), në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, mbi zbatimin dhe respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të përpunimit të të dhënave të pasagjerëve PNR/API.

5.2.2

Gjithashtu, u zhvillua aktiviteti ndërgjegjëses me Prokurorinë e Përgjithshme, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) në kuadër të veprimtarisë së sistemit të Prokurorisë mbi mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të shkëmbimit të informacionit për qëllime të hetimit dhe ndjekjes penale. (Për më shumë rreth këtij aktiviteti, lutem klikoni linkun: <https://idp.al/2024/11/04/garantimi-i-mbrojtjes-se-te-dhenave-personale-ne-veprimtarine-e-prokurorise-dhe-bashkepunimi-me-eurojust/>).

Në kuadër të projektit të binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me acquis-in e Bashkimit Evropian” si pjesë e Komponentit 3 të tij, me qëllim ndërgjegjësimin e kontrolluesve/përpunuesve publik e privat dhe grupeve të interesit mbi përmbajtjen e legjislacionit të ri të fushës, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar trajnime me institucionet ligjzbatuese. Në këto trajnime kanë qënë pjesëmarrës mbi 60 zyrtarë nga Prokuroria, Policia e Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ku u prezantuan përfshirja e Direktivës së Policisë në legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, me miratimin e Ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili përafron plotësisht acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushë si: Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe Direktivën për përpunimin e të dhënave personale nga organet ligjzbatuese (Direktiva e Policisë), Zyra e Komisionerit ka planifikuar zhvillimin e aktiviteteve të posaçme ndërgjegjëse me organet ligjzbatuese me qëllim prezantimin e tyre me risitë që sjell Direktiva e Policisë.

- Zyra e Komisionerit dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA) bashkëorganizuan Konferencën VI Kombëtare për të Drejtën e Informimit me tematikë kryesore “Ndërtimi i besimit: Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit”.

- Zyra e Komisionerit zhvilloi trajnimin online mbi “Të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit dhe Regjistrin Elektronik për kërkesat dhe përgjigjet”. Në këtë trajnim, me pjesëmarrjen e koordinatorëve për të drejtën e informimit nga institucione qendrore e të varësisë apo të njësive të vetëqeverisjes vendore, vëmendje ju kushtua edhe përdorimit të portalit “pyetshtetin.al” dhe regjistrin elektronik për kërkesat dhe përgjigjet për të drejtën e informimit (REKPD) të instaluar në të.

	• Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në Ministrinë e Financave zhvilluan një modul trajnimi 2-ditor. Në këtë aktivitet morën pjesë më shumë se 70 nëpunës të nivele dhe strukturave të ndryshme qendrore dhe vendore të këtyre institucioneve. • Me rastin e 28 Shtatorit, Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit, Zyra e Komisionerit zhvilloi në mjediset e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil një aktivitet informues e ndërgjegjëses. • Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve me rastin e 28 Shtatorit, Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit, Zyra e Komisionerit zhvilloi takime me nxënës e mësues të arsimit 9-vjeçar publik e privat, me moton “Mos ki ndrojtje të pyesësh”.. Stafi i Zyrës së Komisionerit ishte në shkollat 9-vjeçare “E Kuqe” dhe “Indipendent”, ku ndau me të pranishmit njohuri dhe këshilla praktike, si pjesë e angazhimit konstant të institucionit në bashkëpunimin e tij me strukturat arsimore të vendit. • Gjatë vitit 2024, u zhvilluan një seri trajnimesh online me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe personat e kontaktit për të dhënat e hapura nga të gjitha autoritetet publike qendrore dhe të strukturave të varësisë, të organeve të vetëqeverisjes vendore, institucioneve të pavarura, atyre të sistemit të drejtësisë (gjykata dhe prokurori), të shoqërive/kompanive me kapital publik, etj. Trajnimet u fokusuan në tre elemente kryesore: përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit lidhur me aksesin në informacionin publik dhe publikimin/përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve; Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve nëpërmjet portalit pyetshtetin.al, instalimi/përditësimi i tij në autoritete publike të reja apo ku ka patur ndryshim të koordinatorit, si dhe mbi përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit lidhur me të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik. • Shkolla “Transparenca dhe Qeverisja e Hapur 2024” është një program i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, që ka në fokus jo vetëm njohjen me kuadrin ligjor kombëtar por edhe zbatimin e tij në praktikë nga profesionistët e së ardhmes. Në kuadër të bashkëpunimit, Zyra e Komisionerit një grup studentësh pjesëmarrës në këtë Shkollë, ishin të pranishëm gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore me autoritete publike. Njëkohësisht, ata u njohën edhe me kuadrin ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, procesin e modernizimit të tij dhe me trajtimin e rasteve konkrete. • Në mjediset e Zyrës së Komisionerit u zhvillua takimi me një grup studentësh të programit Gazetari-Komunikim të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në këtë aktivitet, të zhvilluar në formën e një bashkëbisedimi të lirë, u prezantua një panoramë të legjislacionit të të drejtës për informim, lidhur me rolin, funksionet dhe veprimtarinë e institucionit në këtë fushë, si dhe mbi trajtimin e rasteve nga praktika.
5.2.3	<i>Koordinimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta të institucioneve të drejtësisë me OSHC-të dhe grupet e interesit me qëllim forcimin e bashkëpunimit për rritjen e informimit të qytetarëve mbi sistemin e drejtësisë. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD, KLGJ</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
5.2.4	<i>Forcimi i bashkëpunimit me Fakultetet e Drejtësisë për ofrimin e ELP. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: KLGJ, ILD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> ILD raporton se është firmosur marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës. Kjo lidhet me një ndër përparësitë që ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të publikut mbi misionin e veprimtarisë së ILD-së. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut është premisë për krijimin e lehtësirave në minimizimin e fluksit të ankesave, të cilat janë jashtë objektivit të veprimtarisë, apo janë të papranueshme për shkak të mos përmbushjes së kriterëve ligjore. Janë zhvilluar 2 takime përgjatë vitit 2024 me studentët e fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës, si dhe me studentët e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Prishtinës.

	Ndërkohë, në dhjetor 2024, Kryetari i KLGJ priti studentë nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, duke i informuar mbi hapat e ndërmarra në kuadër të Reformës në Drejtësi, si dhe mbi sfidat dhe prioritetet për forcimin e një gjyqësori të pavarur dhe të besueshëm.
5.2.5	<i>Rritja e Bashkëpunimit me Median për të Promovuar Ndërgjegjësimin Ligjor mbi sistemin e drejtësisë. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> MD, KLGJ, KLP, GJK, PP, SHM <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
5.2.6	<i>Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të institucioneve publike (nivel qendror e vendor) lidhur me zbatimin e ELP. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> ASPA <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
5.2.7	<i>Forcimi i Komunikimit dhe Transparencës për të Rritur Mirëkuptimin dhe Besimin e Publikut në Reformën në Drejtësi dhe sistemin e drejtësisë. (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues:</u> KLGJ, KLP, GJK, SPAK, MD <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Prokuroria e Posaçme, përmes Koordinatorit për Marrëdhënien me Median, iu përgjigjet kërkesave për informacion nga qytetarët, gazetarët, media dhe shoqëria civile. Gjithashtu, organizon takime periodike midis Drejtuesit të Prokurorisë dhe gazetarëve. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve për informacion mbahet në mënyrë të rregullt dhe publikohet çdo muaj në faqen zyrtare të institucionit. Në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme është i disponueshëm Programi i Transparencës, i cili përditësohet rregullisht me informacion mbi veprimtarinë publike të SPAK, duke garantuar aksesin e qytetarëve në drejtësi dhe rritjen e besimit në institucion. Strategjia e komunikimit përfshin protokollin e menaxhimit të krizave dhe strategjinë për mediat sociale, duke siguruar një nivel të lartë transparence dhe përgjegjshmërie. Objektivi kryesor i kësaj strategjie është forcimi i transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. KLGJ ka vijuar punën për monitorimin periodik të zbatimit të "Planit të Komunikimit për Gjykatat", të miratuar me anë të vendimit nr. 454 datë 02.11.2022. KLGJ ka kryer monitorimin periodik të zbatimit të këtij plani nga ana e gjykatave, të cilat në mbështetje të pikës 3 të vendimit të sipërcituar, pika e kontaktit për secilën gjykatë respektive ka dërguar raportet duke ndjekur veprime konkrete për realizimin e 6 objektivave strategjike të parashikuara në këtë Plan. Gjithashtu, vijon edhe zbatimi i vendimit Nr. 716, Datë 06.12.2023 "Udhëzuesi Standard i Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median", i cili synon rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore, nëpërmjet standardizimit të marrëdhënieve të gjykatës me publikun dhe median. GJK ri-konceptoi faqen e saj zyrtare të internetit, organizoi tryeza të rrumbullakëta me përfaqësuesit e medias, si dhe seminare trajnuese për stafin e saj, me fokus forcimin e komunikimit dhe transparencës institucionale, me fondet e donatorëve. KLP ka një program transparence të miratuar përpara periudhës së raportimit, i cili përditësohet në mënyrë periodike me informacione të reja (linku https://klp.al/ep-content/uploads/2024/07/Programi_i_transparences.1-1.html). Vendimet janë të gjitha të publikuara

në faqen ëeb, pas çdo mbledhje plenare, sipas parashikimeve ligjore ([linku https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/](https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/)). Sa i përket menaxhimit të stafit, një rubrikë prezanton secilin prej tyre ([linku https://klp.al/stafi-yne/](https://klp.al/stafi-yne/)) dhe për rekrutimin ([linku https://klp.al/category/vende-vakante-ne-shërbimin-civil/](https://klp.al/category/vende-vakante-ne-shërbimin-civil/)), informacione të cilat përditësohen rast pas rasti. Bazuar në Ligjin Nr.33/20 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit të sektorit publik", në kuadër të transparencës KLP ka publikuar listën e informacioneve që përdoren si burime të hapura ([linku: https://klp.al/2024/10/15/lista-e-informacioneve-qe-perdoret-si-burime-te-hapura/](https://klp.al/2024/10/15/lista-e-informacioneve-qe-perdoret-si-burime-te-hapura/)) . Më datë 12.11.2024, KLP, në bashkëpunim me programin EU4Justice, organizoi "Forum in e Medias", ku u diskutua mbi standardet mediatike të rekomanduara nga BE-ja dhe problematikave që shfaq rregullorja "Për komunikimin me mediat". Ky forum synoi përmirësimin e standardeve të komunikimit në drejtësi. Në kuadër të transparencës dhe komunikimit, KLP vlerësoi rekomandimet e gazetarëve dhe ekspertëve, dhe në mbledhjen e datës 10.12.2024, diskutoi mbi shfuqizimin e rregullores për mediat, me synim draftimin e një rregulloreje të re. Këshilli vendosi që anëtarë për komunikimin me median të shqyrtojnë kuadrin ligjor mbi Rregulloren dhe në një mbledhje të ardhshme të relatojë për shfuqizimin ose jo të saj.

Për OS 5.2 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***Numri i fushatave mediatike mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë (çdo vit)***

Objektivi i këtij treguesi është të masë numrin total të fushatave mediatike të realizuara mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë gjatë një viti të caktuar. Ky tregues synon të vlerësojë përpjekjet për ndërgjegjësimin publik dhe promovimin e transparencës në drejtësi përmes mediave tradicionale dhe digjitale. Fushatat mediatike mund të përfshijnë reklama televizive, radiofonike, publikime në rrjete sociale, artikuj në media të shkruara, video edukative, si dhe fushata të tjera ndërgjegjësuere. Qëllimi është të sigurohet informimi i gjerë i qytetarëve mbi të drejtat e tyre ligjore, procedurat gjyqësore dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka zhvilluar dy fushata mediatike, duke kontribuar në promovimin e transparencës dhe ndërgjegjësimin publik. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) nuk ka realizuar asnjë fushatë mediatike për vitin 2024. Ndërkohë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka organizuar 54 aktivitete që lidhen me edukimin ligjor të publikut (ELP). Këto takime janë zhvilluar në formën e leksioneve të hapura, njoftimeve në rrjetet sociale, takime fizike me grupe të ndryshme interesi. Nuk kanë munguar edhe marrëveshjet zyrtare në kuadër të edukimit ligjor.

Objektivi Specifik 5.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 5.3 parashikon 4 masa, prej të cilave **1 masë është zbatuar plotësisht, 1 masë nuk është zbatuar** dhe 2 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 50% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht

Objektivi specifik 5.3: Rritja e njohurive dhe kuptueshmërisë së publikut mbi proceset e integritit evropian përmes iniciativave të edukimit ligjor të publikut

5.3.1	<i>Rritja e ndërgjegjësimi mbi proceset e integrimit evropian përmes iniciativave të edukimit ligjor të publikut . (pz. 2024-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Faqja e Instagramit të Ministrisë së Drejtësisë vazhdimisht poston përmbajtje të ndryshme, si video ilustruese, foto dhe dokumenta, që ofrojnë informacion të qartë dhe të kuptueshëm për proceset e integrimit evropian. Këto postime janë një mjet efektiv për të angazhuar qytetarët dhe për t'i mbajtur ata të informuar mbi hapat e nevojshëm dhe përfitimet e këtij procesi. Përmes kësaj fushate në rrjetet sociale, Ministria e Drejtësisë kontribuon në ndihmën për krijimin e një publikimi të informuar dhe aktiv mbi rëndësinë e integrimit evropian. Më 10 Dhjetor 2024, Ministria e Drejtësisë, vendosi një stendë edukative në bulevardin Zogu I për të drejtat themelore të njeriut. Stenda u mbështet nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Projektve në Fushën e Drejtësisë dhe Negociatave, si dhe përfaqësues të institucioneve si Drejtoria e Burgjeve, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve dhe Ndihma Juridike. Përgjatë gjithë ditës, stenda ofroi 200 broshura me kode QR për ndërgjegjësimin dhe procesin e integrimit, si dhe shpërndau 50 libra për të rinjtë të moshave 9-11 vjeç dhe 50 libra për moshën 12- 16 vjeç si dhe për informimin e vizitorëve. Pjesëmarrësit, mbi 100 persona, u informuan mbi rëndësinë e të drejtave themelore dhe angazhimet e Shqipërisë në fushën e integrimit evropian. Punonjësit e Drejtësisë së Integrimit dhe Negociatave zhvilluan një kurs ëbëinar për informimin mbi procesin e integrimit evropian, i orientuar ndaj punonjësve të administratës shtetërore. Ky kurs, i organizuar nga ASPA, synoi të rrisë njohuritë dhe kapacitetet e administratës në lidhje me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian. Ndërkohë në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional, në date 13.12.2024 u zhvillua një takim me krerët e institucioneve për prezantimin e piketave të ndërmjetme. Më datë 13.12.2024 në ambientet e Rogner Hotel u zhvillua një takim i rëndësishëm organizuar nga Drejtoria e Integrimit dhe Negociatave në Ministrinë e Drejtësisë drejtuar nga Ministri i Drejtësisë, Z. Ulsi Manja dhe pjesëmarrjen e shumë prej krerëve të institucioneve të cilat janë pjesë e grupit të punës për Kapitullin 23 dhe Funksionimin e Institucioneve Demokratike. Ministri i Drejtësisë, Z. Manja, theksoi në këtë takim rëndësinë e procesit të negociatave duke falenderuar dhe ftuar serish institucionet të vijnë me bashkëpunimin e frytshëm për të çuar përpara procesin. Pjesëmarrës në takim ishte dhe z. Andre Rizzo, përfaqësues i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, i cili mbajti fjalimin e tij përshëndetës duke përgëzuar Shqipërinë për punën e mirë dhe njëkohësisht duke inkurajuar të vijonim në të njëjtat ritme. Gjatë takimit u paraqit një prezantim i shkurtër i asaj çfarë pritet prej këtij procesi duke përfshirë analiza, afate, disa rekomandime dhe sqarime për vijimësinë.
5.3.2	<i>Integrimi i njohurive mbi ligjet dhe politikat e Bashkimit Evropian në kurrikulat kombëtare të arsimit. (pz. 2026-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MAS</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
5.3.3	<i>Organizimi i aktiviteteve informuese në Ditën e Europës. (pz. 2025-2030)</i> <u>Institucioni raportues: MD</u> <u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Masa do të fillojë zbatimin në periudhën e përcaktuar të zbatimit.
5.3.4	<i>Aktivitete informuese dhe zhvillimi i programeve edukative mbi integrimin evropian në shkollat e arsimit bazë, të mesëm, dhe të lartë. (pz. 2024-2030)</i>

Institucioni raportues: MD

Informacion mbi zbatimin e masës:

Më 12 dhjetor 2024, në Fakultetin Ekonomik u zhvillua një leksion mbi procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), duke analizuar sfidat dhe mundësitë që ky rrugëtim sjell për vendin. Diskutimi u përqendrua në rëndësinë e reformave të brendshme, bashkëpunimit rajonal dhe ndikimit të faktorëve ndërkombëtarë, si elementë kyç për përshtetimin e procesit.

Në kuadër të "Javës së Integritetit", pjesëmarrësit analizuan rolin e etikës dhe transparencës në institucionet publike, si parakushte të domosdoshme për përmbushjen e standardeve të kërkuara nga BE.

Si pjesë e angazhimit për edukimin e të rinjve mbi demokracinë dhe shtetin e së drejtës, janë përgatitur materiale informuese dhe ndërgjegjësuere në formën e librave ilustrativë, me titull "Demokracia dhe Shteti i së Drejtës për të rinjtë në BE", të përshtatur për dy grupmosha:

📖 9-11 vjeç

📖 12-16 vjeç

Gjithashtu, për të përhapur më gjerësisht informacionin mbi integrimin evropian, janë shpërndarë broshura me kode QR, duke përdorur teknologjinë si një mjet inovativ për të angazhuar qytetarët. Me anë të këtyre kodeve, qytetarët mund të skanojnë dhe të marrin qasje në informacion të detajuar mbi BE-në, reformat e nevojshme dhe përfitimet e procesit të anëtarësimit.

Ky program synon të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi rëndësinë e reformave dhe rolin e secilit individ në përmbushjen e kriterëve për anëtarësimin në BE.

Për OS 5.3 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***Numri i sesioneve të informimit mbi procesin e integritetit në BE***

Objektivi i këtij treguesi është të masë numrin total të sesioneve të informimit mbi procesin e integritetit në Bashkimin Evropian (BE) gjatë një viti të caktuar. Këto sesione përfshijnë informacione mbi Kapitullin 23 të negociatave për anëtarësim, që trajton gjyqësorin dhe të drejtat themelore, si dhe mbi Udhërrëfyesin për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit. Gjithashtu, sesionet synojnë të rrisin ndërgjegjësimin mbi të drejtat dhe liritë themelore, si dhe të promovojnë kuptimin e Funksionimit të Drejtësisë dhe Institucioneve (FDI). Përmes këtyre aktiviteteve, synohet të forcohet transparenca e procesit të integritetit dhe të informohen qytetarët për ndikimin dhe përfitimet që ky proces sjell për ta.

Gjatë vitit të raportuar, Ministria e Drejtësisë realizoi katër sesione informuese mbi procesin e integritetit në BE, në përputhje me objektivin e treguesit. Aktivitetet përfshijnë: postime të vazhdueshme në Instagram me përmbajtje edukative mbi Kapitullin 23 dhe të drejtat themelore; një stendë edukative, ku u shpërndanë mbi materiale informuese për fëmijët dhe të rinjtë; një ëëbinar për administratën publike mbi standardet e BE-së, i organizuar nga ASPA; si dhe një takim ndër-institucional më 13 dhjetor 2024. Këto aktivitete kontribuan ndjeshëm në informimin dhe ndërgjegjësimin publik mbi procesin e integritetit evropian dhe angazhimet e Shqipërisë në këtë drejtim.

➤ ***Numri i nxënësve të informuar mbi procesin e integritetit në BE***

Objektivi i këtij treguesi është të masë numrin total të nxënësve të informuar mbi procesin e integritetit në Bashkimin Evropian gjatë një viti të caktuar. Ministria e Drejtësisë, duke qenë se është institucioni përgjegjës për drejtësinë dhe normat ligjore, ndër-merr iniciativën për informimin e gjeneratës së re mbi procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, duke

promovuar ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive të tyre.

Në vitin e caktuar, 100 nxënës janë informuar mbi procesin e integritetit në Bashkimin Evropian. Ky raport tregon se aktivitetet edukative, të organizuara nga institucione si Ministria e Drejtësisë, kanë arritur të përfshijnë këtë numër të konsiderueshëm nxënësish, duke nxitur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive të tyre në një proces me rëndësi të madhe për të ardhmen e vendit.

IV. RISKU DHE HAPAT NË VIJIM

4.1 Pasqyrë e Përgjithshme

Në këtë kapitull përcakohen parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në raportin e monitorimit, metodën që përdoret për identifikimin, analizën, vlerësimin, trajtimin, raportimin e risqeve kryesore që rrezikojnë realizimin e objektivave, me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Risqet në lidhje me zbatimin e përgjithshëm të strategjisë do të duhet të analizohet në vijimësi ku janë evidentuar faktorët kryesor të cilat kryesisht lidhen me aftësinë institucionale, aftësinë financiare, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin nga institucionet e tjera dhe faktorët e tjerë të jashtëm të strategjisë.

Vlerësimi i riskut është kryer për objektivat tek të cilët është identifikuar risk i ulët, i mesëm ose i lartë referuar masave përkatëse dhe treguesve dhe në përputhje me analizën e riskut të përcjellë prej institucioneve përgjegjëse ose në mungesë të saj, të vlerësimit që vetë stafi i ka bërë riskut në përputhje me të dhënat e mbledhura.

Kapitulli IV i këtij Raporti paraqet një analizë mbi të gjitha masat e përfshira në Planin e Veprimit të cilat duhet të zbatohen në vitin 2024. Raporti vlerëson gjithashtu nivelin e zbatueshmërisë së treguesve të lidhura me Qëllimet Politike përkatëse. Disa masa dhe tregues të cilat nuk janë zbatuar ose janë zbatuar pjesërisht, veçanërisht kur afati për zbatimin e tyre ka kaluar, do të konsiderohen me risk dhe duhet të parashikohen aktivitetet respektive për zvogëlimin e risqeve.

Kapitulli IV “Risqet dhe hapat në vijim” synon të japë një pasqyrë të përgjithshme mbi risqet e identifikuara bazuar në nivelin e zbatueshmërisë së masave të listuara në Planin e Veprimit dhe në nivelin e përmbushjes së indikatorëve në Pasaportën e Indikatorëve bazuar në gjetjet e Kapitullit III.

Në vijim, analiza e riskut përfshin: analizën e risqeve, nivelin e riskut, faktorët e riskut dhe

hapat e mëtejshëm të mundshëm për të adresuar këto risqe dhe për të zbatuar me sukses masat dhe përmbushur indikatorët.

Risqet mund të lindin si pasojë e vonesave në zbatim referuar afatit të parashikuar në Planin e Veprimit si dhe në rastet e zbatimit të pjesshëm të cilat kërkojnë vëmendjen e duhur me qëllim zbatimin e suksesshëm.

4.2 Vlerësimi i riskut

Risqet e identifikuar në raportin vjetor të monitorimit për vitin 2024 janë shqyrtuar me kujdes dhe disa prej tyre konsiderohen ende të pa tejkaluara. Ato janë përfshirë në tabelën e mëposhtme me shënimin e qartë se nga cila periudhë ekziston/jnë, risku/risqet.

4.2.1 Qëllimi i Parë i Politikës

Risqet e evidentuara në Qëllimin e Parë të Politikës lidhen kryesisht me zbatimin e masave specifike. Në kuadër të riskut që shoqëron Objektivin Specifik 1.1 – Përditësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi në përputhje me parimet e pavarësisë, llogaridhënies, efikasitetit dhe cilësisë, si dhe sigurimin e harmonizimit të tij me acquis të BE-së, fokusi vendoset te zbatimi i Indikatorit 1: Norma (%) e zbatimit të rekomandimeve të raporteve analitike të institucioneve mbi problematikat e zbatimit të ligjeve të reformës në drejtësi dhe masave përkatëse, si:

Masa 1.1.9 – Avancimi i reformës nëpërmjet ndryshimeve ligjore, duke siguruar vijueshmërinë e rezultateve pozitive të procesit të verifikimit dhe forcimin e rregullave për kontrollin e pasurive dhe figurës së aktorëve të sistemit të drejtësisë;

Masa 1.1.2 – Përditësimi i Kodit Penal në përputhje me acquis të BE-së;

Masa 1.1.3 – Përditësimi i Kodit të Procedurës Penale në përputhje me acquis të BE-së, si pjesë e procesit të hartimit të legjislacionit të ri penal.

<i>OS.1.1 - Përditësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi në përputhje me parimet e pavarësisë, llogaridhënies, efikasitetit, cilësisë dhe siguri i harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së.</i>	
Risku	Mungesa e koordinimit efektiv ndërmjet institucioneve të drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë mund të vonojë përditësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor të reformës. Kjo rrezikon të pengojë zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e sistemit të drejtësisë, duke ndikuar në cilësinë dhe efikasitetin e reformës.
Niveli i Riskut	I lartë
Analiza	Reforma në drejtësi ka prodhuar rezultate të rëndësishme, veçanërisht në procesin e vetting-ut dhe forcimin e integritetit të sistemit. Megjithatë, për të siguruar një reformë të qëndrueshme dhe efektive, nevojitet një përditësim i vazhdueshëm i kuadrit ligjor bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës. Aktualisht, sfida kryesore është koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse, si Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), SPAK, ILDKPKI, ILD dhe Ministria e Drejtësisë, për të identifikuar boshllëqet dhe për të propozuar ndryshimet e nevojshme ligjore.

Faktori i riskut	Mungesa e një mekanizmi të qartë për ndjekjen dhe raportimin e progresit në përditësimin e kuadrit ligjor
Masat për zvogëlimin e riskut	Përfundimi dhe publikimi i Raportit Final mbi veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) për periudhën 2017-2024 për të siguruar transparencë dhe referencë për vendimmarrjen e ardhshme. Hartimi i një studimi krahasues për ligjet kryesore që lidhen me procesin e vetting-ut dhe integritetin e aktorëve të sistemit të drejtësisë, duke identifikuar dispozitat që kërkojnë përmirësime. Organizimi i një grupi pune ndërinstytucional për hartimin e propozimeve ligjore dhe procesin e konsultimit publik. Miratimi i amendamenteve nga Kuvendi bazuar në rekomandimet e grupit të punës dhe studimeve të kryera. Monitorimi i zbatimit të amendamenteve përmes raporteve vlerësuese të rregullta për të siguruar efikasitetin e ndryshimeve të miratuara. Krijimi i një mekanizmi të rregullt raportimi mbi progresin e zbatimit të rekomandimeve, me tregues të qartë për matjen e normës së zbatimit të tyre deri në vitin 2030.

OS.1.1 - Përditësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi në përputhje me parimet e pavarësisë, llogaridhënies, efikasitetit, cilësisë dhe sigurimi i harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së.	
Risku	Procesi i hartimit të Kodit të ri Penal ka filluar në vitin 2020 dhe nuk ka përfunduar ende.
Niveli i Riskut	I lartë
Analiza	Grupi i Punës për hartimin e Kodit të ri Penal, i krijuar nga MD ka nisur me Hartimin e Kodit Penal por procesi ende nuk ka përfunduar. Procesi është i ndërlikuar dhe kërkon punë serioze profesionale. Metodologjia e punës, përvoja specifike e ekspertëve të përfshirë në proces, kërkesat dhe standardet evropiane lidhur me legjislacionin penal, etj. janë disa nga faktorët që duhen rishqyrtuar.
Faktori i riskut	Kompleksiteti i lëndës kërkon përfshirjen e ekspertëve me përvojën dhe njohuritë e duhura për të mundësuar një analizë të plotë dhe të saktë për hartimin e kodeve të rinj dhe sigurimin e harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së.
Masat për zvogëlimin e riskut	Krijimi i një mekanizmi koordinues ndërinstytucional për të siguruar një proces të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të reformës ligjore. Përfshirja e ekspertizës ndërkombëtare dhe sigurimi i mbështetjes nga donatorët për asistencë teknike. Zhvillimi i konsultimeve të gjera publike dhe me grupet e interesit për të garantuar një kuadër ligjor më efektiv dhe të zbatueshëm

Ndërkohë, për sa i përket riskut që shoqëron Objektivin Specifik 1.3 – Ruajtja dhe zhvillimi i mëtijshëm i kapacitetit profesional, pavarësisë dhe efikasitetit të organeve të qeverisjes së drejtësisë, nevojitet zbatimi i masave të mëposhtme:

Masa 1.3.1 – Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) miraton aktet nënligjore të nevojshme për përfundimin e procedurës së vlerësimit për prokurorët, duke përfshirë miratimin e rregullave mbi procedurat e vlerësimit për prokurorët e përgjithshëm dhe drejtuesit e prokurorive;

Masa 1.3.3 – Organet e qeverisjes së drejtësisë të përfshira në vettingun e anëtarëve të Këshillave ose të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, veçanërisht për anëtarët jo-magjistratë, duhet të marrin masa të vazhdueshme për forcimin e kapaciteteve në kontrollin e figurës dhe pasurisë/integritetit;

Masa 1.3.4 – Organet e qeverisjes së drejtësisë dhe subjektet e tjera të përfshira në vettingun e anëtarëve të Këshillave ose të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, veçanërisht për anëtarët jo-magjistratë, duhet të kryejnë kontrole të figurës dhe pasurisë/integritetit në përputhje me standardet e larta të vetting-ut.

Për të siguruar zbatimin efektiv të këtyre masave, është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të marrin masa të menjëhershme për të adresuar problematikat e hasura dhe për të garantuar përmbushjen e objektivave të reformës në drejtësi.

OS. 1.3. - Ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapacitetit profesional, pavarësisë dhe efikasitetit të organeve të qeverisjes së drejtësisë	
Risku	Sigurimi i integritetit më të lartë të kandidatëve për këshilltar në KLGJ dhe KLP përmes kontrollit të figurës dhe verifikimit të pasurisë.
Niveli i Riskut	I ulët
Analiza	Sigurimi i një procesi të rreptë të verifikimit të figurës dhe pasurisë për kandidatët është një element kyç për besueshmërinë e sistemit të drejtësisë. Aktualisht, ka një mungesë të standardizuar dhe të unifikuar për këtë proces midis magjistratëve dhe jo-magjistratëve. Për më tepër, ekziston një hendek ligjor në lidhje me kriteret dhe mekanizmat e kontrollit për emërimet në Këshillat e Drejtësisë.
Faktori i riskut	Mungesa e një kornize të qartë ligjore për një proces të standardizuar të verifikimit. Mospërputhje midis procedurave të kontrollit për magjistratët dhe jo-magjistratët. Afati i caktuar nga GP RA për vitin 2027, ndërkohë që kërkohet përmbushja e këtij objekti brenda vitit 2025.
Masat për zvogëlimin e riskut	Hartimi i një vlerësimi ligjor mbi nevojën për amendime në procesin e emërimit të anëtarëve jo-magjistratë të Këshillave. Harmonizimi i standardeve të verifikimit të figurës dhe pasurisë për të gjitha kategoritë e kandidatëve. Implementimi i mekanizmave të kontrollit të integritetit për të rritur besimin publik në sistemin e drejtësisë. Përsheptimi i zbatimit të këtyre masave përpara vitit 2027 për të përmbushur kërkesat e integritetit brenda vitit 2024.

4.2.2 Qëllimi i Dytë i Politikës

Risqet e evidentuara në Qëllimin e Parë të Politikës lidhen kryesisht me zbatimin e masave specifike. Në kuadër të riskut që shoqëron Objektivin Specifik 2.1. - Garantimi i emërimeve

dhe zhvillimit të karrierës së magistratëve në sistemin e drejtësisë bazuar në meritokraci, është i nevojshëm implementimi i masës 2.1.1-Këshillat plotësojnë rregullat e tyre të brendshme me qëllim emërimin dhe zhvillimin e karrierës së magistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci dhe indikatorëve: 7-Përqindja e magistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) për të cilët është përfunduar vlerësimi i rregullt etik dhe profesional nga KLGJ/KLP në përputhje me planin vjetor respektiv dhe 8-Përqindja e magistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) në sistemin e drejtësisë të vlerësuar me të paktën një vlerësim të plotë etik dhe profesional.

OS. 2.1. - Garantimi i emërimeve dhe zhvillimit të karrierës së magistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci.	
Risku	Vlerësimet etiko-profesionale të magistratëve nuk realizohen në mënyrë të plotë, sistematike dhe efektive, duke ndikuar tek numri i vlerësimeve nga këshillat dhe tek mundësia e magistratëve për tu ngritur në detyrë.
Niveli i Riskut	I lartë
Analiza	Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) kanë një rol kyç në vlerësimin e performancës dhe avancimin në karrierë të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Përmirësimi i procedurave dhe transparencës është thelbësor për një sistem të drejtësisë më të qëndrueshëm dhe efikas. Ndërmarrja nga ana e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP) e masave të cilat sigurojnë vijueshmërinë e standarteve të procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve, edhe pas përfundimit të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbetet një sfidë e cila duhet adresuar në të ardhmen. Zhvillimi i kapaciteteve të KLGJ dhe KLP, procedurat e emërimit, promovimit dhe transferimit të magistratëve duhet të kalojnë nëpërmjet sistemit të kontrolleve të integritetit përpara hyrjes në karrierën e magistraturës si dhe gjatë karrierës, si dhe kontrollit të pasurisë. Vlerësimet etiko-profesionale janë kyçe për të garantuar cilësinë e sistemit gjyqësor dhe besimin e publikut në drejtësi. Aktualisht, ka vonesa në vlerësimet periodike, mungesë metodologjish të qarta dhe mekanizmash për të siguruar ndjekjen e rekomandimeve. Standardet e vendosura nga procesi i vettingut duhet të aplikohen vazhdimisht për të garantuar një sistem drejtësie të besueshëm dhe të qëndrueshëm.
Faktori i riskut	Vonesa në kryerjen e vlerësimeve dhe mungesa e ndjekjes së rekomandimeve. Mungesa e një metodologjie të qartë dhe të unifikuar për vlerësimet etiko-profesionale. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme për vlerësim dhe verifikim të deklaratave të pasurisë dhe integritetit të magistratëve. Mungesa e ndjekjes sistematike të rasteve të mangësive etiko-profesionale.
Masat për zvogëlimin e riskut	Krijimi i një njësie të dedikuar brenda KLGJ-së dhe KLP-së për ndjekjen dhe monitorimin e vlerësimeve. Zbatimi i sanksioneve për mangësitë e konstatuara në integritetin dhe etikën profesionale të magistratëve. Përmirësimi i procedurave për verifikimin e pasurisë dhe figurës, duke inkorporuar standardet e vettingut. Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme për anëtarët e KLGJ-së dhe KLP-së për të forcuar aftësitë e tyre në vlerësimin etiko-profesional të magistratëve.

	Krijimi i një mekanizmi transparent për publikimin e rezultateve të vlerësimeve në mënyrë të përmblodhur, duke ruajtur të dhënat e ndjeshme konfidenciale.
--	--

Në kuadër të riskut që shoqëron Objektivin Specifik 2.5 – Përforcimi i mekanizmave të llogaridhënies së magjistratëve, është e nevojshme ndërmarrja e masave për zbatimin efektiv të: Masës 2.5.5 – Zbatimi dhe monitorimi i mëtejshëm i dokumenteve strategjike të KLGJ-së për hetimin administrativ të sinjalizuesve dhe trajtimin e rasteve të korrupsionit brenda këtij institucioni dhe masës 2.5.2 – Plotësimi gradual i vakancave për inspektorë në ILD, duke synuar rritjen e atraktivitetit të këtij pozicioni dhe forcimin e kapaciteteve të stafit mbështetës për të përmbushur nevojat institucionale në mënyrë efektive.

Për të siguruar zbatimin efektiv të këtyre masave, është i domosdoshëm koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave të menjëhershme për të adresuar problematikat e hasura.

OS. 2.5. - Përforcimi i mekanizmave të llogaridhënies së magjistratëve.	
Risku	Përcaktimi i rregulloreve të sigurta për sinjalizuesit nga KLGJ dhe KLP në konsultim me PP dhe ILD, me fokus tek ndikimet e padrejta të brendshme dhe të jashtme.
Niveli i Riskut	I mesëm
Analiza	Numri i ulët i rasteve të sinjalizimit nga magjistratët për përpjekjet për ndikime të padrejta tregon vetë-censurim për shkak të mungesës së besimit. BE ka dhënë disa rekomandime për adresimin e kësaj problematike, si krijimi i pikave të dedikuara në prokurori, KLGJ/KLP ose këshillat e etikës për të rritur raportimin mbi rastet e ndikimit të padrejtë ndaj gjyqtarëve. Megjithatë, i takon Shqipërisë të vendosë se si ta zbatojë këtë proces dhe të përmirësojë procedurat.
Faktori i riskut	Mungesa e një rregulloreje të sigurt për sinjalizuesit. Frika nga pasojat për raportimin e rasteve të ndikimit të padrejtë. Mungesa e besimit në institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e sinjalizuesve. Mungesa e ndjekjes sistematike të sanksioneve ndaj rasteve të ndikimeve të padrejta.
Masat për zvogëlimin e riskut	Miratimi i një rregulloreje të qartë dhe të sigurt për sinjalizuesit nga KLGJ dhe KLP, në konsultim me PP dhe ILD. Krijimi i pikave të dedikuara për raportimin e rasteve të ndikimit të padrejtë në prokurori, KLGJ/KLP ose këshillat e etikës. Zbatimi i sanksioneve ndaj rasteve të konfirmuara të ndikimit të padrejtë për të ndërtuar besimin e magjistratëve. Organizimi i fushatave informuese për magjistratët mbi mbrojtjen e sinjalizuesve dhe procedurat e raportimit.

OS. 2.5. - Përforcimi i mekanizmave të llogaridhënies së magjistratëve.	
Risku	Mungesa e inspektorëve në ILD dhe tërheqja e kandidatëve cilësorë, duke ruajtur meritokracinë dhe pavarësinë e institucionit.
Niveli i Riskut	I mesëm

Analiza	Aktualisht, 11 nga 20 pozicionet janë plotësuar. BE nuk dëshiron të përjashtojë mundësitë për ndryshime, por insiston që cilësia e kandidatëve të ruhet. Reforma është përfshirë në Agjendën e Reformave me një afat deri në dhjetor 2027.
Faktori i riskut	Mungesa e interesit për aplikime për shkak të kushteve ligjore dhe buxhetore.
Masat për zvogëlimin e riskut	Tryezë e rrumbullakët me MD, ILD, KLGJ dhe KLP për të diskutuar ndryshime në politikën dhe legjislacionin përkatës. Identifikimi i arsyeve të mungesës së interesit dhe zgjidhja me masa specifike nga institucionet e pavarura. Miratimi i kriterëve për komandimin e magjistratëve në ILD. Procedura për komandim të magjistratëve të shpallet 2 herë në vit deri në plotësimin e vendeve vakante. Hartimi i kurrikulave dhe realizimi i trajnimeve të vazhdueshme me SHM.

4.2.3 Qëllimi i Tretë i Politikës

Risqet e evidentuara në Qëllimin e Parë të Politikës lidhen kryesisht me zbatimin e masave specifike. Në kuadër të riskut që shoqëron Objektivin Specifik “3.1. - Përmirësimi i kapacitetit të KLGJ dhe gjykatave, përfshirë GJL, për zbatimin e masave që rrisin efikasitetin”, lidhur me infrastrukturën dhe vakancat në gjyqësore kërkohet zbatimi i masave 3.1.1 Implementimi i Hartes se re Gjyqesore nga KLGJ dhe gjykatat; 3.1.2 KLGJ-ja/këshillat e gjykatave harton/jne dhe miraton/jne një strategji efikasiteti/reduktimi të çështjeve të prapambetura/shpërndarje të barabartë të ngarkesës për gjykatat në të gjitha nivelet; 3.1.3 Garantimi i burimeve njerëzore dhe buxhetit të duhur për të siguruar zbatimin praktik të strategjisë së efikasitetit/reduktimit të çështjeve të prapambetura/shpërndarjen e ngarkesës së punës në gjykata dhe indikatorëve: 15- Përqindja e zvogëlimit të DT (Disposition Time) për gjykatat sipas shkallëve dhe llojit të çështjeve (civile, penale, administrative); 16 - Plotësimi i vakancave në gjykata dhe 17- Përqindja e reduktimit të çështjeve të mbartura (sipas shkallëve të gjykatave).

OS. 3.1. - Përmirësimi i kapacitetit të KLGJ dhe gjykatave, përfshirë GJL, për zbatimin e masave që rrisin efikasitetin	
Risku	Numri i lartë i vakancave në gjyqësor dhe infrastruktura e dobët e gjykatave ndikon në efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe besueshmërinë e tij.
Niveli i Riskut	I mesëm
Analiza	Megjithëse është miratuar Strategjia kombëtare e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (2024-2027), periudha e gjatë me një numër të lartë vakancash dhe infrastrukturë të papërshtatshme ka çuar në një grumbullim të madh të çështjeve gjyqësore, duke vonuar zgjidhjen e tyre dhe duke ndikuar negativisht në qasjen në drejtësi. Është e nevojshme një qasje e koordinuar që përfshin masa të ndryshme për rritjen e efikasitetit.
Faktori i riskut	Prapambetja e lartë e çështjeve gjyqësore dhe mungesa e një mekanizmi të fortë për reduktimin e saj. Numri i lartë i vakancave në systemin gjyqësor sidomos në Gjykatat e Posaçme duke përfshirë edhe vakancat në stafin mbështetës.

	Procedura të ngadalta dhe mungesa e stafit mbështetës për të rritur kapacitetet e gjykatave. Mungesa e investimeve të nevojshme në infrastrukturën gjyqësore.
Masat për zvogëlimin e riskut	Zbatimi i një plani të detajuar për reduktimin e çështjeve të prapambetura, bazuar në mjetet e CEPEJ. Plotësimi i vendeve vakante në gjyqësor dhe rritja e numrit të stafit mbështetës. Sigurimi i burimeve financiare për përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, duke përfshirë sallat e gjyqit dhe arkivat. Monitorimi i rregullt i ecurisë së planit të veprimit për reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe përmirësimin e transparencës në gjyqësor.

Në kuadër të riskut që shoqëron Objektivin Specifik 3.4. - Përkrahja/promovimi dhe rritja e përdorimit të mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve nevojitet zbatimi i masave: 3.4.1 Dhoma e Ndërmjetësve vazhdon të forcojë sistemin e ndërmjetësimit duke ofruar trajnime fillestare dhe të vazhduara për kandidatët ndërmjetës dhe ndërmjetësit e akredituar; kryer fushata ndërgjegjësuere për ndërmjetësimin dhe rritur numrin e ndërmjetësve dhe 3.4.3 Detyrimi ligjor i gjykatave për të informuar siç duhet palët për mundësinë e përdorimit të ndërmjetësimit vlerësohet nga KLGJ-ja në vlerësimin e performancës.

OS. 3.4. - Përkrahja/promovimi dhe rritja e përdorimit të mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.	
Risku	Ndërmjetësimi si mekanizëm alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ka një nivel të ulët aplikimi në Shqipëri, pavarësisht kornizës ligjore ekzistuese dhe përfitimeve të tij në uljen e ngarkesës gjyqësore, kursimin e kohës dhe kostove për palët.
Niveli i Riskut	I ulët
Analiza	- Përdorimi i ndërmjetësimit mbetet i kufizuar, pavarësisht legjislationit në fuqi. - Gjyqtarët dhe avokatët nuk e promovojnë sa duhet si një alternativë efektive duke patur një numër të ulët referimesh nga gjykatat të përdorimit të mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve. - Publiku ka pak informacion mbi përfitimet e ndërmjetësimit.
Faktori i riskut	Mungesa e mekanizmave detyrues për referimin e rasteve. Mungesa e stimulimit financiar ose lehtësive për palët që zgjedhin ndërmjetësimin. Mungesa e trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarët dhe avokatët mbi ndërmjetësimin. Nevoja për implementimin e praktikave më të mira europiane të ndërmjetësimit si dhe trajnimi i duhur ndërmjetësve.
Masat për zvogëlimin e riskut	- Organizimi i fushatave informuese për qytetarët dhe profesionistët e drejtësisë. - Zbatimi i masave stimuluese për përdorimin e ndërmjetësimit, si tarifa më të ulëta ose ulje e kostove të proceseve gjyqësore për palët që zgjedhin ndërmjetësimin. - Detyrimi i gjyqtarëve për të referuar raste drejt ndërmjetësimit kur çështjet janë të përshtatshme për këtë metodë.

Në kuadër të riskut që shoqëron Objektivin Specifik 3.5. - Rritja e efikasitetit në gjykata dhe prokurori me anë të mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit, kërkohet avancimi me zbatimin e masave: 3.5.2 Dizajnimi i Sstemit për Menaxhimin e Integruar të Çështjeve (ICMIS), duke përfshirë hartëzimin e të gjitha proceseve, detajet e funksionaliteteve nga Bordi i Qendrës së QTI-së dhe 3.5.3 Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në gjykata dhe prokurori.

Për të siguruar zbatimin efektiv të këtyre masave, është i domosdoshëm koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave të menjëhershme për të adresuar problematikat e hasura.

OS. 3.5. - Rritja e efikasitetit në gjykata dhe prokurori me anë të mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit.	
Risku	Sistemi i integruar elektronik i drejtësisë nuk është krijuar ende. Në periudhën raportuese ka disa zhvillime sa i takon miratimit të Udhëzuesit për Sistemin e Ri të Integruar të Çështjeve nga ana e KLGJ, si dhe zhvillimit të Udhërrëfyesit ndërinstitucional për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë, por këto hapa janë ende larg vënies në funksion të Sistemit të Integruar të Çështjeve në të gjithë sistemin e drejtësisë.
Niveli i Riskut	I mesëm
Analiza	Stafi i Qendrës së IT-së ende nuk është plotësuar. Nevojitet përgatitje e nevojshme për ndërhyrjet e nevojshme në lidhje me përmirësimet infrastrukturale dhe logjistike. Udhërrëfyesi për sistemin e integruar të menaxhimit të rasteve nuk është miratuar gjatë periudhës raportuese.
Faktori i riskut	Burimet njerëzore, burimet financiare, mbështetja ndërkombëtare.
Masat për zvogëlimin e riskut	Sigurimi i burimeve të nevojshme dhe mbështetjes së donatarovë; Organizimi i procesit në mënyrë transparente; Koordinimi e të gjitha grupet e interesit.

4.2.4 Qëllimi i Katërt i Politikës

Risqet e evidentuara në Qëllimin e Katërt të Politikës lidhen kryesisht me zbatimin e masave specifike. Në kuadër të riskut që shoqëron Objektivin Specifik 4.3. - Forcimi i kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës me qëllim përmirësimin e trajnimit gjyqësor dhe kurrikulave të trajnimit vendoset fokusi në zbatimin e masave: 4.3.1 SHM rishikon Rregulloren e saj të Brendshme duke siguruar që provimi i pranimit është në përputhje standardet më të mira të BE-së dhe shkollave homologe të trajnimit gjyqësor dhe siguron që konkurrentët të vlerësohen mbi bazën e aftësisë dhe jo vetëm mbi bazën e njohurive mbi ligjin; 4.3.4 Rishikimi i kurrikulës së formimit fillestar, miratimi dhe zbatimi i saj gjatë vitit akademik dhe 4.3.5 Përmirësimi dhe pasurimi i programit të formimit të vazhduar që i përgjigjet nevojave të identifikuar për specializimin e magjistratëve në detyrë. Për të siguruar zbatimin efektiv të këtyre masave, është thelbësore që Shkolla e Magjistraturës të ndërmarrë masa të menjëhershme për adresimin e problematikave të identifikuar, duke garantuar pranimin e kandidatëve me integritet dhe përmirësimin e kapaciteteve profesionale të magjistratëve ekzistues, në përputhje me standardet evropiane.

OS. 4.3. - Forcimi i kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës me qëllim përmirësimin e trajnimit gjyqësor dhe kurrikulave të trajnimit.

Risku	Cilësia e pamjaftueshme e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për magjistratët, mungesa e një programi të përshtatur sipas specializimeve dhe mbikëqyrjes efektive të sistemit të mentorimit.
Niveli i Riskut	I mesëm
Analiza	Cilësia e trajnimeve ka nevojë për përmirësim përmes rishikimit të kurrikulave, bazuar në rekomandimet e TAIEX dhe Komisionit Evropian. Nevojitet një sistem efektiv i mentorimit për trajnimin në vendin e punës, me një numër të mjaftueshëm mentorësh dhe kapacitete të përmirësuara. ILD duhet të miratojë metodologjinë për vlerësimin e nevojave për trajnim dhe të zbatojë një skemë të kuptueshme të vlerësimit të trajnimeve të vazhdueshme. Gjithashtu, është e nevojshme modernizimi i platformave të eLearning dhe sigurimi i qasjes në jurisprudencë dhe njësi kërkimore.
Faktori i riskut	Nevoja për një kurrikulë të rishikuar dhe të përditësuar për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm. Mungesa e një sistemi të monitoruar dhe të fuqizuar të mentorimit. Nevoja për një metodologji të përditësuar për vlerësimin e nevojave për trajnim dhe ndikimit të trajnimeve. Mungesa e mjeteve moderne për të mbështetur procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit.
Masat për zvogëlimin e riskut	ishikimi dhe miratimi i kurrikulës së trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm nga Shkolla e Magjistraturës (ShM) në përputhje me specializimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Krijimi dhe fuqizimi i një sistemi efektiv të mentorimit dhe garantimi i një numri të mjaftueshëm mentorësh me kapacitete të përmirësuara. Modernizimi dhe promovimi i platformave të eLearning, sigurimi i qasjes në njësitë kërkimore dhe jurisprudencën.

4.3 Hapat vijues

Në vazhdim të analizës, hapat vijues përqendrohen në sigurimin e një zbatimi të plotë dhe efikas të masave dhe indikatorëve të Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë (SND) gjatë periudhës së ardhshme raportuese, me synimin për të shmangur risqe të reja që mund të ndikojnë në reformën në drejtësi. Për këtë qëllim, do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

1. Përmirësimi i mekanizmave të raportimit dhe monitorimit

- Organizimi i ëorkshopeve të specializuara për rritjen e kapaciteteve të raportimit nga institucionet përgjegjëse.
- Përditësimi i metodologjisë së raportimit për të siguruar një analizë më të thelluar të të dhënave dhe të ndikimit të strategjisë.

2. Zhvillimi i mekanizmave të parandalimit të risqeve

- Krijimi i një mekanizmi paralajmërues të hershëm për të identifikuar dhe adresuar në kohë sfidat që mund të ndikojnë në zbatimin e strategjisë.

- Hartimi i rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, bazuar në analizën e sfidave të raportuara.

3. Forcimi i kapaciteteve institucionale për implementimin e strategjisë

- Organizimi i trajnimeve për stafin përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e SND.
- Organizimi i ëorkshopeve të specializuara për rritjen e kapaciteteve të raportimit buxhetor nga institucionet përgjegjëse.

4. Përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional

- Zhvillimi i takimeve të rregullta mes institucioneve kyçe për të garantuar një qasje të unifikuar dhe efektive në zbatimin e strategjisë.
- Rritja e transparencës në ndarjen e informacionit ndërmjet institucioneve dhe përmirësimi i mekanizmave të raportimit të përbashkët.

Këta hapa do të sigurojnë një zbatim më efikas, të qëndrueshëm dhe të koordinuar të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, duke minimizuar risqet dhe garantuar përparim të qëndrueshëm në reformën në drejtësi.